

magazina evropiane

SOROS

Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur
Kosovska Fondacija za Otvoreno Društvo
Kosovo Foundation for Open Society

| Shkurt 2012 | Numri 6 |

Zhvillimet urbane

sheshi muzeu hapësira
pa leje
urat
planit kaos
focadat urban
shatkuilid
demografia



HYRJE

Ky edicion i "Revistës Evropiane" do të merret me planifikimin dhe zhvillimet hapësinore-urbane, në nivelin lokal dhe rajonal. Me këtë edicion të gjashtë tentohet të kontribuohet në ngritjen e vetëdijes së opinionit të gjerë në tërë këto koncepte shumë të rëndësishme për planerët gjithandej botës, porse shumë pak të njohura për opinionin e gjerë profesional kosovar. Kjo posaçërisht është shumë e rëndësishme kur kemi të bëjmë me integritet evropiane dhe ndikimin e së planifikuarës për një zhvillim të qëndrueshëm të një hapësire, zhvillimit ekonomik, mjedisor dhe social.

Integrimi evropian karshi planifikimeve hapësinore-urbane; zhvillimeve hapësinore-urbane

Konceptet e planifikimit dhe të zhvillimit hapësinor dhe urban, si formë dhe nocion, për shumicën e popullatës janë të ngjashme, nëse jo të njëjta, nuk ekziston dallim.

Sfidat e zhvillimeve hapësinore dhe urbane kanë të bëjnë me sfidat ditore, duke u nisur prej atyre politike, zhvillimore, mjedisore, energjetike, sfidat e bashkëpunimit ndërfaqinësor dhe ndërkombëtar, atyre në sferën e zhvillimit të arsimit, banimit, zhvillimit të infrastrukturës, si dhe të çështjeve të investimeve kapitale dhe buxhetore.


Zhvillimet urbane karshi kërkesave të Bashkimit Evropian janë: Gjithëpërfshirja dhe zhvillimet urbane; Partneriteti publiko-privat dhe zhvillimet urbane; Menaxhimi i patundshmërive dhe zhvillimet urbane; Zhvillimi urban për rajonet metropolitane urbane; Roli i arkitekturës në zhvillimet urbane; Hapësirat e lira publike; Trashëgimia kulturore dhe zhvillimet urbane; Kontrolli i zhvillimeve urbane; Banimi dhe zhvillimet sociale karshi zhvillimeve të hovshme urbane; Rritja urbane e qëndrueshme; Ndërtimet ilegale dhe procesi i legalizimit; Jeta urbane dhe shoqëria civile; Urbanizimi dhe turizmi; Ndikimi i politikës ditore në arkitekturë dhe urbanizëm; Urbanizimi dhe ndryshimet klimatike në Kosovë; Identiteti urban gjatë dhe në Kosovë, e shumë e shumë të tjera.

Të gjithë e dimë se Bashkimi Evropian është në rrugë e sipër të bëhet një kontinent i pandarë, ku territoret janë të ballafaquara me sfida të ngjashme ekonomike, sociale dhe mjedisore, porse të cilat nuk njohin kufij. Kjo ndodh përderisa në të njëjtën kohë këto territore janë të qeverisura në mënyrë institucionale dhe administrative përmes kufijve tradicionalë.

Përderisa në territorin e Bashkimit Evropian nuk ka kufij, do të thotë se aty duhet të ekzistojnë rregulla të dakorduara nga të gjithë që aderojnë në të, për një funksionim të tillë, për një kohezion të qenësishëm ekonomik, social dhe mjedisor.

Pra, integritet evropiane ngrenë çështjen e KOHEZIONIT TERRITORIAL ndërmjet shumë territoreve, tanimë objektiv i ri për Bashkimin Evropian, bazuar në Traktatin e Lisbonës, bashkëpunimin ndërmjet territoreve, përtej kufijve dhe institucioneve të ndryshme gjegjëse, duke u bërë shumë e më e rëndësishme për mënyrën e qeverisjes së tyre, qeverisjes shumështrësore për rajonet e reja funksionale (Seider, M., 2010).

Planifikimi hapësinor është shumë i rëndësishëm për të hyrë në oborin e njëjtë të Bashkimit Evropian, meqë ai funksionon si bashkësi shtetesh pa kufij (me liri të qarkullimit të njerëzve, mallrave dhe shërbimeve).



Për të arritur të lëvizësh i lirë gjithandej nëpër BE, do të duhej të ndihesh i sigurt, ndërsa për t'u ndier i sigurt duhet që të gjithë të respektojnë rregullat e njëjta të lojës, pra edhe që të dinë se çka ndodh dhe çka do të ndodhë në territorin gjegjëse – të fqinjit dhe më larg.

Për të ditur se çka do të ndodhë për më larg në territorin x në BE, duhet të projektohet e ardhmja përmes planeve afatgjata, me të cilën sigurohet se shtetet gjegjëse do të respektojnë rregullat e përbashkëta të lojës. Këtu hyn planifikimi hapësinor!

Bashkimi Evropian për shkak të zhvillimeve të ndryshme në territorin e vet ka rajone me karakteristika të ngjashme zhvillimi, të cilat fondet zhvillimore i mbështesin dhe të cilat paraqiten përmes hartave për shumë çështje me rëndësi. Njëra ndër hartat aktualisht me rëndësi (nëse shkruani fjalët kryesore të kërkimit në internet si rajonet evropiane apo ESPON.eu) që do të hasni është harta e BE-së lidhur me çështjet e mirëqenies ekonomike dhe punësimit. Menjëherë do t'ju dalin përpara hartat, të cilat shumë ministra në BE i shqyrtojnë, dialogojnë, bëjnë marrëveshje, flasin për të tashmen dhe për të ardhmen. Pra, e ardhmja e paraqitur në hapësirë!

Për të përfunduar, në këtë numër të revistës do të elaborohen shumë nga sfidat e zhvillimeve urbane nga ekspertë të ndryshëm vendorë dhe ndërkombëtarë, nga këndvështrimet e ndryshme, dimensionet e ndryshme, ashtu sikurse është shumëdimensionale vetë HAPËSIRA, NJERIU, SHOQËRIA, JETA, ZHVILLIMI, ARDHMËRIA, GJENERIMI I TË RESË, RUATJA E SË VJETRËS.

IDA. Elvida Pallaska, magjistër për menaxhim dhe zhvillim urban

NË KËTË NUMËR

ZHVILLIMET URBANE

PARTNERITETI PRIVAT DHE PUBLIK
PËRBALLË ZHVILLIMEVE URBANE
Ark. Agron Sallova

Faqe 4

URBANIZIMI DHE SFIDAT E
PLANIFIKIMIT URBAN NË KOSOVË
MSc. Besim Gollopi

Faqe 6

NDËRTIMET JOFORMALE DHE ADMIN-
ISTRIMI MË I MIRË I TERRITORIT
Dr. Besnik Aliaj

PLANIFIKIMI GJITHËPËRFSHIRËS SI
MJET PËR NDËRLI-DHJEN DHE PËRKA-
TËSINË E KOMUNITETIT ME VENDIN
IDA. Eliza Hoxha

Faqe 10

ZHVILLIMI I PLANIFIKUAR HAPËSINOR -
INDIKATORI I NIVELIT TË VETËDIJES
KOLEKTIVE - PROGRESIT SHOQËROR
IDA. Elvida Pallaska

Faqe 12

ZHVILLIMI RAJONAL NË KOSOVË
Inxh. i dipl. i ark. Faton Deva

Faqe 15

MISIONI I ZHVILLIMIT URBAN
Flamur Kuçi

Faqe 18

RËNDËSIA APO INJORIMI I PLANIFIKIMIT
HAPËSINOR DHE URBAN NË KOSOVË
Ark. Hidajete Zhuri

Faqe 21

ZHVILLIMI NËPËR HISTORI I HAPËSIRËS
PUBLIKE NË KOSOVË
Ark. Ilir Gjinolli

Faqe 23

PËRPARËSITË E BASHKËPUNIMIT NDËR-
KUFITAR DREJT ZHVILLIMIT TË QËNDRU-
ESHËM TË BALLKANIT PERËNDIMOR
Ark. Ilirjana A. Mejzini

Faqe 27

KARIKATURAT

Faqe 30-31

QYTETI NË TRANSICION: "ARCHIS
INTERVENTIONS" NË PRISHTINË
Florina Jerliu, Kai Vöckler

Faqe 32

TRASHËGIMIA DHE PLANIFIKIMI
Luan Nushi

Faqe 35



JUNIKU, NJË QASJE ALTERNATIVE E
ZHVILLIMIT HAPËSINOR, BAZUAR NË
TRASHËGIMINË KULTURORE DHE
PLANIFIKIMIN ME FORCA VETJAKE
Mirian Bllaci

Faqe 37

KOSOVA – ME URBARKITEKTONIKË
NË "SHQETËSIM"
Ark. Nexharije Buçinca

Faqe 40

VIZIONI PËR KOSOVËN
Përparim Rama

Faqe 42

ROLI I GIS-IT NË PLANIFIKIMIN DHE
MENAXHIMIN URBAN
Rizah Murseli

Faqe 45

ZHVILLIMET URBANE KARSHI MENAXHI-
MIT TË PATUNDSHMËRIVE NË KOSOVË
Visar Hoxha

Faqe 47

LEGJISLACIONI NË ZHVILLIMET
URBANE NË KOSOVË
Vjosa Vela

Faqe 49

ARKITEKTURA E OBJEKTEVE PUBLIKE
NDIKIMI I ARKITEKTURËS PERËNDI-
MORE-EVROPIANE, ARKITEKTURA
E PRISHTINËS 1878 – 1912
Mr.Sc. Vlora Navakazi, i.d.a

Faqe 51

IDENTITETI URBAN NË KOSOVË
Arch. Ylber Vokshi Ylli

Faqe 60

zhvillimet urbane

PARTNERITETI PRIVAT DHE PUBLIK PËRBALLË ZHVILLIMEVE URBANE

Ark. Agron Sallova



Partneriteti publik privat i nevojshëm për efikasitet

Përparësitë dhe risitë që i ka sjellë reforma legislative në fushën e planifikimit urban tashmë janë të dukshme në shumë qytete të Kosovës. Një pjesë e madhe e komunave ka realizuar obligimin e vet ligjor që të nxjerrë PZHU-të. Ndërsa udhëheqja e procesit të hartimit të këtyre dokumenteve ka pësuar avancim pozitiv, duket që shumë rrallë është anticipuar që investimet më domethënëse vijnë nga sektori privat. Këto investime gjithnjë drejtohen në zhvillimin e kapaciteteve afariste, ndërsa e tërë kjo ndodh me ndërtim të intensitetit të shtuar. Për këtë arsye nuk mund të konstatohen kapacitete të mangëta investuese, por e kundërta, mungesa e udhëzimit adekuat të bazuar në planifikim dhe bashkërendim të interesave mes sektorit privat dhe publik. Stad kritik në tërë këtë proces për t'u arritur është hapja e dialogut për balancim të interesave private dhe publike dhe deklarim të projekteve afatmesme dhe afatgjatë nga të dyja palët. Deri në arritje të këtij stadi sektori privat vepron furishëm, ndërsa administrata e hutuar pa asnjë politikë se si të veprojë.

Sidoqoftë, ka shembuj për të ndjekur, dukuri që kërkojnë vëmendje dhe mundësi që "ecja paralele" të kryqëzohet më shpesh në të ardhmen.

Shembuj, për të ndjekur

Të dy shembujt vijnë nga Peja, dhe kanë të bëjnë me efektet pozitive që sjell planifikimi pjesëmarrës, kur, përveç realizimit të interesit publik, të arritur

përmes negociimit intensiv 18- muajsh i mundëson sektorit privat të kapitalizojë vlerat e reja urbane. Fjala është për projektin e zonës së lirë këmbësore në qendër të qytetit, sipas mendimit tim, të vetmes në Kosovë me attribute adekuate. Shembull i mirë për t'u ndjekur në këtë rast është qëndrimi insistues i administratës komunale që njërën nga rrugët më të frekuentuara ta kthejë në zonë për këmbësorë.

Shembull i dytë ka të bëjë me projektin e lirit dhe të sigurimit të qasjes së lirë në një segment të bregut të lumit. Synimi i angazhimit të kapitalit privat dhe publik në projektet strategjike komunale është artikuluar shumë thjesht nga autoritetet komunale përmes këmbimit të pronës komunale me atë private. Specifike në këtë rast është qasja ndaj sektorit privat, nga i cili është kërkuar të blejë pronat që pengojnë zhvillimin e projektit, ndërsa janë ofruar në këmbim prona që nuk pengojnë ndonjë projekt kapital publik e që paraqesin aset të vlefshëm zhvillimor për sektorin privat. Këmbimet janë zyrtarizuar përmes vendimeve përkatëse të Asamblesë Komunale.

Përqendrimi i veprimtarive - dukuri që kërkon vëmendje

Sado në shkallë të ulët, edhe qytetet tona vuajnë nga sindromi, i cili e ka kapluar tërë rruzullin, me shkallë të lartë të rritjes së territorit urban dhe të globalizimit ekonomik. Në një numër të madh të qyteteve "zona industriale" ka qenë e përkufizuar sipas planeve urbane me

zonim funksional të qytetit si pjesë e indit urban. Këto zona kanë shërbyer që të themelohen ndërmarrje shoqërore që pas luftës i janë nënshtruar procesit të privatizimit. Në shumicën e rasteve në fillim ky privatizim nuk ka sjellë rritje ekonomike të pritur kryesisht për shkak të mungesës së investimeve të deklaruara nga pronarët e rinj. Mirëpo shumë shpesh mund të hasim në situata ku pronarët e rinj kanë shitur apo dhënë me rentë pjesë të konsiderueshme të këtyre aseteve, gjë që kryesisht rezulton me hapje të bizneseve të vogla përbrenda një zone. Këto zhvillime sado naive që duken me kohë po e dëshmojnë të jenë më se të arsyeshme e kryesisht për shkak se i tërë ky proces sjell përqendrimin e veprimtarive tregtare, shërbyese dhe zejtare në një zonë të caktuar, ku përparësitë janë të shumëfishta, si lidhja e mirë me qytetin dhe rrugët magjistrale, qasja e lehtë e konsumatorit me automjet në shërbime, hapësirë e mjaftueshme për qarkullim dhe parkim brenda zonës, laramania e ofertës dhe shërbimeve, furnizim më stabil me energji elektrike etj. Me gjithë këtë skemë që funksionon në mënyrë natyrale, sepse laramania është magnet për konsumatorin, shpesh propozimet e planeve kërkojnë transferim të këtyre përmbajtjeve në një distancë më të madhe apo hapje të një zone të re?! Ky zhvillim ofron një mundësi të shkëlqyeshme që nën menaxhimin adekuat të procesit të planifikimit këto zona të "popullohen" më të gjitha ato biznese që në shumicën e rasteve janë të zhurmshme dhe krijojnë imazh të keq në zonat e dendura urbane. Riparuesit e

gomave, larja e veturave, serviset e automekanikëve, tregje me artikuj që nuk mund të transportohen me veturë etj., me një program adekuat të bazuar në partneritet privat dhe publik, mund të transferohen në këtë zonë. Trendët aktualë tregojnë që vizita e konsumatorit nuk është thjesht nevojë për furnizim apo shërbime, por edhe zbavitje, prandaj shpesh vërejmë edhe funksione të rekreacionit, sportit dhe hotelerisë në këto zona të shërbyera edhe me transport falas për shkak të frekuencimit të qëndrueshëm qendër – zonë.

Komunikimi sistematik dhe i strukturuar

Dëgjimet publike për planet afatmesme buxhetore të komunave janë më shumë përmbyshje e obligimit ligjor sesa qasjes pragmatike të identifikimit të pikave ku takohen interesat. Në anën tjetër, këto projektbuxhete as përafërt nuk reflektojnë rekomandimet e planeve urbane, ndërsa nga sektori privat kërkohet që të zhvillojë kapacitetet e veta në përputhje me planet e miratuara. Ende nuk ekziston praktika që ndonjë komunë në Kosovë të ftojë sektorin privat që në hollësi të shpjegojë buxhetin që ka për të ardhmen dhe të paktën të dëgjojë mendimin se si nga perspektiva e ndërmarrësit ky buxhet mund të sjellë më shumë projekte të konceptit "win-win". Ky komunikim duhet të jetë i

planifikuar, sistematik dhe mirë i strukturuar që të krijojë një platformë afatgjate të bashkëpunimit në mënyrë që projektbuxheti gjithnjë të deklarojë edhe investimet e pritura nga sektori privat.

Programet e partneritetit në fushën e banimit

Planifikimi i fondit banesor në kushtet aktuale nuk mund të zhvillohet pa përfshirje të sektorit privat dhe përkrahje të sistemit bankar. Mirëmbajtja e dendësisë së banimit e rekomanduar me plane urbane për një zonë jo rrallë është në kundërshtim me perspektivën e profitit që kanë zhvilluesit e projekteve. Në të dy rastet investohet në planifikim dhe rezultat i kësaj është konflikti i ambicieve në të njëjtën hapësirë. Banimi si funksion primar nuk zhvillohet i bazuar në një politikë zhvillimore me përkrahje të gjerë, në aspektin legjislativ ende nuk janë përcaktuar subjektet përkatëse në sektorin privat që kanë të drejtën e planifikimit dhe zhvillimit të banimit përballë kërkesës për hapësirë të banimit në kushte të rritjes së përshpejtuar urbane. Në këtë situatë profilizimi i ndërmarrjeve për këtë veprimtari, planifikimi i përbashkët, i cili mund të financohet nga sektori privat, përfshirja e bankave kreditore në procesin e planifikimit të hapësirës banesore mund të krijojnë kushte shumë të mira për

balancim sa më të mirë të interesave të palëve të përfshira në proces. Cilësia e hapësirës së banimit, infrastruktura dhe shërbimet, funksionet plotësuese etj., që të gjitha duhet të përcaktohen përmes negociimit intensiv gjatë planifikimit të një ansambli apo blloku për banim, ndërsa plani për zbatim duhet të specifikojë bartësit e investimit për secilën kategori në veçanti. Kjo është e mundur vetëm me partneritet në baza kontraktuale mes palëve të përfshira.

Elaboratet e arsyetueshme sociale, mjedisore dhe ekonomike

Çdo projekt kapital, privat apo publik kërkon paraprakisht studim të arsyetimit investues (fizibilitet), pastaj projekt-propozim, vlerësim përkatës të ndikimit etj. Deri më tani nuk kam hasur në ndonjë rast ku ndonjë komunë në buxhetin e vet ka zotuar mjete për një gjë të këtillë. Për këtë arsye shpesh edhe kur shfaqet ndonjë mundësi e realizimit të ndonjë projekti, i cili paraprakisht kërkon elaboratin e fizibilitetit, procedura e gjatë e zotimit të mjeteve për këtë elaborat e shtyn për së paku një vit realizimin. Në anën tjetër, mund të vërehet se në tre vjetët e fundit kanë filluar të realizohen projekte më serioze nga sektori privat dhe pothuajse në çdo rast investimet janë të bazuara në planifikim paraprak dhe të paktën para-fizibilitet. Kjo praktikë duhet kuptuar si mundësi që ka sektori publik, që në moment të caktuar t'i drejtohet sektorit privat me kërkesë për konsulencë profesionale, huazim të mjeteve nga baza kontraktuale deri në alokimin e mjeteve të zotuara apo thjesht kërkesë për përkrahje të projektit. Kjo posaçërisht vlen në raste të realizimit të infrastrukturës kapitale të qytetit, si impianti për trajtim të ujërave fekale, rregullimin e shtratit të lumit, rirregullim territorial, regjenerimit urban etj. Rindërtimi i pasluftës na ka sjellë një përvojë të re, e ajo është që veprimi i njëanshëm sjell dëme të mëdha për të gjithë.

(Autori është arkitekt për ndërtim dhe inxhiniering, ShPK "Dukagjini" – Pejë)



Partneriteti publik privat, për një qytet më funksional dhe të bukur

URBANIZIMI DHE SFIDAT E PLANIFIKIMIT URBAN NË KOSOVË

MSc. Besim Golloperi



Foto: Besim Golloperi, Prishtinë, 2010

Urbanizimi dhe zhvillimi i jetës urbane në Kosovë me tërë ritmin dhe dimensionet e tij është i ri, megjithëqë disa qytete, siç dihet, kanë histori dhe traditë relativisht të gjatë. Baza natyrore, trashëgimia specifike shoqëro-historike, depërtimi i vonshëm i elementeve të ekonomisë kapitaliste, pozita koloniale e Kosovës gjatë tërë shekullit të kaluar dhe moszhvillimi ekonomik në përgjithësi, kanë krijuar tip të veçantë të popullimit. Zhvillimi i pamjaftueshëm dhe i vonshëm socio-ekonomik dhe transformimi i ngadalshëm hapësinor i Kosovës mundësoi nivel dhe rrjedhë të veçantë të urbanizimit.

Në fund të shekullit XX dallimet midis rritjes së popullsisë dhe dimensionit funksional të urbanizimit shënuan një rritje të madhe, sepse ngeci urbanizimi sekondar si indikator i rëndësishëm i procesit të urbanizimit, ndërsa u forcua edhe më tepër urbanizimi primar.

Deri në fillim të pjesës së dytë të shek. XX ndryshimet në mobilitetin hapësinor dhe social të popullsisë ishin të vogla, në përqendrimin dhe moszhvillimin e qyteteve, si dhe në zgjerimin territorial të strukturave urbane. Pas këtyre viteve, e veçmas në dekadën e parë të shek. XXI, ndodhën ndryshime të mëdha si në përqendrimin demografik dhe zgjerimin hapësinor të zonave urbane dhe atyre periferike-urbane. Në këtë kohë lëvizjet e popullsisë fshat – qytet dhe qytete të vogla drejt qyteteve të mëdha u shndërruan në përditshmëri, ku secilit që iu dha mundësia e shfrytëzoi atë, ku gjithnjë synim, veçmas i të rinjve (studentëve), ishte dhe vazhdon të jetë Prishtina. Ky qytet u bë një gjenerator i

përqendrimit të popullsisë dhe zhvillimeve socio- ekonomike, si dhe shpresëdhënëse për popullsinë, ngase mundësia për të pasur një jetë më të mirë (shkollim, vend pune, etj.), ishte më e madhe se gjëkundi. Kjo ndodhi për faktin se e tërë administrata shtetërore (qendrore), organizatat ndërkombëtare, ambasadat, qendrat e mëdha të biznesit kosovar dhe të huaja etj., u vendosën në Prishtinë dhe rrethinë. Në dekadën e fundit zhvillimet e pakontrolluara urbane dhe periferike-urbane (të paplanifikuara) morën formë gjithë andej territorit të Kosovës, me theks të veçantë në 7 qendrat e mëdha urbane, posaçërisht në Prishtinë. Ndërkaq përgatitjet institucionale për të menaxhuar mirë zhvillimet hapësinore, veçmas me zonat urbane dhe periferike-urbane janë në shkallë modeste. Në këtë situatë të palakmuar hapësinore janë ca faktorë të ndryshëm që kanë ndikuar e që tash do të përmendim disa prej tyre që mendohet se janë ndër më kryesorët:

1) **Mungesa e kapaciteteve humane**

- është një ndër faktorët më me ndikim në fushën e planifikimit hapësinor/ urban. Pas vitit 1999, përveç mungesës së **planerëve profesionalë**, kishte edhe paragjykime në shkallë të lartë në mes të profileve që merreshin me planifikim hapësinor. Mirëpo kjo situatë nuk është diçka për t'u çuditur për faktin se në Kosovë edhe sot e kësaj dite nuk ka fakultet për planifikim hapësinor/urban. Ndërkaq si nënprobleme në vete janë edhe mosorganizimi i mirëfilltë lokal në fushën e planifikimit hapësinor dhe madje nga dy aspekte:

a) edhe sot e kësaj dite nuk ka një

organizim të mirëfilltë në qeverinë lokale. Në këtë situatë ka përzierje kompetencash në mes të drejtorive. Gjatë hulumtimit të realizuar në pranverë të vitit 2011, është kuptuar se shumica e komunave të Kosovës drejtoritë për planifikim hapësinor/urban i kanë të emërtuara ndryshe. Shih grafikonin në vijim:


Kjo situatë krijon përzierje të kompetencave dhe vështirësi të natyrës (mos) bashkëpunuese – (mos) bashkëpunimit ndërkomunal. Nëse e marrim shembull rajonin e Prizrenit, të cilin e përbëjnë 5 komuna (përfshijë Komunën e Mamushës), që të gjitha këto i kanë drejtoritë e planifikimit hapësinor të emërtuara ndryshe.

b) gjatë analizave dhe hulumtimeve në qeverinë lokale është kuptuar se asnjë komunë deri tash nuk e ka hartuar ndonjë plan zhvillimor komunal dhe urban me kapacitetet e veta humane. Të gjitha komunat të cilat i kanë hartuar planet hapësinore dhe janë në proces të hartimit, i kanë kontraktuar kompanitë/organizatat private vendore dhe të huaja, ndërkaq fatkeqësisht shumë kompani, të cilat merren me planifikim hapësinor në Kosovë, e bëjnë këtë punë jo pse janë profesionistë të kësaj fushe, por për arsye se ky lëmë për formën dhe modelin se si ato i hartojnë planet zhvillimore urbane është mjaft përfituese. Në anën tjetër, përbrenda procesit të hartimit të planeve zhvillimore urbane nga vetë kompanitë ka mjaft manipulime të natyrës profesionale, teknike etj., ndërsa, kapacitetet të cilat i ka qeveria lokale (shumica e komunave) nuk janë në gjendje që të kontrollojnë punën e kompanive private gjatë hartimit

të planeve urbane në mënyrën më të mirë të mundshme, prandaj edhe cilësia e planeve urbane vihet në pikëpyetje.

2) **Mungesa e financave** - për hartimin e një plani zhvillimor komunal dhe urban kërkojnë shuma të mëdha financiare, prandaj strukturat udhëheqëse lokale në të shumtën e rasteve në mungesë të mjeteve (financave), me dijeni apo pa dijeni, hartimin e planeve zhvillimore urbane e radhisin në prioritetet e fundit të qeverisjes së tyre, duke u përkushtuar më shumë në projekte fizike (asfaltimin e rrugëve, rrjetit të ujësjellësit, kanalizimit, objekte etj.), të cilat janë të dukshme për popullatën e gjerë dhe përmes kësaj forme të qeverisjes (politikëbërësit dhe vendimmarrësit) synohet të arrijnë elektorat (votues për vete) më shumë. Mirëpo ka edhe disa nga komunat që tash e 4 vjet i kanë hartuar planet zhvillimore urbane si p.sh: Peja, Ferizaj, Gjilani, Gjakova etj., por prapëseprapë zbatimi i planeve në praktikë nuk është i kënaqshëm. Në anën tjetër, disa komuna janë fokusuar më tepër në hartimin e planeve rregulluese urbane (për lagje të caktuara të vogla), si p.sh. Prishtina, gjë që kjo praktikë doemos paraqet vështirësi në harmonizimin e planeve zhvillimore urbane dhe komunale. Në një situatë të këtillë pashmangshëm paraqiten pabarazitë sociale, deintegritime urbane etj.

3) **Mungesa e vullnetit politik** - vërehet një mungesë e vullnetit politik për t'u marrë me hartimin e planeve



Sfidat e zhvillimeve hapsinore

zhvillimore urbane dhe me rregullimin e territorit, punë kjo që frutat e para (rezultatet) do t'i japë pas një periudhe relativisht të gjatë. Siç edhe u potencua më lart, politikëbërësit dhe zbatuesit e atyre politikave më tepër janë të përkushtuar në projekte fizike, të cilat bien drejtpërdrejt në sy të popullatës sesa të hartojnë plane dhe strategji lokale për periudhën afatshkurtër, të mesme dhe afatgjatë. Por një situatë e tillë ndodh në të shumtën e rasteve, ngase nuk kuptohet aq sa duhet roli dhe rëndësia e planeve

zhvillimore urbane. Këtë fakt edhe më tepër e vërteton analiza/hulumtimi i bërë gjatë fushatës së përgjithshme (në nivel qendror) në vitin 2010, ku as 1% e të gjitha intervistave, projektpropozimeve, premtimeve, debateve televizive etj., të liderëve dhe përfaqësuesve të tyre, të politikës kosovare, nuk e zunë ngoje fushën e planifikimit hapësinor/urban. Në mungesë të njohurive dhe pranimit në shkallë të dëshirueshme të fushës së planifikimit hapësinor, kaosi hapësinor vazhdon ta degradojë hapësirën e Kosovës në të gjitha anët. Shih foton në vijim.

Si rrjedhojë e gjithë kësaj që u shtjellua më lart vijmë në përfundim se zhvillimet e pakontrolluara kanë marrë formë gjithandej nëpër komuna, posaçërisht në qendrat e mëdha urbane, duke shkaktuar humbje të tokës bujqësore, zhvillime të pabalancuara hapësinore, degradim të vlerave natyrore dhe kulturore, pabarazi sociale, deintegritime urbane etj., duke e sjellë vendin para një kaosi hapësinor, ku pasojat e tij do të jenë të papara-shikueshme dhe afatgjate.

(Autori punon në Institutin për Planifikim Hapësinor)



NDËRTIMET JOFORMALE DHE ADMIN- ISTRIMI MË I MIRË I TERRITORIT

Dr. Besnik Aliaj



Ndërtime ilegale-informale

Në ditët e sotme Shqipëria po përjeton përvojën e ndërrimeve radikale të territorit dhe pronës, situatë kjo e ngjashme me atë në Angli dhe Shtetet e Bashkuara të para dy shekujve. Gjatë dekadës së fundit, së paku 1/3 e popullatës, e cila kishte jetuar më parë në viset e izoluar malore, lanë mënyrën e jetës tradicionale dhe erdhën në qendrat urbane dhe tregjet e reja të punës. Popullata e Tiranës është trefishuar, ndërsa e Durrësit është dyfishuar. Popullata e Kamzës dhe Fushë-Krujës është rritur për 10 herë, përderisa bregdeti i Shqipërisë aktualisht përballlet me një 'boom' demografik. Në fillim të viteve 2000, sipas të dhënave të Bankës Botërore, në Komunën e Kamzës (95% të ndërtesave ishin të ndërtuara në mënyrë informale pas vitit 1990), ku popullata lokale për një dekadë ka investuar së paku 100 milionë USD, në ndërtesa, të cilat shërbejnë për qëllime të strehimit, biznesit dhe infrastrukturës bazë, përderisa në shumë raste investimet publike kanë munguar tërësisht. Në rastin më të mirë, investimet nuk kalojnë shumën prej 100,000 USD në vit. Përafërsisht 6-7 nga 10 objekte të ndërtuara pas vitit 1990 në Shqipëri, janë ndërtuar në mënyrë ilegale-joformale.

"Misteret" që pengojnë zhvillimin e Shqipërisë - Nocioni i pronës përfshin një seri të pyetjeve vitale të cilat janë sfida të qenësishme për shtetin, siç është Shqipëria, të cilat

pyetje kërkojnë përgjigje të qenësishme. Me injorimin e këtyre çështjeve, mund të shkaktohet transformim në "mistere" të frikshme, të cilat do ta pengojnë seriozisht administrimin e territorit të shtetit.

Do të shikojmë në objekte pa leje të qyteteve tona, pasi që sasia e tyre është e madhe përderisa shumica e tyre praktikisht është "kapital i vdekur". Në botë vlera monetare e objekteve pa leje arrin në së paku 10 bilionë USD, ndërsa rreth 70% të ndërtimeve në Shqipëri pas vitit 1990 konsiderohen të jenë (pjesërisht apo tërësisht) pa leje. Një deklaratë nga qeveria thotë se pas vitit 1990 në Shqipëri, së paku 200.000-300.000 objekte kanë qenë të ndërtuara pa leje, me një vlerë monetare të 6 miliardë USD. Kjo është vlerë e nënvlerësuar për shkak të vlerës investuese fizike dhe e cila nuk është e vlerës së tregut. Në këto kushte, në lagjet më të varfra të cilat janë të stërmbyshura me objekte pa leje, ekzistojnë miliona dollarë, të gatshme për t'u përdorur nga autoritetet me përgjegjësi, të cilët do të kishin mundur të ishin "kapital i gjallë" nëse do kishin zbuluar misterin e transformimit të pasurive. Banorët e këtyre zonave nuk janë problem, ata janë vetë zgjidhja!

Misteri i pronës – Aktualisht, nocioni i pronës krahasohet me "shpendin dhe vezën e artë". Askush nuk mund të thotë se ku është ky "shpend". Çka është prona? Si është e prodhuar? Cili është raporti me paranë? Në fund të

luftës së ftohtë, një numër i shteteve si Shqipëria kërkoi ndihmë nga shtetet e zhvilluara. Ndër këshillat që mori ishte edhe imitimi i Perëndimit, por ende edhe sot nuk është kuptuar fakti që arsyet e vërteta të suksesit të shteteve të zhvilluara shtrihen shumë më thellë se në sipërfaqe. Në fakt, sistemet e qasshme të pronave juridikisht legale janë motorë të cilët shërbejnë dhe mundësojnë zhvillim ekonomik dhe administrim të suksesshëm të territorit. **Misteri i vetëdijes politike** – Nëse sasia e tillë enorme e kapitalit të vdekur ishte në fuqinë e popullatës, si është e mundur që të mos jetë marrë parasysh si potencial zhvillimor? Këto rezultate të gabueshme vijnë nga mungesa e informatave të nevojshme, mungesa e kuptimit dhe rezultatet e rivendosjes së popullatës, sikurse edhe faktit se të varfrit kanë ndërruar mënyrën e jetesës së tyre, fakt ky që me shumicë është neglizhuar. Përderisa të gjithë këta banorë "jologjrespektues" të qyteteve tona, kontrollojnë një sasi të konsiderueshme të patundshmërive si dhe njësie ekonomike prodhuese, do të jetë e qartë se një numër i madh i problemeve kombëtare rezulton nga diskrepanca ndërmjet ligjeve aktuale dhe mënyrës aktuale në të cilën shoqëria funksionon. Nëse ligjet e shkruara janë në konflikt me "ligjet", të cilat konkretisht udhëheqin njerëzit në realitet, sigurisht që do të udhëheqë varfëria dhe pakënaqësia. Problemi fundamental nuk është zhvillimi i qyteteve me ndërtesa pa leje porse fakti

se banorët “jologjrespektues” krijojnë kontrata ekstra-legale sociale, të cilat më pastaj imponojnë redistribuim esencial të pasurisë dhe të mirëqenies. Kur autorët pranojnë këtë arsyetim, atëherë nuk do të jenë këto objekte shkak i problemit por pjesë e zgjidhjes. *Mësimi i humbur nga Historia Amerikane* – Ajo çka në këtë moment është duke ndodhur në Shqipëri, ka ndodhur më parë në Evropën Perëndimore dhe Shtetet e Bashkuara, por deri më sot askush nuk e ka analizuar mënyrën se si këto shtete e kanë kapërcyer këtë sfidë. Njohja dhe integrimi i së drejtës për pasuri ekstra-legale kanë qenë elemente kyç që kanë tregun e Shteteve të Bashkuara më të rëndësishmin në ekonominë botërore dhe krijuesin më të madh të pasurisë. Çelësi amerikan për sukses ka bërë revolucion në të drejtat pronësore, edhe pse jo gjithmonë me dëshirë dhe në mënyrë konstante. Amerikanët gradualisht i kanë legjitimuar normat ekstra – legale dhe rregullativën pronësore duke integruar elementet shoqërore me ligjet e tokës dhe sistemin formal të ri për patundshmëri. Në fakt, ishte procesi i integritit ai i cili krijoi mundësitë e prosperitetit duke zëvendësuar natyrën statike të pronës së siguruar, i cili është i mbrojtur kundër ndryshimeve të mundshme të shpejta, me një aspekt dinamik të pronësisë të cilat në mënyrë të



Informaliteti në zhvillime urbane

drejtpërdrejtë i shërbejnë rritjes ekonomike. Transicioni drejt formalizimit të ekstra-legal pronësive në SHBA rezultoi me linjën e konceptit se institucionet legale mund të mbijetojnë vetëm nëse u përshtaten nevojave shoqërore. Mësimi më i mirë nga SHBA-ja është se ka qenë gabim i madh të pretendohet që sektori ekstra-legal nuk ekziston, veçanërisht nëse ky sektor është formalizuar pa ndonjë strategji të qartë. Me këtë detyrat e autoriteteve në funksion do të ishin: i) identifikimi i kontratave reale sociale të pronësisë; ii) integrimi me ligjet zyrtare

; iii) zhvillimi i strategjisë që ofron rregullativa legale në këtë sferë.

Misteri i dështimit të ligjit – Që nga shekulli XIX, shumë kombe kanë imituar ligjet e Perëndimit me qëllim që qytetarëve të tyre t’u ofrojnë një kornizë legale, e cila do të stimulonte krijimin e pasurisë dhe të mirëqenies. Por, shumë shpesh, kanë dështuar. Shumica e qytetarëve shqiptarë sot nuk mund të përdorin këto ligje për të materializuar dhe shndërruar kursimet e tyre në mirëqenie. Pjesa e cila mungon dhe e cila e bën ligjin funksional mbetet mister. Sido që të jetë, draftimi i legjislacionit për legalizimin e objekteve ilegale/joformale duhet të ketë për qëllim krijimin e sistemit të patundshmërive të qasshëm për të gjithë. Qëllimi i fundit i sistemit të patundshmërive dhe legjislacionit urban nuk është vetëm draftimi i statuteve elegante dhe rregulloreve; porse do të duhej të ishte qëllimi për investimet në rrjetëzime gjigante kompjuterësh apo të printimit të hartave të bukura me ngjyra; Qëllimi për një garanci legale mbi pronën, e cila do të ishte në duar të qytetarëve ligjdashës.



Ndërtimet ilegale të rrënuara

(Autori është profesor në Universitetin Polis – Tiranë)

PLANIFIKIMI GJITHËPËRF- SHIRËS SI MJET PËR NDËRLI- DHJEN DHE PËRKATËSINË E KOMUNITETIT ME VENDIN IDA. Eliza Hoxha



Planifikimi gjithpërfshirës në Afrikë

E kemi dëgjuar gjithandej se gjithpërfshirja është vlerë e shoqërive demokratike. Grupe të ndryshme sociale, etnike, gjinore, moshe e kulturore kanë nevojë dhe kërkesa të ndryshme përbrenda një lagjeje, qyteti a rajoni. Për t'iu dhënë përgjigje një game kaq të gjerë nevojash e kërkesash të këtyre grupimeve për një të ardhme alternative për të gjithë, një grup i vogël ekspertësh planifikues e ka shumë të vështirë ta bëjë atë nga zyra, si kishte bërë dikur.

Përfshirja e grupeve të ndryshme të interesit në proceset e planifikimit dhe zhvillimeve urbane e njohur në botë si "planifikimi gjithpërfshirës" ka filluar që në të '70-tat, atëherë kur paradigma moderne po venitej dhe kur platforma të reja të komunikimit dhe planifikimit do të shfaqeshin si nevojë e përfshirjes së zërave të shumtë e të ndryshëm për një të ardhme të përbashkët. Përfshirja e komunitetit në bërjen e vendit ishte diçka që filloi ta rizgjonte qytetin dhe shpirtin e tij të fjetur. Ishte diçka që gradualisht filloi të rindërtojë ndjenjën e përkatësisë së komuniteteve për vendin, duke qenë se ata tashmë kishin mundësi të ishin pjesë e një rrugëtimi të përbashkët të zhvillimit të copëzave të qytetit të tyre. Por jo vetëm, edhe bizneset lokale dhe grupet e tjera shoqërore kishin mundësi të gjenin vendin e tyre në kornizën vizionare për të ardhmen e vendit, lagjes apo qytetit të tyre tashmë, duke kornizuar edhe investimet dhe interesat e tyre vetjake përbrenda një interesi të përbashkët publik. Ideja që në procesin e planifikimit dhe të zhvillimeve urbane të përfshihen komunitete që kanë ndikim në plan dhe ata që ndikohen nga plani bënë që të krijohet një platformë komunikimi për një konsensus

mbi të ardhmen dhe interesin e përbashkët, ku secili ka çfarë të thotë dhe për të dhënë.

Në këtë kontekst të ri autoritetet lokale zhvendosin fokusin e tyre nga ofruesit e shërbimeve tek menaxhimi i resurseve dhe mundësive për shërbime edhe jashtë kornizave institucionale për ta mundësuar zhvillimin e përbashkët të qytetit.

Kosova në këtë rrugëtim është mjaft vonë duke qenë se këto lloj procesesh të hapura dhe gjithpërfshirëse për qytetin filluan të promovoheshin tek pas luftës së fundit. Korniza e re ligjore për Planifikimin Hapësinor më 2003 promovoi planifikimin strategjik si mundësi për t'i orientuar dhe menaxhuar zhvillimet urbane, komunale edhe në gjithë territorin e Kosovës. Sipas këtij ligji dhe akteve të tjera nënligjore, procesi i planifikimit duhet të jetë i hapur dhe përfshirës që nga identifikimi i çështjeve dhe diagnoza urbane e deri të vizioni për të ardhmen. Shpeshherë ndodh që procesi të jetë i hapur dhe të ketë debat publik në lidhje me ndonjë plan për zhvillimin e qytetit apo rregullimin e ndonjë lagjeje, por ato përfundojnë me komunikim njëdrejtimësh, me një gjuhë teknike profesionale dhe me një ekspozë hartash e grafikonesh që shpesh për qytetarët duken të largëta, të panjohura, të palexueshme e ndonjëherë edhe të pakuptueshme.

Në anën tjetër, është e rëndësishme të ceket se në legjislacionin kosovar për planifikim mungon edhe një hallkë që do ta obligonte arkitektin dhe planerin që në zhvillimet e pjesshme në shkallë më të vogël urbane, por njëkohësisht më të prekshme për komunitetin, përfshirja e tij të jetë e obligueshme. Duke qenë se Plani Zhvillimor Urban është një dokument vizionar, i cili

orienton zhvillimet e një qyteti për një periudhë afatgjate, janë planet rregulluese ato, të cilat në shkallë më të vogël sjellin rregullat dhe kriteret për orientimin e zhvillimit të ardhshëm apo rregullimin e lagjeve të dikurshme, tani në transformim. Këto plane janë baza ligjore për të lëshuar leje për ndërtim në nivel qyteti, por atëherë kur shfaqet plani i nivelit urb-arkitektonik, procesi ngec dhe shpesh implementimi i planeve është i pamundur po ashtu. Kjo po bën që urbanizmi në qytetet tona të humbet çdo ditë duke qenë se "kemi ngecur shumë prapa në bërjen e vendeve, të hamendur pas ndërtimeve sa më të mëdha", siç thoshte White dikur.

Autoritetet lokale duken si të dorëzuara para kësaj pamjeje të re të zhvillimeve të pakontrolluara, të cilat kanë filluar t'ia zënë dritën vetë qytetit duke minimizuar gjithnjë e më shumë hapësirën publike në shërbim të komunitetit.

"Si ta rikthejmë vendin"?!...

Duket sikur njerëzit kanë harruar se jeta në qytet ka vlerën dhe peshën më të madhe në hapësirat e përbashkëta, në hapësirat publike aty ku qyteti feston, zhurmon, frymon dhe jeton. Dhe pikërisht në këto procese të bërjes së këtyre hapësirave, ku ata socializohen, dashurohen, argëtohen apo çfarëdo tjetër, përfshirja e tyre mungon. Zakonisht dizajni i hapësirave publike, parqeve apo bulevardëve në Kosovë është bërë përmes kompanive të angazhuara nga autoritetet lokale, të cilat më shumë fokus a kanë vetë dizajnin dhe elementet e tij, sesa procesin. Ka raste kur peizazhin urban në përgjithësi e përcakton ndonjë

“kompani për pastrim” të qytetit apo ndonjë tjetër që kultivon fidanë, e cila po ashtu është e angazhuar nga autoritetet lokale. Rasti i dytë është më se drastik pasi përveç qytetarëve, këtu jashtë procesit është edhe komuniteti profesional për një gjë të tillë.

Sidoqoftë, situata nuk është krejt bardhë e zi. Ka raste edhe të disa lëvizjeve nëpër qytete të Kosovës, ku me iniciativa nga shoqëria civile apo vetë komuniteti kanë filluar të bëhen ca zhvillimeve të pjesshme për përmirësimin e hapësirave publike dhe krijimin e një peizazhi të ri urban.

Do të dëshiroja të ndaja me ju eksperiencën time me OJQ “Project for Public Spaces (PPS)” nga Amerika, që nga viti 1975 “kanë ndihmuar komunitetet për të krijuar hapësira publike aktive dhe vitale” gjithandej nëpër botë, përmes procesit të hapur të vizionimit dhe zhvillimit të tyre. Ata besojnë se “procesi i përfshirjes publike, i cili definon dhe u përgjigjet konditave të komunitetit dhe nevojave që nga fillimi është një nga faktorët më kritikë në dizajnin e hapësirës publike” (PPS). Kjo qasje duket shumë e rëndësishme për ta pasi që njëkohësisht “ka fuqizuar ndër vite traditën e pjesëmarrjes publike në çështjet e qeverisjes si praktikë demokratike”.

Të përkrahur nga Rockefeller Brothers Fund, PPS erdhi në Kosovë më 2009, pas një eksperience në rajon prej më se 15 vjetësh. Ideja e PPS-së për Kosovë ishte zhvillimi i kapaciteteve dhe pilot-projekteve. U zhvilluan dy projekte, ai në Pejë me OJQ-të nga rajoni i Dukagjinit dhe qendrën e rinisë “Zoom” në formën e një punëtore njëditore mbi platformën e PPS-së si metodë apo komizë planifikimi dhe mundësi implementimi në kontekstin kosovar, si dhe pilot-projekti në Gjilan, parku “Arbëria”.

Parku “Arbëria”

Procesi për parkun “Arbëria” ka nisur në mars 2009, kur së bashku me PPS-në bëmë një vrojtje në terren pasi që kryetari i Komunës së Gjilanit na komunikoi për zonën e përcaktuar për trajtim. Lokacioni “Arbëria” i njohur në Gjilan si “ish-tregu i gjedheve” ishte një djerrinë, një hapësirë e gjithkujt dhe e askujt njëkohësisht. Analizat e para në terren na bënë të njoheshim më për së



Planifikimi gjithpërfshirës në Kosovë

afërmi për tiparet e hapësirës, relacionin e saj me lagjen dhe me qytetin e Gjilanit.

Më pas, në maj 2009, është mbajtur punëtorja e parë me pjesëmarrës të ndryshëm nga komuniteti, biznesi lokal dhe shoqëria civile, që punuan në tri grupe për të dalë më pas me listat e çështjeve, nevojave dhe kërkesave të tyre për t'i adresuar në të ardhmen. Në korrik 2009, u mbajt takimi i dytë me komunitetin dhe aktorët e tjerë për të diskutuar rreth listës finale të çështjeve dhe shtrirjes së tyre hapësinore. Në shtator 2009, në takimin e tretë publik u prezantua diagrami hapësinor apo vizioni për parkun “Arbëria” për të cilin u arrit konsensus në mes palëve. Pas një procesi prej 6 muajsh, Kuvendi Komunal në Gjilan miratoi në parim vizionin për parkun “Arbëria”. Për PPS-në kjo ishte njëkohësisht edhe arritje e qëllimit të tyre dhe përmbyllje e fazës së projektit të tyre pasi fokusi i punës së tyre është procesi deri te konsensusi mbi vizionin e hapësirës dhe programin e përmbylljeve bazuar në çështjet e identifikuar me komunitetin. Ky dokument apo kjo komizë programore tani mund t'i shërbente Komunës së Gjilanit si udhërrëfyes për ta zhvilluar procesin teknik tutje me aktorët lokalë profesionalë.

Procesi i vizionimit të parkut me komunitetin bëri që ata të jenë të zëshëm dhe aktivë në kërkesat e tyre për vazhdimin e fazës së dytë të projektit, që tashmë veç është në proces. Gjatë këtij rrugëtimi aktorë të tjerë kanë shprehur interesin të jenë pjesë e tij. Komuniteti mysliman pretendon të ndihmojë në zbatim për shkak të interesit që ka për hapësirën e sheshit përballë xhamisë, e cila ka një oborr minimal dhe të pamjaftueshëm. Njëkohësisht aktorë nga biznesi lokal kanë

treguar interesim për pjesëmarrje dhe Kuvendi Komunal i Gjilanit pretendon të zhvillojë disa investime të pjesshme aty përmes komizës së Partneritetit Publiko-Privat (PPP). Përfshirja e bankave përmes fondit të tyre për komunitete në krijimin e hapësirave – dhe këndeve për lojëra të fëmijëve do të jetë evidente po ashtu. Së fundi edhe “UN-Habitat” do të jetë pjesë e rrugëtimit të këtij parku në idenë e promovimit të zhvillimit të hapësirave të qëndrueshme në procesin e implementimit të tij. I tërë ky proces ka ndikime të shumta në lidhjen e komunitetit me vendin, rritjen e përgjegjësisë karshi tij, mirëmbajtjes dhe dashurisë për të. Njëkohësisht ky lloj procesi fuqizon dhe ndihmon zhvillimin dhe promovimin e institucioneve të hapura dhe demokratike, të cilat janë afër qytetarit dhe për qytetarin. Një rrëfim i suksesshëm si ky për procesin e vizionimit dhe bërjes së parkut “Arbëria” mund të jetë një mësim i mirë për të gjithë ne si pjesëmarrës në procesin e planifikimit dhe zhvillimit të qyteteve tona. Vetëm në këtë formë do të mund të ndërtonim një të ardhme të përbashkët, ku secili nga ne ka rolin, rëndësinë dhe përgjegjësinë e vet në mozaikun e një mjedisi që përmbyll kërkesat tona si komunitet përballë procesit të ndërtimit të një imazhi që do të na identifikonte kënaqshëm dhe me dinjitet edhe si shtet. Për ta mundësuar këtë proces tutje në qytetet e tjera dhe për t'u ndihmuar planerëve komunalë në këtë drejtim është përkthyer në gjuhën shqipe doracaku nga PPS me titull: “Si ta ringjallim një vend”, në mars 2011, nga OJQ “UrbaniaK” nga Prishtina.

(Autorja ka master në arkitekturë dhe vendbanime njerëzore)

ZHVILLIMI I PLANIFIKUAR HAPËSINOR - INDIKATOR I NIVELIT TË VETËDIJES KOLEKTIVE - PRO- GRESIT SHOQËROR

IDA. Elvida Pallaska



Prishtina 1965

Hapësira është resursi më i çmuar gjatë gjithë kohërave, për të cilën gjithmonë është luftuar dhe me mjete moderne luftohet edhe sot. Nuk mund të quhen të rastësishme manipulimet edhe sot me hapësirën, dhe madje në emër të planifikimit të saj. Edhe pse në shekullin 21, vetëm mjetet janë ato që dallojnë nga e kaluara për arritjen e pronësisë/zotërimit mbi një hapësirë, prej atyre luftarake dikur, në ato paqësore të formatit elektronik, zigzageve ditore politike sot.

E mbroj tezën me të cilën planifikimi hapësinor është dhe do të mund të përdoret si instrument për matjen e nivelit të vetëdijes kolektive në një vend, qeverisjes së mirë dhe nivelit të demokracisë.

E mbroj tezën se planifikimi/zhvillimi hapësinor-urban është politikë dhe e kundërta, dhe po qe se planifikimi- zhvillimi hapësinor dhe urban është efikas, në atë vend zhvillohet politikë e mirëfilltë, ka qeverisje të mirë dhe ka demokraci, dhe e kundërta!

Si do të duhej të ishte!

Të ndihemi mirë, të lumtur, të gëzuar, të sigurt! Në aspektin e zhvillimeve të rrethinës sonë ku jetojmë, shohim rezultate pozitive çdo ditë, të cilat i prekim, i përjetojmë, duke shkuar në shkollë, shtëpi, punë, në këmbë apo dhe me automobil. Të kemi pamje të lirë nga dritaret çdo ditë në mëngjes, që të japin optimizëm, ku dielli bie në dhoma pa u ndalur nga ndërtesat,

nga tymi e bloza, sikurse dhe që zogjtë cicërojnë.

Të ndihemi të sigurt për fëmijët tanë të vegjël dhe adoleshentë, për prindërit e moshuar, përderisa kanë ku të dalin, të luajnë, të hedhin mënjanë melankolinë, në mëngjes, mesditë apo pasditeve, verë apo dimër, në natyrë të hapur urbane apo jo. Të kemi të vetmen sfidë në familje: Ku do ta kalojmë pasditen apo fundjavën, në cilin park të qytetit, me roshulla apo biçikletë, trotinet apo këmbë, në këtë park nacional apo në tjetrin, në këtë liqe apo atë basen, në këtë apo atë shfaqje teatrore, në kinema, të angazhohemi në këtë apo atë aktivitet vullnetar-shoqëror, të cilat të bëjnë të ndihesh krenar për atë që ke bërë!

Të jenë rrugët pranë shtëpive tona të gjëra për veturat e tëra dhe ne të lirë të ecim nëpër trotuare, të shtyjme karrocën e fëmijëve për në parqe dhe sheshe të shumta të qytetit, të ngrohemi pa ndjenjë faji se kemi prerë drunjtë, të kemi rrugë të ndriçuara gjithandej, t'i shohim fytyrat e baballarëve tanë dhe tonën menjëherë pas tyre, krenarë për arritjet në shoqërinë kosovare, jetën dinjitoze..., pa drojë, pa vuajtje, pa ndotje.

Të na mbledhin zyrtarët tanë nëpër sallat e shumta të bashkësive lokale apo dhe të komunës, për të na pyetur për nevojat, kërkesat dhe mundësitë që së bashku të qepim një të ardhme të bukur dhe të sigurt për të gjithë në qytet. Ne flasim të lirë dhe të motivuar, dëgjohemi me vëmendje

dhe e dimë se vendimet që u morën janë më e mira e mundshme ... për të gjithë NE!

"Plani" u bë, është bërë sipas masave, kërkesave, nevojave tona. Ne u zotuam se do ta përkrahim një zbatim të tillë të planit dhe se do të kontribuojmë përderisa ata që zgjedhëm kryejnë punën e tyre, zbatuan projektet me përpikëri dhe përgjegjësi të plotë!

Të gjithë në planet ndihemi mirë, të lumtur, të sigurt me rrethinën ku jetojmë!

Po sot?

Jemi të pakënaqur çdo ditë me të papriturat në mëhallën, qytetin tonë, komunën tonë. Ndihejmë të pasigurt dhe të indinjuar çdo ditë për dhe me rrethinën ku jetojmë, me ata që munden dhe nuk e kanë prioritet të mbrojnë rrethinën tonë të jetesës!

Rrugë dhe trotuare të stërmbohura me vetura, pasiguri në kalimin e rrugës, beton dhe asfalt të shumtë në vend të gjelbërimit, restriksione të pakontrolluara të energjisë elektrike, semaforë që s'punojnë, ndërtesa që zënë hapësirën përmbi trotuar, prerje të drurëve nëpër rrugë të qytetit deri në trung, prerje të gjithë trungut për hir të një kioske aty pranë, prerje të një pylli të tërë shumëdekadash për hir të ndërtimit të bllokut kolektiv, prerje e gjithmbarshme e drurëve vetëm për ngrohje dhe jo për ndonjë industri përpunuese të drurit,

Prishtina 2008 (Burimi: IPH)





Fotografi ajrore e Prishtinës

ndotje e shumëllojshme mjedisore, gllabërim i pamatshëm i hapësirës... Në emër të zhvillimit (lexo: ndërtimit).

Ne sot në Kosovë përjetojmë ndërrime enorme dhe të shpejta të pamjeve të qytetit, ndërrime AD HOC dhe me inercion....

Askush nuk e pyet qytetarin, ndërsa debatet publike si instrument i transparencës dhe dëshmisë së gjithëpërfshirjes, aty ku do të duhej të shpalosej versioni i mundshëm dhe më i mirë i planit, janë shumë formale dhe shkel e shko dhe bëhen vetëm sa për raportet e procesverbaleve, një detyrimi ligjor.

Në anën tjetër, edhe as që mund të flasim për zbatim të planeve, të cilat nuk shërbejnë në praktikë, p.sh. planet hapësinore, edhe pse do të duhej të ishin pasqyra të planeve zhvillimore të komunave, të përdoren për hartimin e strategjive zhvillimore të komunave, planeve vjetore të punës, krijimin e projekt-buxheteve vjetore si faza të zbatimit të planeve, ato përdoren për të përbushur një detyrim ligjor, për të pasur dhe një tender më shumë në dispozicion...

Në anën tjetër, përderisa planet nuk përdoren, ato keqpërdoren në Kosovë,

ndryshohen në emër të planifikimit dinamik dhe strategjik dhe mundësive për të ndryshuar ato në bazë të "arsyetimit të bazuar" e të shumëfishtë që natyrisht në Kosovë gjithmonë "mungon"....

Natyrisht, kur bie fjala për ndryshimet AD HOC të planeve, do bëjmë një analogji me avokatët e mirë, të cilët shfrytëzojnë zbrazëtitë, dykuptimësinë e ligjeve për të fituar rastet gjyqësore, përderisa planerët së bashku me zyrtarët komunalë ndryshojnë në masë të madhe planet hapësinore dhe urbane, në mënyrë joprofesionale dhe të qëllimshme për përfitime konkrete.

Kjo ndodh në shumicën e komunave të



Vizionimi i të ardhmes

Kosovës, duke shfrytëzuar zbrazëtitë në Ligjin për Planifikim Hapësinor, mungesën e akteve të tjera juridike përcjellëse të ligjit, dykuptimësinë dhe paqartësitë në planet hapësinore-komunale-urbane, duke i shfrytëzuar këto "denjesisht" për ndryshime të shumta për interesa private, interesa të klasës së elitës politike, pra duke ndryshuar në përqindje të madhe planet e APROVUARA nga vetë kuvendet e tyre komunale.

Në takimin e një forumi të planerëve, me temën "Ç'ka me procesin e legalizimit të objekteve ilegale në Kosovë", ku pas fakteve të shumta është parë nevoja urgjente e përcaktimit dhe me Ligj për planifikim hapësinor, masa e lejimit të ndryshimeve të një plani hapësinor-komunal-urban dhe rregullues urban në emër të të njëjtit "plan" – hapësinor dhe urban".

Prej të njëjtit takim joformal të komunitetit të planerëve na doli nevoja dhe se do të duhej mbështetje e madhe politike si masë e parë, sikurse dhe caktimi i instrumenteve për matjen e përqindjes së ndryshimeve në një plan së bashku me zbatimin e tyre! Është ky një problem shumë akut dhe i rëndësishëm, duke iu referuar Kosovës, porse nuk dyshohet se ka qenë edhe për vendet e tjera në transicion!

P.sh. Një plan rregullues në një komunë në Kosovë, tani së fundmi e aprovuar nga Kuvendi Komunal (në formën elektronike), është ndërruar dy apo më shumë herë, varësisht prej nevojës për dhënien e lejeve urbanistike për disa banesa kolektive, përderisa fillimisht në versionin zyrtar të aprovuar në Kuvendin e Komunës, hapësira gjegjëse ishte hapësirë e lirë e gjelbër.

Natyrisht që ne sot e dimë se çka mund të bëhet me programet CAD dhe GIS, nëse një version final i planit të aprovuar në Kuvendin Komunal nuk ruhet në kopje të fortë, nuk është i shtypur, i lidhur, i vulosur dhe arkivuar për të shërbyer si referencë për çdo ndryshim të mëvonshëm, porse gjithmonë leja e dhënë i referohet, planit "zyrtar" të ndryshuar, përderisa shoqëria civile hesht... dhe kjo u konvenon zyrtarëve...

Fenomeni i tillë ndoshta merr dhenë, përderisa ripërtëritja -mbindërtimi i planeve është paraparë me ligj të jetë çdo pesë vjet. Ky mbindërtim i planit vetëm se do të duhej

pastaj t'i përshtatej gjendjes së ndërruar dhe të krijuar për çdo ditë.

A thua pas një kohe do të na interesojë më se kush përfiton dhe kush humb në këto raste? A thua dukuritë e tilla nuk e kanë shty popullatën në apati kolektive, me pasoja të mosdaljes në zgjedhje lokale dhe qendrore në të ardhmen, me mosaktivitet të tyre në formë të organizuar si shoqëri civile, sepse edhe njashtu askush nuk qan kokën për ta?


Shtetet e zhvilluara kanë shoqëri të avancuara

Shoqëritë e avancuara janë të gjithëpërfshira që nga fillimi i procesit të planifikimit, kërkojnë transparence në përmbushje të interesave të shumicës së shoqërisë, janë aleatë porse dhe mjet apo "qen vëzhgues", të qeverive të tyre. Kështu do të duhej të ishte edhe në Kosovë, ku shumica e shoqërisë e përfaqësuar përmes grupeve të organizuara të interesit apo dhe si individ, të kenë rol në çdo ndryshim, zbatim, monitorim të planit.

Nëse diçka e paplanifikuar ndryshon kursin e zhvillimeve pa inkuadrimin e shoqërisë, punët nuk do të duhej të shkonin mirë, si për udhëheqësit menaxherë të planifikimit, porse edhe për udhëheqësit politikë.

Në kontekst të zbatimit të planeve, llogaridhënies dhe ndikimeve në politikën ditore, njëra ndër sfidat sot në botën e zhvilluar është nëse më shumë ndikon politika ditore e ndjekur nga zyrtarët në baza ditore¹, apo e politikanëve me një kurs më të gjatë veprimi!

Ja pra pse është planifikimi hapësinor-



Trekëndëshi ekonomik i Kosovës

urban efikas: politikë e mirëfilltë e cila zgjedh të bëjë qeverisje të mirë, duke respektuar demokracinë, parimet e saj, porse në të kundërtën aty ku nuk ka demokraci nuk ka qeverisje të mirë dhe nuk ka planifikim efikas. Sipas kësaj kemi tautologjinë: "Planifikimi efikas hapësinor-urban paraqet nivelin e lartë të demokracisë në një vend"!

Kosova në kushtet e transicionit dhe të

lëkundjeve politike e shoqërore ende nuk përkrah institucionalisht procesin e planifikimit në vend, duke u nisur nga fakti se planifikimi hapësinor ende NUK është prioritet, edhe pas një dekade të pasluftës! Në një rast z. Cendrowicz - zyrtar për çështje të Kosovës në Drejtorinë për Zgjerim të Komisionit Evropian, përgjigjës për hartim të Raportit të Progresit për Kosovën, në pyetjen nëse planifikimi hapësinor është temë për vlerësim, po ashtu është përgjigjur pozitivisht, duke shtuar se vlerësohet dhe (dis)kursi i caktimit prioritet nga Qeveria e Kosovës! Përderisa plani i suksesshëm është progres, përmbushje interesash dhe objektivash për të cilat është sajuar, gjithëpërfshirës dhe i përkrahur, do të kishim $1+1=3$, pra dhe minimum një përmbushje më shumë prej të planifikuarave, përderisa ne në Kosovë sot kemi gjithsesi $1+1<2$.

(Autorja ka titullin magjistër për menaxhim dhe zhvillim urban)




Demokracia në proces!

¹ P.sh. me ndryshimin e planit pa konsensus apo kontroll, apo me (mos)dhënien e lejeve si detyrë të përditshme.

ZHVILLIMI RAJONAL NË KOSOVË

Inxh. i dipl. i ark.
Faton Deva



Vështrim nga aspekti i Planifikimit Strategjik Hapësinor në Kosovë dhe me interes të përafritimit dhe anëtarësimit në Bashkimin Evropian (apo të respektimit të rregullativës së BE-së në shtetet anëtare)

Cilat janë nivelet e planifikimit në Kosovë?

Në Kosovë, sipas Kushtetutës, kemi dy nivele të administrimit. Bazuar në Ligjin për Planifikim Hapësinor me nr. 2003/14 dhe Ligjin për ndryshimin e tij me nr. 03/L-106, për hapësirën e tërë dhe të caktuar territoriale të tyre, hartohen planet strategjike: hapësimore për nivelin qendror dhe zhvillimore e urbane për nivelin komunal (lokal).

Çka është planifikim strategjik?

Planifikimi strategjik, për dallim nga ai gjithëpërfshirës dhe me destinim të sipërfaqeve, sikur edhe në të gjitha vendet e zhvilluara, hartohet mbi sfida dhe çështje, gjegjësisht treguesit (indikatorët) e tyre të caktuar. Këta indikatorë tregojnë nivelin e arritur për informatën e caktuar, nga cilado qoftë fushë tematike (sociale, ekonomike, mjedisore) apo të sektorëve të ndryshëm brenda tyre. Sikur në gjithë botën, edhe në Kosovë, treguesit e tillë, janë më të besueshëm kur sigurohen dhe ofrohen nga regjistrimi zyrtar i popullsisë dhe të mirave materiale, nga autoriteti qendror i statistikave. Po ashtu tregues të besueshëm llogariten edhe të dhënat që dalin nga hulumtimet – studimet shkencore dhe nga anketimet e ndryshme të bazuara në informatat të sigurta zyrtare, e që nuk mund të

sigurohen drejtpërdrejt nga autoriteti i lartcekur.

A ka ndarje të saktë të rajoneve statistikore në Kosovë?

Për fat të mirë apo të keq, në Kosovë mund të hartohen plane strategjike për dy nivelet e përmendura (qendror dhe komunal), bazuar në legjislacionin në fuqi dhe në grumbullimin e të dhënave të sigurta statistikore. Planerët (por edhe politikanët) kosovarë, nëse duan të hartojnë një plan - projekt strategjik për zhvillim (ngritjen pozitive të vlerës së ndonjë indikatorit) të një rajoni (zone) të caktuar, nuk mund të jenë të sigurt se kanë të dhëna të besueshme. Arsye për këtë është procesimi i mëtejshëm i të dhënave që mirren në nivelin komunal, gjegjësisht grupimi joadekuat (jorelevant) i tyre nëpër rajone të përcaktuara nga Enti Statistikor i Kosovës (ESK). Momentalisht grupimet e të dhënave (informatave) nëpër rajone janë të trashëguara dhe paraqesin parregullsi, sepse janë të ndara në 7 rajone për disa sektorë të caktuar, kurse për sektorët e tjerë ndahen edhe në 6 e 5 sosh. Kjo parregullsi është e nevojshme të rregullohet, gjë që vërtetojnë edhe kërkesat e ESK-së të kamotshme dhe të adresuara deri në Qeveri dhe Parlament të Kosovës, për ndarjen e saktë dhe zyrtare të rajoneve statistikore.

Si funksionon kjo në shtetet anëtare të BE-së?

Në aspektin e përafritimit me BE-në, sikur në të gjitha shtetet anëtare të kësaj familjeje evropiane, edhe aktivitetet e Qeverisë së Republikës së Kosovës duhet

të jenë në pajtueshmëri dhe përputhshmëri të plotë me politikat dhe rregullativat e kësaj bashkësie. Në këtë rast duhet theksuar nevojën dhe kërkesën për ndarjen e territorit të Kosovës në numër të saktë të rajoneve, për fillim me statusin e rajoneve statistikore, që në BE janë të njohura si NUTS – Numenclature Units for Territorial Statistics.


Siq dihet, informatat merren nga zonat më të vogla (lagje, bashkësi lokale, fshat etj.), mirëpo zyrtarisht, për nivel më të Ulët Lokal Administrativ – LAN (Local Administrative Numenclature) të grumbullimit të të dhënave është niveli komunal. Prej këtu grumbullimi i të dhënave dhe ndarja e tyre në rajone statistikore ka hierarkinë e vet, nisur nga niveli celulë më i ulët lokal/komunal drejt atij më të lartë/qendror. Pra, nga LAN që janë komunat, duke u ngritur në rajone statistikore - hapësirë më e gjerë lokale (me domethënie rrethi ose qarku - sikur në anglisht që është county), që shprehet me shkurtesën NUTS-3 dhe përbëhet prej disa komunave. Nivel tjetër i ndarjes së informatave në rajone statistikore është edhe ai që shprehet me shkurtesën NUTS-2, i cili prapë mund të jetë lokal, por që është paksa më i gjerë dhe në përbërje të të cilit janë dy (2) ose më shumë rajone të nivelit NUTS-3. Zakonisht, për nivelin qendror/shtetëror si rajon statistikor, rezervohet niveli i përcaktuar me NUTS-1 dhe NUTS-0, njëkohësisht që është territori i tërë vendit dhe përbëhet prej disa rajoneve të kategorizuara si NUTS-2 (apo në rastin kur edhe NUTS-2 është i rezervuar për nivel qendror, atëherë me NUTS-3

përfundon niveli lokal). Përjashtim kanë vendet që janë shumë të mëdha (për nga numri i popullsisë dhe territori) apo janë federata që i përkasin shkallës më të lartë të rajonit statistikor NUTS-0, ku brenda territorit të tyre janë disa hapësira më të gjëra ose shtete (si p.sh. në Gjermani që janë landet) që përcaktohen për rajon statistikor me shkurtesë NUTS-1.

A duhet të ndodhë kjo ndarje edhe tek ne?

Gjithsesi, sikur në të gjitha shtetet anëtare të BE-së, ashtu edhe në ato kandidate dhe pretenduese të integritimit në të, edhe Kosova herët a vonë medoemos duhet të organizohet dhe të përcaktojë ndarjen e rajoneve statistikore. Sa për kuriozitet, Kroacia ka zyrtarizuar ndarjen e territorit saj në NUTS-a si shtet pretendues-kandidat, disa vjet para Sllovenisë e cila paraprakisht ishte anëtare e Bashkimit Evropian. Pse të mos shfrytëzohet mundësia e përgatitjes së plan-projekteve për konkurrim në fondet e përbashkëta zhvillimore, të adresuara sipas emërtimeve të politikave të ndryshme të BE-së, si: rajonale, rurale, të kohezionit territorial, rrjeteve të trafikut dhe të kryeqendrave, zhvillimit të balancuar, ndër dhe tejkuftare, ndër-rajonale e të tjera, nga Republika e Kosovës?

Para së gjithash, këtë ndarje rajonale duhet organizuar jo vetëm për konkurrim në fondet e përbashkëta për zhvillim, por pse është kërkesë e BE-së, sidomos e rrjetit të qendrave statistikore evropiane EUROSTAT (*European Statistics*) dhe rrjetit mbikëqyrës për planifikim hapësinor evropian ESPON (*European Spatial Planning Observation Network*), gjegjësisht rrjetit të pasqyrimin të gjendjes së të gjithë treguesve (indikatoreve) hapësinorë në tërë territorin e Bashkimit Evropian. Të gjitha hartat e prodhuara deri më tani nga ESPON, me të cilat shërbehen të gjitha shtetet anëtare të BE-së, i ka të mbështetura dhe janë punuar në bazë të indikatorëve (të dhënave) statistikore për nivelin rajonal NUTS-2 dhe NUTS-3. Shkurtimisht, nëse tërhiqet një paralele



Skema e ndarjes së Kosovës në zona sipas potencialeve dhe karakteristikave të ngjashme zhvillimore (Burimi: IPH)

për nga roli, përgjegjësia dhe detyrat, sikur EUROSTAT-i dhe ESPON-i që janë për nivelin evropian, ashtu janë edhe ESK-ja (Enti Statistikor i Kosovës në MAP) dhe IPH (Instituti për Planifikim Hapësinor në MMPH) për nivelin kosovar. Prapëseprapë nuk duhet ngurrar për ndarjen e rajoneve statistikore në Kosovë, të cilat nuk duhet të jetë gjithsesi edhe administrative për fillim, kurse ndërkohë mund të ketë përgjegjësi dhe rol vendimmarrës për projektet dhe planet e caktuara për atë rajon. Krijimi i miniansambleve rajonale, që realizohet përmes dërgimit të delegatëve nga komunat përkatëse e fuqizon rolin vendimmarrës. Përfaqësimi apo delegimi i këshilltarëve komunalë, nga secila komunë pjesëmarrëse në rajonin e caktuar statistikor, arrihet duke u bazuar në numrin e popullsisë brenda, si kriteri i vetëm për ndarje rajonale, që është edhe në shtetet anëtare të BE-së.

Cila është ndarja logjike e rajoneve statistikore në Kosovë sipas BE-së?
Ndarja e Kosovës në tetë ($7 + 1 = 8$) rajone, për nivelin NUTS-3, është i mbështetur në rregullativën e BE-së

dhe logjikën e thjeshtë. Së pari, për arsye të ekzistimit, funksionalizimit të rregullt të 7 qyteteve më të mëdha të Kosovës me komunat përreth tyre dhe (plus) të një kryeqendre urbane (me disa komuna të ndara brenda saj), do të plotësonte edhe kriterin e vetëm (ndarjen e rajoneve për nga numri i popullsisë), gjë që përdoret në shtetet anëtare të BE-së.

Cilit dokument mund t'i referohemi për nismën e kësaj ndarjeje rajonale?

Në dokumentin e aprovuar nga Qeveria dhe Parlamenti i Kosovës - Plani Hapësinor i Kosovës 2010 – 2020+ (që është rishikim i PHK 2005 - 2015), në kapitullin III - Korniza e zhvillimit hapësinor që shpreh parashikimin e dëshiruar për zhvillimet hapësinore në Kosovë ndërtohet mbi konceptin dhe strukturën e zhvillimit dhe organizimit të ardhshëm hapësinor.

Me konceptin e zhvillimit të ardhshëm hapësinor (PHK faqe 121 dhe 122) Kosova ndahet në katër zona tipike, të cilat janë caktuar në bazë të disa karakteristikave të përbashkëta për këto zona. Këto tipare paraqesin llojllojshmërinë dhe në të njëjtën kohë janë unike për secilën nga to, sikurse

janë: potencialet zhvillimore, karakteristikat gjeografike dhe veprimtaritë socio-ekonomike që zhvillohen në këto zona. Emrat e këtyre zonave paraqesin një identitet të caktuar që ngërthejnë disa karakteristika të tyre, kurse në hartë prezantohen me ngjyra të caktuara, siç janë:

- Thesari i Kosovës (Hapësira e gjelbër) - industriale, shërbyese tregtare – paraqet pjesën veriore të Kosovës të përbërë nga komunat: Mitrovica, si qendër kryesore, Vushtrria, Skënderaj, Zveçani, Leposaviqi dhe Zubin-Potoku, si komuna më të vogla, të cilat gravitojnë në Mitrovicë.
- Porti i Kosovës (Hapësira e kaltër) - administrative, shërbyese, tregtare, agroindustriale, turistike – paraqet pjesën veriore të Kosovës të përbërë nga komunat: Prishtina, si kryeqendër e Kosovës dhe qendër kryesore, Obiliqi, F.- Kosova, Podujeva, Drenasi, Lypjani dhe Shtimja, që gravitojnë në qytetin e Prishtinës, rajonale.
- Urat e Kosovës (Hapësirat e verdha) - shërbyese tregtare, agroindustriale e turistike - paraqesin pjesët juglindore dhe jugperëndimore të Kosovës, të përbërë nga komunat: 1) Ferizaj, Shtërpçë, Kaçanik, Gjilan, Viti, Novobërdë dhe Kamenicë, në qendër me qytetet e Ferizajt dhe Gjilanin; 2) Gjakovë, Deçan, Rahovec dhe Malishevë në qendër me qytetin e Gjakovës.
- Kopshtet e Kosovës (Hapësirat e portokallta) - kulturore-turistike, shërbyese tregtare, agroindustriale paraqesin pjesët perëndimore/veripe-rëndimore dhe jugore të Kosovës, të përbërë nga komunat: 1) Pejë, Klinë dhe Istog, me qytetin e Pejës në qendër; 2) Prizren, Suharekë dhe Dragash, me qytetin e Prizrenit në qendër.

Konkludim!

Përfundimisht, përveç interesit të integritetit në BE, kjo ndarje rajonale statistikore duhet të ndodhë edhe për shkak të padrejtësisë që po i bëhet Komunës së Ferizajt dhe asaj të Gjakovës, për konkurrimin dhe fitimin e projekteve

zhvillimore në Agjencinë për Zhvillim Rajonal, sipas së cilës territori i Kosovës është ndarë në pesë rajone. Kjo ndarje është e papranuar për popullin shumicë, sepse është trashëguar nga pushteti serb, i cili në pamundësi të qeverisjes në të gjitha qendrat rajonale, bëri përshtatjen e tillë me qëllim të sundimit më të lehtë. Kështu që, sa më parë që të mblidhen ekspertët profesionalë të lëmenjve përkatës (nga sektorët qeveritarë, asociacioni i komunave, Universiteti, biznesi, OJQ-të dhe shoqëria civile në përgjithësi) dhe të përcaktohet ndarja e territorit të Republikës së Kosovës në 8 rajone statistikore, për hir të zhvillimeve në të ardhmen. Insistimi në ndarje të rajoneve NUTS-3 (përderisa niveli i rajoneve NUTS-2 mbetet opsion, për t'u përcaktuar) që trajtohen dhe i përkasin nivelit lokal të menaxhimit dhe administrimit, nuk kërkon edhe ndryshime shumë të mëdha të legjislacionit në fuqi. Kurse niveli i rezervuar për nivel qendror, për tërë territorin e Republikës së Kosovës dhe masën e popullsisë së saj, mund dhe duhet të jetë njëkohësisht niveli i NUTS-1 dhe NUTS-0, gjersa prapë niveli NUTS-2 duhet përcaktuar në mes nivelit qendror dhe nivelit lokal, që mund të jetë ndarje në dy rajone më të gjëra gjeografike: Rrafshi i Dukagjinit dhe i Kosovës.

Megjithatë, do të duhej intervenuar paksa në Ligjin për Planifikim Hapësinor, të cilin edhe ashtu duhet plotësuar, ku përveç zhvillimit institucional të vetë IPH-së, si autoritet i vetëm koordinues qendror për planifikim dhe zhvillim hapësinor, duhet përfshirë edhe zhvillimin rural dhe ndarjen rajonale (të rretheve) si nivel të planifikimit dhe zhvillimit hapësinor. Atëherë, me kohë do të themelohen edhe njësitë rajonale për planifikim dhe zhvillim, me ekspertët profesionalë të përzgjedhur dhe përfaqësues nga IPH-ja dhe komunat përkatëse të rajonit të caktuar.

Prandaj, ndarja e rajoneve statistikore do të dukej kështu:

1. Rajoni i kryeqytetit me komunat përbërëse: Prishtina lindore, P. jugore, P. perëndimore dhe P. veriore (ose emërimet e veta sipas mëhallëve

më të mëdha për secilën zonë-komunë);

2. Rajoni i Prishtinës me komunat përbërëse: Prishtina, Obiliqi, F. - Kosova, Podujeva, Drenasi, Shtimja, Lypjani, Graçanica dhe Novobërda, që gravitojnë në Prishtinë, si qendër kryesore rajonale;
3. Rajoni i Mitrovicës me komunat përbërëse: Mitrovica, Vushtrria, Skënderaj, Zveçani, Leposaviqi dhe Zubin-Potoku, si komuna më të vogla të cilat gravitojnë në Mitrovicë;
4. Rajoni i Pejës me komunat përbërëse: Peja, Klina dhe Istogu, me qytetin e Pejës në qendër;
5. Rajoni i Gjakovës me komunat përbërëse: Gjakova, Juniku, Deçani, Rahoveci dhe Malisheva, në qendër me qytetin e Gjakovës
6. Rajoni i Prizrenit me komunat përbërëse: Prizreni, Suhareka, Mamusha dhe Dragashi, me qytetin e Prizrenit në qendër.
7. Rajoni i Ferizajt me komunat përbërëse: Ferizaj, Shtërpçë, Kaçanik, Han i Elezit, në qendër me qytetin e Ferizajt si dhe
8. Rajoni i Gjilanit me komunat përbërëse: Gjilani, Vitia, Klllokoti, Parteshi, Ranillugu dhe Kamenica, me qytetin e Gjilanin në qendër.


Përfundim.

Fuqizimi i tillë në Kosovë në rajone NUTS-3 (rrethe apo si në anglisht county-ies), me qendrat e tyre (Prishtina kryeqyteti, rrethi i Prishtinës, rr. i Mitrovicës, rr. i Gjilanit, rr. i Ferizajt, rr. i Pejës, rr. i Gjakovës dhe rr. i Prizrenit) do të lehtësonte grumbullimin dhe pasqyrimin e të gjitha të dhënave në një hapësirë të caktuar. Më tej, bazuar në këto të dhëna mund të bëhen strategjitë shtetërore, rajonale, sektoriale, e të tjera. Përfundimisht, hartohen plane dhe projekte të arsyeshme, të fuqishme dhe të pranueshme nga të gjithë – me të vetmin qëllim: të përmirësimit të gjendjes së treguesve që janë me nivel më të dobët në veçanti dhe të vetë jetës së qytetarëve në përgjithësi.

(Autori ka titullin magjister në planifikim hapësinor evropian dhe zhvillim rajonal)

MISIONI I ZHVILLIMIT URBAN

Flamur Kuçi



Zhvillimi i qendrueshem

Rëndësia e temave për urbanizimin është në rritje e sipër në debatet ndërkombëtare të profesionistëve dhe ato politike. Është evident procesi dhe ndikimi i tyre, për shkak të resurseve të limituara, të cilat janë brengë në rritje e shoqërive gjithandej në botë.

Kjo dukuri është duke u ndikuar në mënyrë të dukshme më shumë në vendet më pak të zhvilluara, me shkallë më të ulët të urbanizimeve krahasuar me vendet e zhvilluara.

Qëllimi i këtij artikulli është provokimi i lexuesit përmes disa pyetjeve për natyrë, orientimin dhe dinamikën e procesit të urbanizimit, i cili po lë shenjë në procesin e zhvillimit të vendeve, siç janë Shqipëria dhe Kosova. Artikulli elaboron shembujt në Shqipëri, por dhe vendos disa paralele me situatën në Kosovë. Në fakt, qëllimi është të shihet nëse ka ndonjë rëndësi në kontekst të Kosovës, e tëra ajo që ndodh në Shqipëri.

Shqipëria përjetoj ndryshime të mëdha dramatike të procesit të urbanizimit këta 20 vjet. Ndryshimet politike dhe ekonomike të cilat erdhën pas "erërave të ndryshimeve" në të 90-tat në Evropën Lindore, janë të njohura si reformat më sinjifikante të marra nga qeveria e orientuar drejt ekonomisë së lirë të tregut. Në fakt, reformat më sinjifikante të qeverisë demokratike të fillimit të viteve 90, fokusohen në procesin e privatizimeve të ndërmarrjeve joefikase shoqërore dhe të privatizimeve të tokës. Qëllimi ishte themelimi i bazës apo themeleve të ekonomisë së tregut. Liberalizimi i lëvizjeve të popullatës në vend pasoi me proces frenetik të urbanizimit të orientuar drejt qendrave

urbane të mëdha në pjesën qendrore dhe perëndimore të vendit. Evidente është se procesi i reformimit drejt ekonomisë së lirë të tregut shtrihet mbi disa realitete të vendosura nga kriza e vitit 1997, dështimet e tipit të "skemave piramidale" dhe e cila ka evoluar në krizë politike dhe institucionale.

Sido që të jetë, në 10 vjetët e fundit Shqipëria hyri në një fazë të stabilizimit solid dhe të integritit në Unionit Evropian, duke pranuar se është në kohë të re të zhvillimit ekonomik dhe institucional të vendit.

Kosova kaloi nëpër spirale të ndryshme të ngjarjeve, edhe pse ka ngjashmëri sinjifikante me formatin ekonomik, institucional dhe politik të Shqipërisë. Kosova doli nga procesi i shpërbërjes së Jugosllavisë, (ku, për shkaqe historike, nuk ndihej kurrë pjesë e saj), e përcjellë nga ngjarjet dramatike, sikurse ishin pastrimi etnik nga regjimi i Milosheviqit drejt popullatës shqiptare. Kosova angazhohej në reforma, për të konsoliduar pavarësinë me një qëllim të qartë të të qenit në një të ardhme pjesë e Komunitetit Evropian.

Të dyja vendet ballafaqohen me sfidat e ekonomisë konkurrenente të bazuar në sektorët prodhues dhe sektorët e shërbimeve. Të dyja vendet kanë pothuajse industri të shkatërruara (edhe pse deri në 5 vjetët e fundit kemi disa shenja të përmirësimit) të industrisë së rëndë.

Procesi i urbanizimit ishte me rëndësi në të dyja vendet. Edhe pse pikat fillestare ishin të ndryshme, procesi i urbanizimit shënoi një zhvillim për 20 vjetët e fundit.

Është evidente se urbanizimi imponon ndryshime të konsiderueshme në rindërtimin e infrastrukturës dhe ristrukturimin e sistemit menaxhues të infrastrukturës dhe shërbimeve. Në anën tjetër, procesi i urbanizimit ka përfshirë energji të konsiderueshme në investime në rajonet qendrore.

A thua planifikimi luan rol në ndryshimet në Shqipëri? Në fakt është shumë me rëndësi të kuptohet nëse planifikimi bën ndonjë ndryshim në procese zhvillimore, në realitetet e Shqipërisë dhe të Kosovës. A i ka planifikimi mjetet e nevojshme dhe të përshtatshme për sfidën e zhvillimit? A është në fakt menaxhimi i planifikimit ai i cili influencon zhvillimin ekonomik të qyteteve tona? Apo ndoshta do të duhej të ndërrojmë dhe adoptojmë mjetet për një sistem planifikimi efikas?

Shqipëria dhe Kosova vijnë nga një sistem rixhid i planifikimit centralist. Resurset ekonomike dhe të shpërndarjes, infrastruktura dhe investimet sikurse dhe elementet bazikë të zhvillimeve urbane ishin të planifikuara në nivelin qendror. Sistemi komunist (edhe pse në Shqipëri e shprehur në mënyrë më ortodokse, përderisa Jugosllavia adoptonte politika dhe instrumente më liberale), të bazuara këto në një planifikim rixhid centralist, duke penguar elementet bazë të ekonomisë së lirë të tregut. Qasja e adoptuar rezultoi me dështim (posaçërisht në rastin e Shqipërisë) të ekonomisë, për shkak të pamundësisë së ekonomisë socialiste të konkurrojë me ekonominë globale apo të paktën të ndërli dhej me tregjet globale.

Gjatë procesit të transicionit nuk i është dhënë shumë rëndësi dhe mund iniciativave të planifikimit. Në fakt, qytetet shqiptare u ballafaquan me përvojën e transicionit në një mjedis ku nuk udhëhiqnin rregullat dhe udhëzimet. Një pjesë e madhe e popullatës deri në vitet '90 që banonte në viset malorë-rurale, lëshoi këto vendbanime duke u drejtuar drejt qendrave urbane në kërkim të jetës më të mirë, punësimit dhe mundësive për arsim.

Toka. Reformat e ndërmarra të tokës në kohën e transicionit patën për qëllim privatizimin sa më të madh të tokës bujqësore dhe asaj urbane, sikurse dhe të shtëpive për të themeluar bazën e tregut të lirë të tokës, sikurse dhe të patundshmërive në vend. Në fakt, reformat rezultuan me themelimin e sektorit të gjallë të menaxhimit të patundshmërive, kryesisht të udhëhequr me kërkesa të mëdha të procesit të urbanizimit. Sido që të jetë, fragmentimi i tokës pati për pasojë zhvillimet e pabalancuara.

Sistemi i shfrytëzimit të tokës kryesisht ka shërbyer në orientimet dhe shtrimin e mënyrës për proceset e ndërtimit,



Planifikimi gjithëpërfshirës për zhvillim të qëndrueshëm

zakonisht jo në bashkëpunim dhe për interes publik. Në fakt, sistemi ka akomoduar nevojën për ndërtim dhe patundshmëri, përderisa i tërë procesi neglizhonte interesin publik për hapësira publike, shkolla, çerdhe, fusha të sportit dhe rekreacionit. Mund të thuhet se sistemi i planifikimit urban ka ofruar modele ku interesi privat (në shumë raste temë e spekulimit) ka mbizotëruar interesin publik.

Banimi. Sektori i ristrukturuar i banimit kishte për qëllim ndërrimin e rolit të qeverisë nga ofruesi direkt i banimit në ndërmjetësin e shërbimit, për të mirën e krijimit të bazës së banimit që është i përballueshëm në veçanti për personat me të ardhura të ulëta. Roli i kapaciteteve organizative të qeverisë është i madh. Në mungesë të kapaciteteve të tilla, banimi mund të bëhet më pak i qasshëm, duke pasuar me një eksplodim të qasjes së "ofrimit vetjak", i cili rezultoi me kualitet të ulët të ofrimit të banimit, zakonisht në mënyrë joformale dhe ilegale.

Zhvillimet joformale. Shqipëria ka diku rreth 320.000 objekte joformale/ilegale. Diku rreth 250.000 nga to i janë qasur reformës së legalizimit, e cila dështoi, edhe pse vetëm në 3 vjetët e fundit janë ndërtuar rreth 80.000 më shumë. Në fakt, dukuria është vetë rezultati i dështimit të ofrimit të banimit dhe sistemit të planifikimit urban. Përderisa të dyja sistemet nuk krijojnë banim të përballueshëm dhe zhvillim të balancuar të tokës, qarku vicioz i modelit të ndërtimeve joformale do të predominojë dhe do të fusë në rezik qëndrueshmërinë e zhvillimit urban në vend.

Infrastruktura. Përderisa shumë mund është bërë për procese të decentralizimit, kapacitetet e qeverisë lokale mbesin të ulëta. Në fakt, investimet dhe menaxhimi i infrastrukturës është ende sfidë, posaçërisht për qeverinë lokale. Në këtë



Konkurset për zgjidhje dhe dizajn urban për studentë, organizuar nga Bashkia Tiranë



Ferizaj (Burimi: IPH)

kontekst sistemi fiskal pëson shumë vështirësi në ofrimin e mbulimit real të shpenzimeve operacionale, duke mos përmendur këtu mirëmbajtjen dhe investimet kapitale. Strukturës së zhvillimit të tokës i nevojitet ndryshimi në mënyrë që më mirë të shpërndajë përfitimet e zhvillimit përderisa gjeneron resurse të përshtatshme për ofrimin e mbulesës së infrastrukturës dhe shpenzimeve të shërbimeve.

Mjedisi. Procesi i urbanizimit dinamik dhe frenetik është i shoqëruar me një shprehi neglizhuese ndaj mjedisit. Në fakt, ndryshimet e viteve '90 e zënë shoqërinë shqiptare në një mungesë totale të edukimit për çështjet mjedisore për shkak të formatit ekonomik të Shqipërisë, ku nuk ka pasur debate për mjedisin. Shumë shpejt shoqëria shqiptare mësoi për shpenzimet dialektike, shumë shpesh konfliktuoze, ndërmjet zhvillimit dhe mjedisit.

Zhvillimi ekonomik. Reformat e ndërmarra në periudhën e transicionit rezultuan me hapjen e ekonomisë shqiptare në ekonomi globale. Evidente është se reformat e ristrukturimit kanë gjeneruar rritje ekonomike (në shkallën fillestare me rritje dyshifrore). Sfidat e

Shqipërisë në ndryshimin rapid prej gjenerimit në konsolidimin e rritjes ekonomike. Sido që të jetë, duhet të thuhet se planifikimi urban kurrë nuk është parë me rëndësi për rritjen ekonomike. Ky miskonceptim e ka origjinën në kuptimet e ngushta të ndërtimeve fizike dhe planifikimit urban tradicional.

Konkluzion

Transicioni nga sistemi centralist i planifikimit ekonomik dhe politik, në ekonomi të lirë të tregut dhe sistem demokratik, ishte kompleks dhe pa diskutim i komplikuar. Ndërrimi prej qasjes së planifikimit rixhid ishte i përcjellë nga një 'laissez-faire'. Të dyja modelet, me një rezultat shumë të dallueshëm, jo gjithmonë ai që ofron zhvillim ekonomik dhe mirëqenie.

Mjetet e sistemit të planifikimit urban nuk janë të mjaftueshme për t'u marrë me sfida në rritje, të procesit të urbanizimit. Në fakt, instrumentet e planifikimit urban nevojitet të jenë të qëndrueshme, me kapacitete organizative të përshtatshme, të qeverisë qendrore dhe lokale.

Detyrat e planifikimit urban duhet t'u shërbejnë qëllimeve të investimeve publike dhe private, dhe mos t'u shërbejnë vetëm qëllimeve të ngushta të procesit të ndërtimit.

Planet urbane duhet të ofrojnë modele të gjithmbarshme të organizimit të hapësirës, porse dhe më shumë; duhet të jenë të përshtatshme për organizimin e veprimeve të nevojshme për krijimin e qendrave, me kualitet të jetës.

Pikë me rëndësi është adresimi i planifikimit urban si një mjet kompleks (I) për të gjeneruar rritje ekonomike dhe punësim (II) mbrojtje dhe zhvillim të mjedisit (III) ofrimin të bazës për zhvillim të balancuar të tokës private dhe publike; Duke integruar këto dimensionet, në sistemin e planifikimit urban përmes këndvështrimit të përgjithshëm të zhvillimit urban, i cili do të mundësonte që planifikimi urban të bëjë një ndryshim në procesin e zhvillimit ekonomik, social dhe mjedisor në shoqëritë si Shqipëria dhe Kosova.

(Autori ka master në Menaxhim Urban, Këshilltar i Zëvendëskryeministrit E. Haxhinasto-Shqipëri)



Gjakova (Burimi: IPH)

RËNDËSIA APO INJORIMI I PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE URBAN NË KOSOVË

Ark. Hidajete Zhuri



Kuvendi i Kosovës, miratimi i dokumenteve strategjike zhvillimore

Të arriturat e Bashkimit Evropian në fushën e zhvillimit hapësinor janë udhërrëfyes i shkëlqyeshëm për zhvillim të mjediseve urbane në hapësirat tona. Nëse synimi ynë vërtet është integrimi në Evropë, atëherë na duhet një sistem cilësor i planifikimit hapësinor dhe urban. Vendet anëtare të Bashkimit Evropian nuk kanë qasje unike ndaj planifikimit hapësinor, por ekzistojnë disa parime të përbashkëta që ndiqen nga të gjithë, e që përmblidhen në dokumentin “Perspektiva Evropiane e Zhvillimit Hapësinor” (ESDP). Këto parime janë: kohezioni social dhe ekonomik; ruajtja dhe menaxhimi i trashëgimisë natyrore dhe kulturore, si dhe konkurrenca e balancuar e territorit evropian.

Me gjithë faktin se nuk ka karakter detyrues, ESDP është dokument i nënshkruar nga ministrat përgjegjës për planifikim rajonal të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, që flet për ndikimin e këtij dokumenti në politikat e planifikimit hapësinor në rajonet e Evropës dhe në shtetet anëtare, duke krijuar kështu parakushte për zhvillim të qëndrueshëm dhe të balancuar të territorit evropian.

Prandaj, planerët duhet ta kuptojnë në thelb shprehjen “zhvillim i qëndrueshëm”, e cila pasqyrohet në të kuptuarit e sistemit të vlerave, mënyrës së jetesës, raportit ndaj burimeve natyrore dhe mjedisit jetësor, dhe, në përgjithësi, raportit ndaj hapësirës dhe mënyrës së jetesës në të.

Tani, nga planifikimi hapësinor evropian përqendrojmë vëmendjen në nivelin tjetër – planifikimin urban në Kosovë. Theksi duhet vënë në disa vlera, sepse, mosnjohja ose injorimi i tyre bën që

procesi i zhvillimit urban të rezultojë me hapësira urbane jofunksionale dhe jokualitative.

Situata aktuale në Kosovë mund të karakterizohet si kaotike, përkatësisht si kohë e fundit që ato pak hapësira dhe resurse të mbetura të ruhen, kurse ato të degraduarat të rehabilitohen.

Në vitet e para të administratës ndërkombëtare në Kosovë, nuk mund të pritej që planifikimit urban t'i jepej prioritet, pasi që fokusi ishte tek çështjet emergjente. Dëshira e individëve për të ndërtuar, pavarësisht dëmit që i shkaktonte mjedisit dhe pronës publike, nuk u pengua nga administrata e atëhershme. Tepërcia e energjisë individuale për të kompensuar mungesat e së kaluarës nga njëra anë dhe paaftësia e institucioneve për të kanalizuar këtë energji, nga ana tjetër, në një mjedis me kornizë ligjore të mangët dhe institucione në ndërtim e sipër, pa dyshim se u reflektua edhe në zhvillime të paplanifikuara dhe të pakontrolluara urbane. Në funksion të planifikimit e menaxhimit hapësinor dhe urban u ndërtua korniza institucionale dhe ligjore. Në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor u themelua Departamenti i Planifikimit Hapësinor (viti 2002), Instituti për Planifikim Hapësinor (viti 2003), si dhe u hartua Ligji për Planifikim Hapësinor, Ligji i Ndërtimit, udhëzimet administrative që plotësonin këto ligje, e ligje dhe institucione të tjera.

Dokumentet e planifikimit hapësinor dhe urbanistik

Me gjithë vështirësitë e mëdha, zbatimi i ligjeve është i domosdoshëm. Problemet

urbane, si trafiku i ngjeshur, transporti urban, ndërtimet ilegale, papunësia dhe shumë të tjera, adresohen edhe përmes planeve hapësinore dhe urbanistike.

Edhe pse me vonesë, janë aprovuar disa plane hapësinore dhe urbanistike të nivelit qendror dhe lokal. Pas shumë përpjekjesh dhe prolongimesh, këtë vit Kuvendi i Kosovës ka aprovuar Planin Hapësinor të Kosovës, si plan strategjik multisektorial, i cili përcakton qëllimet afatgjata të planifikimit hapësinor për territorin e Kosovës për periudhën 15-vjeçare. Ndërkaq, në nivelin lokal plane hapësinore dhe urbanistike kanë aprovuar edhe komunat e Pejës, Gjakovës, Gjilanit, etj. Vlen të përmendet se plane të tilla ka edhe komuna e Junikut, edhe pse e krijuar vetëm dy vjet më parë. Megjithatë, ka ende komuna që nuk kanë hartuar planet e tyre hapësinore. Edhe pse nxjerrja e tyre është obligative brenda afatit të caktuar kohor, në ligj nuk parashihi masa ndëshkuese për vonesat apo moshartimin e tyre.

Për zona të caktuara të qyteteve të Kosovës janë hartuar dhe prezantuar në debate publike disa plane rregulluese urbane, të cilat, sipas përkufizimit, do të duhej të ishin plane të detajuara për sipërfaqet e banuara ose zona të tjera në të cilat parashihet të ndërtohet. Nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës janë aprovuar disa prej tyre, në mesin e të cilave “Vellusha”, “Qyteza Pejton”, “Dardania”, “Lakërishte” etj.

Mirëpo, sa korrespondojnë këto plane me realitetin? A mund të zbatohen me nivelin e hartuar? A i janë nënshtruar ndonjëherë mbikëqyrjes gjatë procesit të hartimit? Ka edhe pyetje të tjera që

kërkojnë përgjigje.

I tërë procesi dhe përgjegjësitë deri në aprovimin e planeve rregulluese urbane janë të përshkruara në Ligjin për planifikimin hapësinor. Mirëpo përmbajtja, si dhe mënyra e prezantimit të planeve të hartuara në të shumtën e rasteve nuk janë në përputhje me kushtet e përcaktuara ligjore, bile, shumë herë edhe me gjendjen ekzistuese të sipërfaqes për rregullim. Pse? Ndoshta buxheti i ulët që parashihet për hartimin e tyre mund të jetë njëri prej shkaktarëve për mungesë cilësie. Sidoqoftë, pa marrë parasysh cilësinë, ato plane aprovohen dhe, si të tilla, mbesin në sirtarë, të pazbatueshme. Duke synuar që, në një afat sa më të shkurtër kohor, të arrihet deri tek produkti, çfarëdo qoftë ai, anashkalohen apo formalisht kalohen hapa të tërë, të rëndësishëm në zinxhirin e planifikimit. Shmangia nga planifikimi gjithëpërfshirës, si dhe mospërfshirja apo përfshirja formale e qytetarëve në procesin e identifikimit të problemeve dhe adresimit të nevojave të tyre, ka rezultuar me zgjidhje të paarsyeshme dhe të paqëndrueshme. Po ashtu, dialogu në mes të përfaqësuesve të autoriteteve qendrore, lokale, ekspertëve të fushës së zhvillimeve urbane, si dhe vetë qytetarëve nuk rezultojnë të jetë produktiv, pasi që palët e përfshira nuk identifikohen qartë me interesat e tyre dhe nuk i mbrojnë ato në masë të duhur dhe me argumente të duhura. Kjo mungesë e kulturës së dialogut, si dhe niveli i ulët i transparencës dhe llogaridhënies bëjnë që planet të jenë të pazbatueshme dhe askush të mos përgjigjet për anomali të tilla.

Hartimi i planeve të zbatueshme është sfidë e vërtetë, sepse procesi i planifikimit kërkon qasje shumëdimensionale dhe përgjegjësi nga të gjithë aktorët. Një proces i menaxhuar mirë kërkon nga niveli lokal të ketë një strategji të elaboruar të komunikimit me qytetarë, duke i konsultuar ata për zgjidhjet konkrete, si dhe duke organizuar informim në masë të gjerë përmes medias së shkruar dhe elektronike. Po ashtu, debatet publike me qytetarë, ekspertë dhe faktorë të tjerë duhet të moderohen në mënyrë profesionale, për të siguruar që pjesëmarrësit të japin kontributin e tyre, duke i shprehur interesat e vërteta të

grupeve që përfaqësojnë.

Ndërkaq hartuesit e planeve duhet t'i respektojnë kërkesat ligjore për përmbajtjen dhe paraqitjen grafike të planit, përfshirje të komunitetit në fazat e hershme të procesit të hartimit të planit, deri në arritje të konsensusit, bashkëpunim me aktorët e nivelit lokal dhe qendror, si dhe kriteret e transparencës.

Niveli qendror (MMPH) do të duhej të organizonte diskutim me aktorët kyç për pengesat e mundshme ligjore gjatë procesit të hartimit të planeve rregulluese urbane, adresimit të tyre, mbikëqyrje inspektuese gjatë procesit të hartimit të planit, etj.

Kontrolli i zhvillimeve

Që prej një viti e gjysmë funksionon Komisioni i përbashkët MMPH-MAPL për shqyrtimin e ligjshmërisë së akteve të nxjerra nga kuvendet komunale në fushën e planifikimit urban dhe rural. Zinxhiri i informimit dhe raportimit të obliguar në nivele të ndryshme duhet të jetë në shërbim të përcjelljes së vazhdueshme dhe mbarëvajtjes së çdo iniciative për zhvillime të planifikimeve urbane nëpër komuna. Mirëpo, ka vështirësi të sigurohen informata për të gjitha zhvillimet, pasi jo të gjitha komunat raportojnë për punën që bëjnë. Kështu p.sh. Komisioni ka pranuar akte nga disa komuna, mirëpo asnjë nga Komuna e Prishtinës, edhe pse dihet se Kuvendi Komunal ka nxjerrë disa vendime të kësaj fushe. Kjo tregon se planifikimi urban është një fushë ku duhet të punohet më shumë në zbatimin e ligjit.

Injorimi institucional apo...?

Me gjithë angazhimin për ndërtimin e bazës institucionale dhe ligjore për planifikimin hapësinor dhe urban, problematika e kësaj fushe nuk trajtohet në dokumente zhvillimore të Kosovës të nxjerra në vitet e fundit, duke mos e njohur kështu rëndësinë e tij për të ardhmen e vendit. As Kushtetuta e Republikës së Kosovës nuk i referohet planifikimit hapësinor, për dallim nga Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme, në të cilën përcaktohet përgjegjësia në këtë fushë. Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2011-2014, mbështetet në katër shtylla

kryesore, e që janë: 1) Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik; 2) Qeverisja e mirë dhe fuqizimi i sundimit të ligjit; 3) Zhvillimi i kapitalit njerëzor; si dhe 4) Mirëqenia sociale. Në shtyllën e parë të këtij programi radhiten synimet e Qeverisë për partneritete publike dhe private, në mesin e të cilave edhe përmbushja e kërkesave për shërbime publike nga autoritetet komunale në transport urban, parkingje publike, sport, rekreacion dhe kulturë, si dhe mbledhje të mbeturinave. Mirëpo, edhe pse një plan hapësinor apo urbanistik do të duhej t'i paraprinte vendosjes së këtyre partneriteteve, në Programin e Qeverisë planifikimi hapësinor dhe urban nuk adresohet në asnjërën prej katër shtyllave. Në Planin Zhvillimor Strategjik të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor 2011-2014, i miratuar nga Qeveria në korrik të vitit 2011, në mesin e tetë objektivave strategjike, fuqizimi i planifikimit hapësinor radhitet si i treti. Mirëpo, me strukturën e re organizative të MMPH-së, që është bartëse e këtij Plani, parashihet shkrija e Departamentit të Planifikimit Hapësinor dhe Departamentit të Ndërtimit dhe Banimit, gjë që ndikon në zvogëlimin e kapacitetit të Ministrisë për ta menaxhuar një aspekt të rëndësishëm të funksionimit të saj, i cili, për ironi, është edhe pjesë e emërimit të Ministrisë. Thënia e njohur "të dështosh në planifikim do të thotë të planifikosh dështimin", edhe pse zhvilluar nga komuniteti i biznesit në vitet '70, gjithsesi vlen edhe për planifikimin hapësinor dhe urban. Këtë e ka dëshmuar përvoja e deritanishme në Kosovë, ku mungesa e planeve të tilla ka rezultuar me kaos urbanistik në qytete, ndotje të mjedisit, degradim të tokës bujqësore dhe të pyjeve, kufizim të mundësive për të ndërtuar rrugë cilësore, e shumë e shumë efekte të tjera negative që ndikojnë në cilësinë e jetës së qytetarit dhe në potencialin e vendit për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror.

(Autorja punon në Departamentin e Planifikimit Hapësinor, në Ministrinë e Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor)

ZHVILLIMI NËPËR HISTORI I HAPËSIRËS PUBLIKE NË KOSOVË

Ark. Ilir Gjinolli



Sheshi publik në Pejë

Hyrje

Hapësira publike në përgjithësi kuptohet si një hapësirë në të cilën mund të tubohemi me të tjerët në mënyrë të lirë në baza të barabarta brenda kornizës ligjore. Hapësira publike karakterizohet me të hapurit e saj. Çdo pjesëtar i saj në princip mund të marrë pjesë në çdo gjë që ndodh aty, varësisht nga ajo se çka ai ose ajo zgjedh. Hapësira publike nuk është e hapur vetëm për njerëzit e mëdhenj. Ajo u takon të gjithëve në mënyrë të barabartë - të gjithë së bashku janë pronarë të saj. Hapësira publike qeveriset nga ligji e jo nga individë ose entitete.

Viteve të fundit vlera e hapësirës publike ka arritur deri te nivelet më të larta të politikës. Interesi nga majat e larta të politikës reflekton perceptimin e shtuar për hapësirën publike si përkushtim publik. Po ashtu tashmë ekzistojnë dëshmitë se hapësira publike mund të sjellë një numër përfitimesh – qofshin ato ekonomike, sociale dhe mjedisore.

Në përgjithësi, krijimi i hapësirës publike i atribuohet nevojës për:

- Hapësira publike si zonë e zhvillimit të veprimtarive ekonomike – tregti dhe shërbime.
- Hapësira publike si hapësirë e kulturës dhe ngjarjeve publike
- Hapësira publike si hapësirë e rekreacionit
- Hapësira publike si hapësirë reprezentative.

1. ZHVILLIMI NËPËR HISTORI I HAPËSIRËS PUBLIKE NË KOSOVË

1.1 ZANAFILLA - Ndërtimi i strukturës urbane është i kushtëzuar, pa dyshim, me

krijimin e hapësirës publike, gjegjësisht me ndarjen e hapësirës private nga ajo e dedikuar për publikun. Në shumicën e qyteteve të Kosovës është e mundur të dallohet shtresimi historik i formave të hapësirës publike karakteristike për periudhat e ndryshme të zhvillimit historik nëpër të cilat kanë kaluar ato.

Meqenëse të gjitha qytet e Kosovës, me formën dhe lokacionin të cilin e hasim sot, janë themeluar në periudhën e Perandorisë Otomane, gjeneza e hapësirës publike mund t'u atribuohet në radhë të parë nevojave themelore të qytetarëve për veprimtaritë ekonomike, siç janë tregtia dhe zejtaria në njërin anë dhe nevojave të tjera, si religjioni, shërbimet e tjera publike – administrimi, arsimit rekreacioni dhe ato ekonomike – si pazaret, bezistanet dhe hanet, të cilat ndërtoheshin nga të ardhurat publike përmes vakëfit – 'waqf' - në një tërësi të quajtur 'kyllije' (turq. külliye) - tërësi). Një kyllije përmbante xhaminë, rreth së cilës ndërtoheshin medreseja, spitali, biblioteka, hamami, hani, bezistani, dhe zhvilloheshin format themelore të hapësirës publike - çarshia - rruga tregtare/zejtare dhe pazari-tregu i qytetit.

1.2 PERIUDHA PASOTOMANE - në mes dy luftërave, sjell në qytetet kosovare një transicion të cilin nuk e shkaktoi vetëm lufta dhe nënshtrimi i Kosovës prej Serbisë, por edhe ndryshimi i sistemit ekonomik shoqëror i vetë Perandorisë Otomane, meqenëse lidhjet ekonomike, sociale dhe kulturore nuk ishin shkëputur me ish-Perandorinë – Republikën e Turqisë. Në këtë periudhë krijohen

hapësirat e para publike si hapësira për kulturë dhe ngjarje publike.

1.3 PERIUDHA PAS LUFTËS SË DYTË BOTËRORE - në periudhën e socializmit, në ish-Jugosllavi, gjatë modernizimit janë paraqitur tri forma të intervenimit në hapësirë – janë zhvilluar pjesë të reja të qytetit në formë të aneksimit të territorit, është transformuar struktura ekzistuese urbane ose është rikonstruktuar dhe rivalizuar indi i vjetër urban sikur në rastin e Çarshisë së Gjakovës.

Në këtë periudhë hapësira publike zgjerohet edhe me hapësirën publike të rekreacionit dhe ato reprezentative të qytetit, me qëllim të madhështimit të shtetit socialist të dedikuar jo për individin, por për 'shoqërinë'.

Ndërtimet e reja kanë sjellë kryesisht format e hapësirës publike të qytetit modernist, të cilat kanë qenë të përqendruara më shumë në dimensionin fizik dhe vizual, dritën dhe insolinin, pa e marrë parasysh dimensionin perceptual dhe social dhe nevojën e interaksioneve në mes njerëzve – shoqërimi, komunikimi, involvimi në aktivitetet, të cilat ndodhin në hapësirën publike. Këto veçori mund t'i shohim nëpër lagjet e planifikuara të banimit në Prishtinë dhe qytete të tjera. Ajo që në shumicën e rasteve është rezultat, është mungesa e njerëzve dhe rrjedhimisht mirëmbajtja.

2. PROBLEMET AKTUALE TË QYTETEVE NË LIDHJE ME HAPËSIRËN PUBLIKE –

Transicioni pas luftës në vitin 1999 ka sjellë fazën e tretë të modernizimit –



Sheshi publik në Pejë

liberalizimin në zhvillimin urban. Liberalizimi zakonisht sjell pak ndryshime të organizuara në strukturën historike urbane. Në qytet kosovare zhvillimi liberal i qytetit nga organet lokale të qeverisjes nuk është menaxhuar në mënyrë të suksesshme. Kjo është shkaktuar kryesisht nga vështirësitë në zbatimin e ligjeve të aplikueshme dhe ndikimit të grupeve të caktuara të interesit, të cilat nuk kanë lejuar kontrollin e ndërtimit.

2.1 GABIMET NGA E KALUARA

Të gjitha qytetet e Kosovës ballafaqohen me gabimet nga e kaluara, të shkaktuara nga luftërat, ndryshimi i sistemit ekonomik shoqëror, rënies ekonomike, sociale dhe kulturore. Këto ndryshime janë manifestuar përmes ndërtimit stihik-pa plan ose me plan, por pa vizion, duke ndërtuar të renë mbi të vjetrën. Moskuptim i rëndësishë së ruajtjes së trashëgimisë së ndërtuar arkitektonike dhe urbanistike ka shkaktuar humbjen masive të indit historik urban, përfshirë edhe hapësirën publike – posaçërisht çarshinë, si hapësirën themelore të interaksionit social në mes njerëzve.

E pamirëmbajtur, shpesh me ndërtime të shëmtuara, e atakuar nga uzurpues dhe mjetet motorike të qarkullimit, hapësira publike merr konotacionin 'problem i tjetërkujt' (Douglas Adams).

2.2 SPEKULIMET ME PRONËSINË MBI TOKËN

Për shkak të mungesës së kornizës së

qartë ligjore për kthimin/kompensimin e pronave të cilat janë marrë në periudha të ndryshme të qeverisjes në Kosovë, është dëmtuar edhe hapësira publike. Në shumë raste, prona të tilla, të cilat kanë qenë hapësira publike, u janë rikthyer pronarëve në mënyrë spekulative dhe në to janë ndërtuar ndërtesa, me çka janë rrudhur edhe më shumë hapësirat publike të qytetit.

2.3 NDËRTIMI STHIK LIBERAL

Zhvillimi stihik liberal i qytetit ka shkaktuar ndërtimet me standarde shumë të ulëta. Sa i përket kualitetit të ndërtimit dhe indeksit të ndërtimit – relacioni sipërfaqja e ndërtuar dhe sipërfaqja e lirë. Sipërfaqja e lirë ngel shumë e vogël. Ajo shërben vetëm për futjen e vijave të infrastrukturës nëntokësore dhe krijimin e korridoreve të qarkullimit kryesisht të dedikuar për qarkullimin motorik, kurse njerëzit zakonisht mbeten të 'padukshëm' gjatë planifikimit të saj.

2.4 HAPËSIRAT E PUSHTUARA PUBLIKE

Në periudha transicioni nëpër qytete është e zakonshme dukuria e pushtimit të hapësirës publike. Në mungesë të sundimit të ligjit, uzurpohet hapësira publike për përfitime personale ose grupe me ndërtime të përkohshme ose të 'përhershme'. Edhe në Kosovë ka ndodhur një dukuri e tillë. Por pushtimi më drastik i hapësirës publike vjen nga automobili, duke marrë hapësirë për

qarkullim dhe parkim nga hapësira publike dhe duke e shndërruar hapësirën sociale në hapësirë qarkullimi. Shtimi i automjeteve pas luftës në Kosovë u ka sjellë qeverive komunale probleme të mëdha pasi që nuk kanë arritur të ofrojnë zgjidhje të suksesshme për qarkullimin e këmbësorëve, qarkullimin dhe parkimin e automjeteve.

2.5 RIMARRJA E HAPËSIRËS PUBLIKE

Pas ndryshimeve të sistemit ekonomik shoqëror, qytetet kanë trashëguar edhe hapësira të degraduara dhe të tilla që u janë tretur funksioni. Rimarrja e hapësirës publike kryesisht është orientuar në hapësirat e uzurpuara dhe të pushtuara nga automobili.

Në përgjithësi, në lidhje me uzurpimin e hapësirës publike, ajo që në qytetet e Kosovës ka filluar ngadalë të bëhet praktikë, është kthimi dhe kujdesi ndaj hapësirës publike të uzurpuar dhe të keqtrajtuar nga qeveritë komunale. Megjithatë në hapat e saj fillestarë, qeveritë komunale e konsiderojnë të domosdoshme rimarrjen e hapësirës publike për shfrytëzim nga publiku dhe për publikun. Kjo ka të bëjë edhe me përfitimet politike, sepse çdo përmirësim në sektorin publik prek në ndërgjegjen e qytetarëve dhe pritjet që ata kanë nga qeveria për të cilën ata kanë votuar. Janë disa zhvillime të tilla që mund të konsiderohen si shembuj suksesi në pikëpamje të nxitjes së interesit për hapësirën publike.

- PRISHTINË - Shndërrimi i bulevardit "Nënë Tereza" në Prishtinë në një shëtitore të lirë nga trafiku motorik - një projekt i papërfunduar në tërësi, por që mund të konsiderohet si një nga sukseset më të mëdha të qeverisjes komunale në lidhje me hapësirën publike. Përfitimi nga ky transformim ka qenë i shumëfishtë – në aspektin social, qytetarët kanë përfituar një hapësirë ku mund të ecin lirshëm, të komunikojnë, të pushojnë, të blejnë e po ashtu edhe të marrin pjesë në të gjitha ngjarjet, të cilat organizohen me rastin festave, panairove apo kremteve të tjera. Në aspektin mjedisor, ndotja



Sheshi Nënë Terezë

nga trafiku – tymi dhe zhurma gati janë eliminuar fare.

Në aspektin ekonomik, jo vetëm që janë rritur të ardhurat e bizneseve në bulevard, por edhe vlera e banesave dhe e hapësirës afariste është rritur shumëfish.

- PEJË - Shndërrimi i korzos së Pejës në zonë këmbësore dhe lirimi i bulevardit nga parkimi i automobilave. Megjithëse i kontestuar nga komuniteti i biznesit në atë pjesë të qytetit, ky transformim është treguar shumë i dobishëm në të gjitha aspektet –social, mjedisor dhe ekonomik, posaçërisht pasi që të gjitha dyqanet kanë pasur rritje të të ardhurave. Në këtë projekt të përkrahur nga "UN-Habitati" mund të lavdërohet procesi i pjesëmarrjes-sidomos konsultimet me komunitetin e biznesit, i cili ka pasur më së shumti dyshime për suksesin e projektit.

- GJILAN – Në Gjilan është duke u zhvilluar projekti i rregullimit të shtratit të lumit Mirusha që ka tre komponentë - komponentin mjedisor - kanalizimin e qytetit dhe krijimin e një brezi të gjelbër në tërë territorin e qytetit, komponentin social – në një gjatësi prej

4 km, bregu i lumit do të shndërrohet në një brez rekreacioni – ecje, vrapim, biçiklizëm dhe pushim, si dhe komponentin ekonomik, ku pronarëve do t'u lejohet hapja e bizneseve të vogla në përkrahje të aktiviteteve përgjatë lumit. Me gjithë mungesën e përkrahjes nga qeveria qendrore, qeveria komunale është e përkushtuar ta zbatojë këtë projekt edhe me mjete vetjake.

2.6 DIZAJNI

Derisa dëshira dhe idetë për përparimin e hapësirës publike në qytetet e Kosovës tashmë janë të pranishme edhe si politika të qeverisjes, kualiteti i dizajnit është ende në nivel shumë të ulët. Përgjashtuar disa raste të rralla, shumica e intervenimeve janë ad hoc, me dizajn sipërfaqësor dhe pa mbështetje në parimet bashkëkohore të dizajnit urban dhe dizajnit të peizazhit. Kualiteti i dobët buron nga mungesa e urbanistëve profesionistë dhe përvoja shumë e kufizuar në dizajnin urban. Në shumicën e rasteve është formal, jotransparent dhe i ndikuar nga procedurat rixhede të prokurimit publik. Konkursat e dizajnit urban, të cilat organizohen për këtë qëllim janë zakonisht me afate të shkurtra, me detyra jo të qarta dhe proces jotransparent

të përzgjidhjes nga vlerësues jokompetentë.

Komuna e Prishtinës e ka zhvilluar konkursin për "Sheshin e Pavarësisë" katër herë. Në konkursin e fundit propozimi i përzgjedhur ka fituar në konkurrencë me vetëm një propozim tjetër. Kjo tregon se mënyra e tashme e organizimit të konkurseve publike nuk është tërheqës për arkitektët dhe urbanistët. Kësaj duhet shtuar edhe një mungesë. Prishtina, si kryeqytet i një shteti të ri evropian, do të duhej që për projekte të rëndësishme publike të organizonte konkurse ndërkombëtare për projekte të rëndësishme publike. E ngjarjet e tilla janë mundësi e mirë e promovimit edhe të qytetit, por edhe të shtetit. Këtu duhet të konstatojmë se as projektet e financuara nga donatorë seriozë, si USAID, EC, UN-Habitat, nuk paraqesin ndonjë praktikë të suksesshme që mund të shërbejë si shembull në lidhje me procesin e dizajnit urban të hapësirës publike.

3. MENAXHIMI I HAPËSIRËS PUBLIKE

M.Carmona, në librin e tij mbi dimensionin e menaxhimit të hapësirës publike, konstaton se "...të gjitha

hapësirat publike, pa marrë parasysh sa janë gjithëpërfshirëse dhe demokratike, kanë nevojë për disa forma menaxhimi, të cilat mundësojnë realizimin e rolit të tyre në mënyrë efektive. Ideja e hapësirës publike dhe menaxhimit të hapësirës publike domosdo ndërlidhet me sektorin publik, gjegjësisht me qeverisjen lokale". Sipas tij, janë katër komponentë të menaxhimit që duhet t'i konsiderojnë qeveritë lokale:

a) Rregullimi i shfrytëzimit të hapësirës në mënyrë formale apo me praktika sanksionuese. Kjo nënkupton një kornizë rregulluese se si duhet të shfrytëzohet hapësira publike, të zgjidhen konfliktet në mes funksioneve të ndryshme dhe të përcaktohen se cilat sjellje lejohen në hapësirat publike e cilat jo. Si kuptohen rregullat dhe si mbështeten ato është me rëndësi vitale për hapësirën publike. Ky segment në qeveritë tona lokale ende nuk është rregulluar. Nuk ekzistojnë rregullore komunale me të cilat përcaktohet mënyra e shfrytëzimit të hapësirës publike dhe çfarë funksionesh mund të zhvillohen në cilin

vend, koha e shfrytëzimit dhe cilat janë përfitimet qoftë publike apo private. Komunitet p.sh. shpesh lejojnë ose ndalojnë shfrytëzimin e hapësirës publike për veprimtari ekonomike të lidhura me publikun, por asnjëherë nuk kanë mundur ta ndalonin parkimin në trotuar që duhet të konsiderohet uzurpim i hapësirës publike.

b) Mirëmbajtja e komponentëve fizikë të hapësirës publike. Kjo nënkupton hapësirën publike të shfrytëzueshme, të pastër dhe të sigurt, mirëmbajtjen e dyshemesë urbane, ndriçimit, gjelbërimit dhe të të gjitha pajisjeve të mobilierisë urbane. Përfshirë rastet e rralla, në përgjithësi hapësirat tona publike nuk janë të mirëmbajtura dhe shpesh i nënshtrohen edhe vandalizmit.

c) Investimet e reja në hapësirën publike dhe format e investimit, të cilat mundësojnë që hapësira të jetë gjithnjë tërheqëse dhe të ripërtërihet me intervenime të reja. Aktualisht nuk ka ndonjë praktikë të suksesshme, të provuar, të alokimit të resurseve financiare – qoftë nga buxheti i komunave apo i

përkrahur nga burime të tjera – partneritetet publiko-private apo kontributi i agjencive ndërkombëtare që përkrahin zhvillimin urban në domenin publik. Komunitet duhet ta gjejnë formulën për financimin e investimeve në ripërtëritjen e hapësirës publike duke shfrytëzuar të gjitha instrumentet që ia lejon procesi i projektimit të buxhetit komunal përfshirë format e partneritetit publik dhe koncesionet me investitorët privatë.

d) Koordinimi i intervenimeve në hapësirën publike - Ato që kemi pasur rastin t'i shihnim gjatë dhjetë vjetëve të kaluar shpesh kanë qenë edhe intervenimet jo të koordinuara në mënyrë direkte ose indirekte të personave dhe organizatave. Ky koordinim duhet të aplikohet në të gjitha nivelet dhe në të gjitha hallkat e qeverisjes – në kuadër të departamenteve të komunës, komunës dhe qeverisë qendrore, si dhe agjencive të zhvillimit dhe shoqërisë civile.

(Autori është arkitekt dhe drejton kompaninë URBAN PLUS në Prishtinë)



Sheshi Nënë Terezë

PËRPARËSITË E BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR DREJT ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM TË BALLKANIT PERËNDIMOR

Ark. Ilirjana A. Mejzini



Malet e Sharrit

Në çdo vend të botës kryeqytetet janë fuqia me shtytëse zhvillimore, ku është infrastruktura më e avancuar, ku popullsia produktive është më e koncentruar, ku mund të zgjedhen shkollat, kinematë, teatrot... "aty ku ndodh gjithçka". Lum për qytetet e afërta, sepse dosido ndikohen nga reciprociteti me kryeqytetin, por a është njësoj jeta atraktive edhe për komunitetin e vendbanimeve më periferike?! Kjo mëdyshje filloi të trajtohet qysh në vitet e shtatëdhjeta në vendet më të zhvilluara të Evropës. Komunitetet e qyteteve që ndodheshin më larg nga kryeqyteti filluan t'i hulumtonin mundësitë e përmbushjes së nevojave të tyre përmes iniciativave të bashkëpunimit ndërkufitar, me të cilat gradualisht arrihej eliminimi i barrierave kufitare, që rezultoi në zhvillime ndërrajonale dhe liri të plotë të lëvizjes në çdo cep të BE-së.

Nëse sipërfaqësisht prekim historikun e popujve të Ballkanit Perëndimor, kujt në botë do t'i shërbenin përvojat e tilla të bashkëpunimit, për thyerje të tabuve ndarëse, të cilat gjithherë vështirësuan jo vetëm lëvizjen e lirë, por edhe të të gëzuarit e të drejtave elementare të njeriut për jetë dhe punë. Edhe pse i pozicionuar në qendër të trekëndëshit Romë - Konstandinopol dhe Athinë, që simbolizon qendrën e civilizimit evropian, Ballkani Perëndimor ende identifikohet me nofkën "njollë e zezë" e kontinentit të vjetër. Arsyet janë të shumta, por falë inovacioneve për qasje në njohuri, po bëhen shumë të lehta për t'u kuptuar. Së pari, me shekuj ishte vendtakim i perandorive. Varësisht nga

"lëvizja" e vijës kufitare të perandorive, ndërrohej dhe imponohej edhe identiteti social i komuniteteve, bile-bile brenda një qyteti. Sa më shumë që shekujt lejonin kombinimet (variacionet) në mes të komponentëve të gjuhëve, dialekteve gjuhësore dhe sekteve fetare, aq më shumë lindnin dallimet që ndanin qytetarët e vendbanimeve antike, derisa dallimet e tilla shkrepën Luftën e Parë Botërore mu në zemër të Ballkanit Perëndimor. Ishte toka e Ballkanit Perëndimor ajo ku tërë bota, pas pesë dekadash "qetësie ballkanike", u bashkua për të ndalur topat shkatërrues të një etnie drejtuar tjetrës për gati një dekadë, e ku përpos komuniteteve pësonte trashëgimia e thesarit botëror, si qyteti antik i Dubrovnikut, Pallati i Dioklecianit apo Ura në Mostar, që ndër shekuj lidhte perandoritë. Fatkeqësisht, pasojat e ndarjeve kufitare ballkanike ende nuk po e lënë të qetë këtë rajon. Është Bashkimi Evropian shpresë e vetme, që duke i hapur dyert për integrim, t'i inkurajojë komunitetet e përçara për përfitimet që shtetet e BE-së kishin nga bashkëpunimi ndërkufitar. Në dy dekadat e fundit, BE-ja alokoi më së shumti fonde për përforsim të zonave ndërkufitare, fonde këto që u menaxhuan bashkërisht nga dy ose më shumë vende për realizimin e projekteve të përbashkëta zhvillimore. Përvojë tipike e bashkëpunimit të tillë u tregua shumë efikase në rajonin Oresund, që përfshinte territore nga Danimarka dhe Gadishulli Skandinav, sidomos pas ndërtimit të urës gjigante në mes të Kopenhagës dhe Malmos. Edhe pse

Malmoja e pozicionuar shumë larg kryeqendrës së saj, Stokholmit, përmes bashkëpunimit me Kopenhagën u zhvillua në shumë aspekte urbanistike dhe hapësinore. Vlen të përmendet fenomeni i qarkullimit ditor të një numri shumë të madh të banorëve nga të dyja anët e urës, që punonin në metropolin e Kopenhagës, të cilët kishin zgjedhur të banonin nëpër komplekset bashkëkohore të banimit në Malmo. Si danezët ashtu edhe suedezët kishin përfituar nga bashkëpunimi ndërkufitar urban, që me kosto shumë më të ulët t'i ofrojnë vetës rehati dhe kualitet në aspekt të banimit në qytetin më të qetë të Malmos, dhe të shfrytëzojnë mundësitë shumë më të mëdha të punësimit më të avancuar që mund të ofrojnë një kryeqytet si Kopenhaga. Shembull tjetër janë edhe qytetet e rajonit Alp-Adriatik, (Trieshta në Itali, Gracë në Austri, Kopër në Slloveni dhe Rjeka në Kroaci), të distancuara nga njëra-tjetra deri në 200km, të cilave me projekte të përbashkëta ndërrubane iu mundësua mbështetja reciproke e perspektivave të tyre zhvillimore, duke kombinuar resurset lokale të secilit lokalitet në të mirë të tërë rajonit.

Duke i menduar barrikadat aktuale në Mitrovicë dhe "pika të tjera të nxehta" apo "Jerusalem" ndëretnike e ndërftare në çdo pëllëmbë të Ballkanit, bashkëpunimi ndërkufitar po tingëllon utopi. Megjithatë zhvillimi i shkencës dhe teknologjisë po ndikon në shumë sfera të jetës duke lehtësuar komunikimin drejt një globalizimi si proces i pandalshëm. Me pranimin e

Kroacisë në Bashkimin Evropian, “njolla e zezë” po i afrohet edhe me shume Evropës, të cilës do t’i shkaktojë pamundësi në arritje të kohezionit hapësinor dhe zhvillimit të balancuar. Është koha të shfrytëzohen me efikasitet iniciativat e BE-së për shtetet potenciale për integrim, të njohura si IPA (Instrument of Pre-Association), komponentë e së cilës është bashkëpunimi ndërkuftar. Të vlerësohen mundësitë mutidisciplinare të bashkëpunimit në identifikimin e ngecjeve reciproke, duke u dhënë hapësirë vepruese iniciativa për zhvillim ekonomik, të cilat direkt do të ndikojnë në rritjen e bazës materiale. Siguria optimale ekonomike do të rezultojë në mirëqenie sociale, ku do të krijohej klime “zbutëse” për komunitete për fqinjësi të mirë dhe tolerancë në proces të pandalshëm të globalizimit. Ndasitë feudale do të zëvendësohen me sinergji të diversitetit shoqëror, në zgjidhjen e sfidave reciproke dhe në shfrytëzim efikas të resurseve të përbashkëta lokale, për zhvillim dhe prosperitet të vazhdueshëm rajonal.

Komuniteti, si përfitues kryesor, duhet të jetë i vetëdijshëm karshi mundësive, që me projekte të përbashkëta ndërkuftare do të mund të thithnin fondet e alokuara të BE-së drejt qaceve të ndryshme strategjike. Vetëm falë komponentit mutidimensional të bashkëpunimit ndërkuftar, mund të shpresohet përfshirja e trajtimit dhe rregullimit të shumë e shumë zhvillimeve kaotike, si në vendbanimet urbane po ashtu edhe në ato rurale. Në shumë vende kuftare të Ballkanit Perëndimorë ende mungon infrastruktura bazë për lëvizje të njerëzve, edhe pse ballafaqohen me inferioritetin e periferisë, pasi gjenden shumë larg kryeqytetit. Për të ilustruar mund të elaborohet shembulli i tërësisë territoriale rreth liqeve të Ohrit dhe Prespës, me qytetet si Ohri, Manastiri, Florina, Kozani, Koçra e Pogradeci, të ndara me vija që ndajnë liqenet në tri shtete. Periferinë dhe largësinë nga dinamika e kryeqyteteve do ta zëvendësonin me frekuencën e lëvizjes së lirë në mes vete, përmes strategjive të përbashkëta zhvillimore që do të



Ngjashmëri vizuale e konfiguracionit urban në mes të qyteteve të Ballkanit Perëndimor



bazoheshin në shfrytëzimin optimal të resurseve më unike, si:

- dy liqene me park nacional në mes;
- zona të turizmit dimëror;
- klimë për prodhime më rentabile bujqësore, blegtorale e pyjore; dhe
- qytete të urbanizuara nga kohët më të lashta të njerëzimit, me monumente të shumta, që vulosin secilën epokë historike të Ballkanit Perëndimor.

Lidhjen e tërë rajonit kontinental, me portet e rëndësishme detare, do ta mundësonte infrastruktura më e përsosur e Greqisë, si anëtare e kamotshme e BE-së, respektivisht autoudha Florinë – Janinë – Igumenicë. Shfrytëzimi efikas i infrastrukturës ndikon në ruajtjen e mjedisit, veçanërisht të tokës në këtë rast, pasi nuk do të ketë nevojë për duplikim të rrugës edhe prej pjesës së

Maqedonisë drejt daljes më të shkurtër në Mesdhe.

Njëra ndër sfidat që kërkojnë qasje komplekse dhe urgjente janë menaxhimet urbane të qyteteve të Ballkanit Perëndimor, të cilat, pas shume vitesh të fazës së transicionit, kanë pësuar rritje të numrit të popullsisë dhe zgjerime të pakontrolluara. Disa qytete, aq shumë kanë pësuar degradime, ku në shumicën prej tyre nevojitet qasje serioze profesionale për ruajtjen e “shpirtit” urban dhe funksionimit të tyre për jetë normale të komuniteteve. Me këtë rast vlen të theksohen investimet kapitale me rregulla zero të ndërtimit, shumëfishimi i telave nëpër rrjetën urbane të infrastrukturës energjetike, apo lidhjet e egra në rrjetin e ujërave, si dhe deponimi i pakontrolluar i mbeturinave shumë afër qendrës.



Degradime të trashëgimisë urbane

E përbashkët tjetër e qyteteve të Ballkanit është edhe mostrajtimi i mjaftueshëm i trashëgimisë kulturore. Mbi të gjitha, njëra ndër sfidat kryesore mbesin varrezat dhe mënjanimi i zgjerimit të tyre si pasojë e përqendrimit të popullsisë në shumë qytete të Ballkanit Perëndimor. Aq shumë sipërfaqe, si në toka rreth qyteteve, po ashtu edhe në fshatra, janë duke u shndërruar në varreza, saqë një intervenim urgjent dhe profesional i urbanistëve është më se i domosdoshëm. Duke kombinuar kapacitetet profesionale të diversitetit shoqëror të Ballkanit Perëndimor, ka shpresa për identifikimin e metodave dhe mënyrave për mënjanim të mangësive dhe njëkohësisht shfrytëzimin efikas të përparësive drejt rregullimeve të qëndrueshme urbane të qyteteve tona.

Po ashtu fenomen për trajtim ndërkufitar është gjatësia bregdetare prej 16 km e grykës së qytetit të Neumit, ku komuniteti i rajonit të Hercegovinës ballafaqohet me shumë pika doganore të njëpasnjëshme e me tri valuta monetare, sepse kufijtë u vendosen vetëm në bazë të tri fraksioneve fetare dhe të tri kombeve me gjuhë të njëjtë, por me tri dialekte. E të mos flasim për largësinë e këtij komuniteti nga kryeqytetet, kur kemi parasysh konfiguracionin e Maleve Dinarike për të arritur Zagrebin, Sarajevën apo Podgoricën. Me aplikimin e iniciativave

të bashkëpunimit ndërkufitar, komuniteti i qyteteve të shumta (Dubrovnik, Neum, Mostar, Trebinje, Hercegnovi e Kotor) do të tejkalonin vështirësitë e përmendura, me resurset e rralla bregdetare, drejt prosperitetit të sigurt gjithëpërfshirës rajonal.

Kurse për Kosovën, si vend kontinental shumë i vogël, e me kufij të brishtë, shumë pak do të kishte shpresa për zhvillim vetjak, pa bashkëpunim të mirëfilltë me fqinjët, për menaxhim efikas të resurseve të përbashkëta ndërkufitare, si dhe në zgjidhjen e sfidave reciproke në të mirë të tërë rajonit. Nga organizatat ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë, mund të veçohet

tentativa joformale, e njohur si “Balkan Peace Park Coalition” (Koalicioni Ballkanik për Parqe të Paqes”, që ka pasur qëllim harmonizimin e perspektivave për zhvillim të balancuar të Bjeshkëve të Nemuna, në mes të Kosovës, Shqipërisë dhe Malit të Zi. Kjo tentativë do të duhej të merrej më seriozisht nga të tri vendet, pasi resurset malore ofrojnë bashkëpunime në shumë fusha, si: industri pyjore, blegtorale dhe turistike, si dhe kapacitete klimatike për energji të ripërtëritur. Si vendbanimet rurale që ndodhen më afër maleve, po ashtu edhe zonat urbane do të përfitonin përmes një partneriteti rajonal urban-rural, për zhvillim më gjithëpërfshirës të rajonit. Përvojat evropiane efikase për zhvillim hapësinor të bazuar në resurse malore mund të përvetësohen nga menaxhimi i përbashkët i Alpeve, ku të gjitha shtetet në të cilat shtrihen këto male, përmes një konvente të përbashkët, i harmonizuan perspektivat, për ndërtim të ekosistemit rajonal dhe drejt zhvillimit të qëndrueshëm në kuptim më të gjerë rajonal. Le të besojmë në realizimin e këtyre perspektivave edhe në Ballkanin Perëndimor, për paqe dhe prosperitet rajonal, që do të kontribuonte në kohezion territorial dhe qëndrueshmëri zhvillimore të tërë Evropës në kontekst global.

(Autorja ka MA në Planifikim Urban)



Çarshia e Gjakovës

QYTETI NË TRANSICION: "ARCHIS INTER-VENTIONS" NË PRISHTINË

Florina Jerliu,
Kai Vöckler



Prishtina është një shembull i një qyteti në transicion. Përfaqëson vështirësitë e një procesi transformues nga një shtet socialist në ekonomi të tregut, e cila mund të identifikohet në qytetet e Ballkanit, pas një periudhe të gjatë të represionit dhe luftës së vitit 1999.

Nevojat për zhvillime u intensifikuan në Prishtinë e pasluftës, pasi që popullata rurale filloi të shpërngulet me shumicë në qytet. Për një kohë të shkurtër Prishtina e dyfishoi numrin e popullatës, duke pasuar me një rindërtim shumë të shpejtë të qytetit. Shumica e qytetarëve të Prishtinës së pasluftës u angazhuan në krijimin e hapësirave të reja për qëllime banimi dhe për bizneset e tyre familjare. Shumë nga ta ishin të përkushtuar në ndërtimin e ndërtesave të banimit të nivelit më të lartë, të interesuar në përmirësimin e stilit të tyre të jetës. Në mënyrë simultane, komuniteti ndërkombëtar në shumicë i përqendruar në Prishtinë, kërkonte kapacitete të

shumta të zyrave dhe hapësirave të akomodimit, përderisa jetonin në pjesët më atraktive të qytetit dhe ndërkohë që ato shtëpi banimi zgjeroheshin në të njëjtën kohë. Në mënyrë të papritur, ndërtime të paautorizuara filluan të ndikojnë seriozisht në strukturën urbane të qytetit duke ngritur probleme të shumta sociale, infrastrukturore dhe të sigurimit. Më shumë se 70% të pjesës urbane u transformua për shkak të mosrespektimit të ligjit, mungesës së planifikimit të obligueshëm dhe standardeve të ndërtimit. Vetëdija kolektive për problemet fundamentale të shkaktuara nga ndërtimet ilegale dhe krizës së besimit në dimensionin publik të jetës urbane, mund të thuhet se ishte brenga më e madhe e Prishtinës.

Në këtë pikë organizata joqeveritare lokale "Archis Interventions – Prishtina" – anëtare e rrjetit më të gjerë Archis – të themeluar më 2006, është angazhuar në ofrimin e ekspertizës profesionale në këtë

proces, sikurse dhe shkëmbimit të informatave për të zhvilluar strategji-zgjidhje të qëndrueshme për rregullimin e aktiviteteve të ndërtimeve ilegale në kontekst social dhe politik të pasluftës.¹ Kompleksiteti i situatës urbane në Prishtinë është hulumtuar dhe analizuar në studim, përmes së cilit është bërë identifikimi i prototipave të ndërtimeve ilegale. Është gjeneruar e ashtuquajtura "Hartë Patologjike Urbane e Prishtinës", me qëllim të tërheqjes së vëmendjes tek opinioni i gjerë, lokal dhe ndërkombëtar, platformën e zhvillimeve urbane të paplanifikuara në kontekst të pasluftës. Është bërë një përmbledhje e pasojave të dala nga problemet e ndërtimeve të pakontrolluara dhe në bazë të këtyre analizave të zonave "patologjike" janë katër prototipa të ndërtimeve të pakontrolluara:

Prototipi 1: Shtëpi njëshe - e ndërtuar në periferi të qytetit, ku pronarët posedojnë tokën porse nuk kanë leje të ndërtimit.

Prototipi 2: Shtëpi njëshe - e ndërtuar brenda qytetit, aty ku pronarët e objektit posedojnë tokën dhe zakonisht janë pjesë e komunitetit të lagjes; pronari nuk ka leje të ndërtimit dhe ndërton maksimalisht në tërë parcelën, pa konsideratë për limitime të planifikimit.

Prototipi 3: Objektet të cilat maksimalisht shfrytëzojnë parcelën dhe lartësinë, janë të ndërtuara për qëllime komerciale, apartamente dhe zyra etj. Në këtë aspekt zhvilluesit zakonisht nuk janë pjesë e komunitetit dhe ndërtojnë pa leje,



Fig1. Ndërtimet ilegale në Prishtinë

¹ Bashkëpunimi me Hackenbroich Architekten (Berlin) dhe Co-PLAN (Tirana). Projekti është mbështetur nga ERSTE Foundation and Friedrich-Ebert-Stiftung (FES).



Fig. 2 Studimi në Prishtinë: prototipat e objekteve ilegale (objektet ilegale të ndërtuara pas vitit 1999 janë me të kuqe)

pa konsiderata për limitime të planifikimit.

Prototipi 4: Parazitët urbanë – grupet e shtesave në kulm, anekset, shtesat në ndërtesa të cilat janë bërë nga vetë pronarët për të rritur banesat familjare. Hapësira në këto raste është publike dhe nuk kanë leje ndërtimi.

Paralel me këtë është punuar në konceptin e përgjithshëm strategjik, i cili lejonte kombinimin e disa strategjive së bashku: strategjinë urbane arkitektuale që ndikonte në komunikimin, përdërisa si mbështetje nga "Archis Network" u përfshinë grupe të ndryshme të interesit në projekt model dhe organizata të tjera lokale. Koncepti i strategjisë ishte pranuar nga administrata lokale në vitin 2007 dhe u bë pjesë e Programit për Qytetin e Prishtinës për vitet e ardhshme. Kjo mirënjohje e bëri të mundshëm zhvillimin e mëtutjeshëm të konceptit, disa prej të cilave veçse janë realizuar.

Në vitin 2009, është prodhuar "Udhërrëfyesi për legalizimet e strukturave të ndërtuara pa leje". Manuali vendos standarde minimale bazike për t'u ballafaquar me procesin e legalizimit si një proces shumë kompleks. Pjesa teknike përmban udhëzime bazike të standardeve të sigurimit, aspekteve sociale dhe nevojave infrastrukturore. Këto tri çështje/aspekte janë marrë në konsideratë për tri prototipat e ndryshme: ndërtesat me max 450 m² (të cilat sipas ligjit është maksimumi për

shtëpi familjare), ndërtesa e cila kalon 450 m², dhe anekset e objekteve legale. Standardet minimale të sigurisë janë të zhvilluara në aspekt të shtigjeve të evakuimit, distancës minimale – për mbrojtje kundër zjarrit, strukturës (statika e objektit) dhe tërmetit (dinamika e objektit).

E marrë nga "Udhërrëfyesi" duke paraqitur kriteret e legalizimit në aspekt të distancës minimale– mbrojtjes kundër zjarrit për prototipin një (shtëpitë)

Afati kohor me faza të procesit të legalizimit

Në korrik të vitit 2009, Komuna e Prishtinës shfrytëzoi aspektet fundamentale të këtij koncepti, mori aprovimin për të proceduar legalizimet. Faza e parë e procesit të legalizimeve përfshirë dhe regjistrimin e objekteve ilegale, është kryer në fund të vitit 2010. Gjatë kësaj periudhe janë mbajtur takime informative me qytetarë dhe opinioni i tyre është marrë në konsideratë nga sektori i legalizimeve në Komunën e Prishtinës, e themeluar tani së voni. Rreth 7000 aplikacione për legalizime janë dorëzuar nga qytetarët e Prishtinës dhe janë në procedim e sipër në fazën e dytë të procesit.

Së bashku me koncept-strategjinë për legalizimet, "Archis Interventions" ka angazhuar diskutime për perspektivën e ardhme të Prishtinës duke promovuar strategji realiste, e cila merr në konsideratë dhe vendos parimet e një të ardhmeje të qëndrueshme. Ky studim është emërtuar me

B / Minimum distance - Fire protection

Maintaining a minimum distance between buildings can prevent the spread of fire and thus increase safety (i.e. fire that breaks out in one building may be prevented from spreading quickly to the neighboring building).

Minimum Standard:

a) If a building is on the plot line:

- windows, doors, balconies or other openings in the border wall are not permitted;
- the roof is not permitted to extend over the wall the roof should contain an attic.

b) If the building is up to 1.0 meter distant from the neighboring building:

- windows and balconies are not permitted;
- the roof is not permitted to extend over the plot line;
- a fence or any other structure that blocks passage between the two neighboring buildings is not permitted.




Fig. 3. Standardet minimale të legalizimit

emrin: “Prishtina – Qytet dinamik”, ku janë hulumtuar tema kyçe dhe rëndësia e tyre hapësinore si propozim për diskutime për të ardhmen e qytetit dhe të shoqërisë. Analizat thonë se potencialet e Prishtinës si kryeqytet në Kosovë, rininë e saj – me njohuritë dhe edukimin – janë faktor kyç për zhvillimet e ardhshme. Ky studim e komplementon “Programin e Qeverisjes për Prishtinën 2010 – 2013”, të adoptuar nga Komuna në vitin 2010.

Integrimi i zonave strategjike duke reflektuar orientime të zhvillimeve hapësinore

“Prishtina – Qytet dinamik” gjithashtu ofron udhërrëfim për revidimin e planeve urbane për të përmbushur nevojat e qytetit për një kontekst të zbatimit të suksesshëm për legalizime në veçanti dhe për të ofruar qëllime për zhvillime reale të cilat mund të arrihen për një kohë të gjatë. Së bashku, këto vizione mund të mbështeten me projekte kyçe të cilat mund të jenë të gatshme për t’u zbatuar. Kjo metodë, e cila është zakonisht e pranuar në planifikimin bashkëkohor, nevojitet të adaptohet për kontekst specifik social dhe politik. Këtu, gjithashtu “Archis Interventions” në Prishtinë tenton të luajë një rol të rëndësishëm në establimin e metodave të ndryshme të planifikimit. Sido që të jetë, kjo nuk është lehtë të arrihet!...Edhe pse të vetëdijshëm se procesi i legalizimeve është shumë kompleks dhe se suksesi varet nga hapat e zbatuar me përpikëri, në kohën e caktuar sipas rregulloreve në fuqi për legalizime, zyrtarët e komunës vështirë se lëvizin prej hapave “të ngadaltë” dhe qasjes së fragmentuar për planifikim urban




Fig. 4. Procesi i legalizimit në Prishtinë

dhe problem të menaxhimit, të cilat ekzistuan gjatë dekadës së kaluar. Në mënyrë që të sjellim shembuj dhe të shkëmbejmë përvoja me institucione mirë të njohura arkitekturore dhe të planifikimit dhe me personalitete në Evropë, janë iniciuar debate publike me qëllim të inicimit të debateve urbanistike që mungojnë në Prishtinë. Një ngjarje e cila vlen të përmendet është “NAI Debatet në lëvizje: Prishtina e pandërtuar” e organizuar nga NAI (Netherlands Architecture Institute) dhe “Archis Interventions”, në janar të vitit 2010. Debatet kanë për qëllim të kontribuojnë me diskutime për legalizime dhe pjesëmarrjen e qytetarëve rezidentë në planifikimin urban dhe proceset transformuese. Përderisa, nëse flasim në përgjithësi, Komuna e Prishtinës ka demonstruar gatishmërinë për të qenë pjesë e ngjarjeve publike të komunitetit të arkitektëve dhe planerëve urbanë për interaksion dhe

kuptim të ndërsjellë të problemeve, të cilat mbesin për t’u zbatuar në aspekt të iniciativave dhe mirëmbajtjes së debateve urbanistike, si pjesë e procesit zhvillimor. Një detyrë me rëndësi sot është shqyrtimi i planeve rregulluese ekzistuese duke marrë parasysh integrimin e objekteve, të cilat parashihen të legalizohen dhe të prodhohet një vizion i cili korrespondon me kapacitetin zhvillimor të qytetit në kontekst të kornizës ligjore në fuqi. Në mënyrë që të iniciohet ky debat, “Archis Interventions - Prishtina” ka organizuar, në tetor të vitit 2011, punëtorinë, ku objektet ilegale janë inspektuar dhe vënë në hartë për të identifikuar nivelin e devijimit nga planet rregulluese dhe ofrimin e konceptit për revidimin e tyre të mundshëm, mjetet për ndërmjetësim me fqinjët, të cilët nuk kanë ndërtuar në mënyrë të egër.


Në përmasa më të gjëra, jemi në një pikë, ku punohet në më shumë veprime të cilat mund të ndikojnë në publik, në projekt model të mundshëm, që mund ta bëjë të mundshëm përdorimin e proceseve të reja për koordinimin e marrëveshjeve të interesave të ndryshme dhe realizimin e ideve. Atë për të cilën përfaqësuesit e shumtë ndërkombëtarë dhe organizata lokale kishin thënë se është e pamundur në vitin 2005, tani na dalin frytet e para: situata përmirësohet për të mirën e përgjithshme të shoqërisë. Për të bërë gjithë këtë, sido që të jetë, arkitektët dhe planerët, të cilët dëshirojnë ndryshime dhe që punuan në emër të qytetit të tyre: mund të jenë të nominuar si “agjentë të ndërrimeve”.



Fig. 5. Analizat për integritet hapësinor për hapësira simbolike në Prishtinë

TRASHËGIMIA DHE PLANIFIKIMI

Luan Nushi



Analiza e rritjes urbane (Burimi: IPH)

Plani Hapësinor i Kosovës¹ është dokumenti kryesor i sektorit të planifikimit hapësinor, i cili është ndërtuar në bashkëpunim me të gjithë sektorët e rëndësishëm të Qeverisë së Kosovës. Në hartimin e tij kanë marrë pjesë edhe profesionistë të dalluar të fushës, institucionet e ndryshme shkencore, Universiteti, organizata të ndryshme joqeveritare, përfaqësues të shoqërisë civile, zyrtarë të nivelit lokal dhe organizata të ndryshme ndërkombëtare, ndihma dhe përkrahja e të cilave ka qenë pa dyshim shumë e rëndësishme.

Në mesin e sfidave të identifikuara dhe çështjeve të trajtuara është edhe trashëgimia kulturore dhe natyrore. Në bazë të rezultateve dhe asaj që është prezantuar në dokument, e kemi përshtypjen se trashëgimia kulturore nuk është trajtuar në masën që ne do të kishim dëshirë. Të dhënat që disponojmë janë të mangëta dhe nuk shprehin gjendjen reale të shtrirjes hapësinore, mungon valorizimi dhe gjendja e objekteve, monumenteve dhe zonave që për momentin janë vetëm emra të një liste "të dyshimtë".

Gjendja dhe shkaktarët

Në bazë të një hulumtimi që është bërë gjatë hartimit të Planit Hapësinor, i cili për temë ka zhvillimin urban në vite, zonat urbane janë rritur në sipërfaqe përafërsisht

tri herë. Analiza është bërë për shtatë qendrat e mëdha urbane, të cilat në fakt paraqesin pikat drejt të cilave në vitet e fundit është ndier lëvizja më e madhe e popullatës. Natyrisht se kjo ka ndikuar në rritjen e numrit të banorëve në zonat urbane, që në mënyrë të drejtpërdrejtë ka ndikuar edhe në rritjen e sipërfaqes së vetë zonës. Skema e mëposhtme tregon rritjen hapësinore të disa qendrave të mëdha urbane të Kosovës në periudhën 1980 – 1999.

Nga këto lëvizje ndikimet më të mëdha vërehen në qytetin e Prishtinës, i cili në bazë të vlerësimeve dhe asaj që po ndodh në aspektin urban – "nuk ka qenë i përgatitur" për këtë. Fluksi i madh i ardhjes dhe më këtë i kërkesave për sigurimin e një vendi për banim në njërin anë, dhe në anën tjetër mosgatishmëria e autoriteteve komunale që të ofrojnë hapësira legale për ndërtim, janë faktorët kryesorë që kanë ndikuar dhe po vazhdojnë të ndikojnë në parregullsinë urbane të Prishtinës.

Në figurën e mëposhtme tregohet rasti i Prishtinës dhe rritja e saj në vite, tregohet raporti në mes zonës së vjetër dhe pjesës tjetër urbane. Në mënyrë të qartë tregohet trendi i zhvillimit të deritashëm dhe tendenca në vazhdim.

Pa dyshim se në gjithë këtë "rrëmujë" presioni më i shprehur është bërë dhe po

bëhet në qendër, në zonën me më së shumti objekte të klasifikuara si vlera të trashëgimisë kulturore. Shumë objekte të kësaj vlere nuk ekzistojnë më, në të shumtën e rasteve ato janë zëvendësuar me objekte të "arkitekturës moderne" që në fakt në mënyrë serioze po ndikojnë në humbjen e identitetit që duhet ta ketë një zonë e vjetër e qytetit.

Ky trend po vazhdon edhe sot, dhe shumë shpejt do të përballemi me situatën kur do të na vijë keq për veprimet dhe mosveprimet e bëra, pjesë e të cilave jemi të gjithë. Përgjegjësia bie së pari te autoritetet qendrore, të cilat duhet të insistojnë në përf forcimin e infrastrukturës ligjore dhe përcaktimin e qartë të pozicionit të të gjitha institucioneve përgjegjëse për ruajtjen e trashëgimisë kulturore. Përgjegjës janë edhe autoritetet komunale, të cilat nuk janë treguar të gatshme t'u përgjigjen kërkesave, të cilat në pjesën më të madhe të rasteve kanë qenë të ndërlidhura me qendrën dhe zonën e vjetër të qytetit. Janë punuar disa plane rregulluese urbane, në të cilat çështja e trashëgimisë dhe objekteve kulturore ka mbetur e patrajtuar në mënyrën-nivelin e duhur. Nuk ekziston një kufi i qartë (në këtë rast administrativ) i zonës së vjetër të qytetit, që gjithsesi do të ishte parakusht për hartimin e një plani adekuat për këtë zonë. Një përgjegjësi e



Rritja urbane ne Prishtine (Burimi: IPH)



...veprimet dhe mosveprimet tona... – objekti në foto i "dënuar" për shkatërrim!

madhe u takon edhe profesionistëve, të cilët me vetëdije ose pa të shkelin rregullat e ndërtimit në favor të arkitekturës moderne. Përgjegjës janë edhe qytetarët, një pjesë e të cilëve të ndodhur në situatë të vështirë ekonomike në njërin anë dhe në anën tjetër para presionit të ndërmarrësve, me lehtësi po heqin dorë nga e kaluara historike e familjes.

Krahas gjithë kësaj rrëmuje, një shkaktar tjetër i rëndësishëm është "diskriminimi kulturor" që po ndodh me shpalljen e listës së zonave të ashtuquajtura "zonat e veçanta të mbrojtura". Në fakt, lista e prezantuar është pjesë përbërëse e trashëgimisë kulturore të Kosovës dhe trajtimi i tyre me ligj të posaçëm krijon bindjen se zonat e tjera që nuk janë në listë janë më pak të vlefshme. Kjo situatë në mënyrë të drejtpërdrejtë po ndikon në krijimin e opinionit se ndaj tyre dhe përreth tyre mund të sillemi pa ndonjë kriter dhe procedurë të caktuar.

... dhe emëruesi i përbashkët i gjithë kësaj është se – **trashëgimia jonë kulturore po humbet dhe madje me ritëm shumë të shpejtë!**

Prandaj, duke i pasur të gjitha këto parasysh dhe duke qenë të vetëdijshëm për rëndësinë e trashëgimisë dhe efektin që ka ajo, propozoj një listë të përgjithshme të rekomandimeve, që duhet gjithsesi të plotësohet edhe nga të tjerët.

Rekomandimet

Përcaktimi i qartë i zonave me trashëgimi kulturore – të gjitha komunat në bashkëpunim me autoritetet përgjegjëse dhe profesionistët e fushës duhet të definojnë në mënyrë të qartë zonën dhe kufirin e saj.

Hartimi i planeve për konservim (të nivelit të Planit rregullues urban)

– të gjitha komunat në bashkëpunim me autoritetet përgjegjëse dhe profesionistët të fushës janë përgjegjës për realizimin e planit. Plani duhet të jetë i bazuar në listën e detyrave (ToR) të përcaktuara paraprakisht nga autoritetet përgjegjëse.

Hartimi i planeve të menaxhimit – në mes tjerash plani duhet të përcaktojë qartë autoritetet përgjegjëse që do të menaxhojnë zonën, buxhetin dhe afatet e realizimit të punëve të parapara.

Trajtimi i zonave të përcaktuara në të gjitha nivelet e planifikimit – forma dhe niveli i trajtimit do të varet nga niveli i planit. Sa më i detajuar të jetë plani aq më me detaje duhet të trajtohen objekti, monumenti apo zona e trashëgimisë kulturore dhe natyrore;

Planifikimi urban hapësinor, si instrument për kontrollin e zhvillimeve në zona me vlera kulturore dhe historike – këto dokumente duhet të shërbejnë si vegla me të cilat autoritetet përkatëse do të realizojnë kontrollin ndaj objekteve, monumenteve apo zonave me trashëgimi kulturore dhe natyrore;

Të bëhet inventarizimi (baza e të dhënave) – nga autoritetet qendrore kërkohet që në afat sa më të shkurtër të përfundojnë inventarizimin, të ndërtojnë bazën reale të shënimeve që do të shërbejë për shprehjen adekuate hapësinore të trashëgimisë kulturore;

Të bëhet valorizimi i gjendjes – për shumë objekte, monumente dhe zona të trashëgimisë kulturore nuk dihet gjendja fizike momentale e tyre, është nevojë urgjente që kjo të bëhet në mënyrë që të përcaktohen masat e nevojshme për ruajtjen dhe sanimin e tyre.

Të vazhdohet me shënimin e

zonave të tjera – në të njëjtën mënyrë sikur është vepruar me listën e objekteve nga Pakoja e Ahtisarit, të vazhdohet edhe me objekte, monumente dhe zona të tjera të trashëgimisë kulturore. Momentalisht mungon një hartë e përgjithshme në të cilën duhet të paraqiten të gjitha objektet, monumentet dhe zonat e trashëgimisë kulturore;

Të bëhet përfshirja funksionale – të gjitha objektet, monumentet dhe zonat e trashëgimisë kulturore duhet të jenë pjesë funksionale e dokumenteve të planifikimit hapësinor;

Përkrahja institucionale e pronarëve të monumenteve – është shumë me rëndësi që të gjitha strukturat përgjegjëse të fushës së trashëgimisë kulturore, të gjejnë formën e përshtatshme që do të mundësojë përkrahjen institucionale të pronarëve të objekteve, monumenteve dhe zonave të trashëgimisë kulturore. Përkrahja duhet të jetë e formës materiale dhe e mjaftueshme për plotësimin e kërkesave, e bazuar në standardet e shteteve të përparuara;

Pjesëmarrja aktive e qytetarëve – qytetarët e sidomos pronarët e objekteve, të monumenteve dhe zonave të trashëgimisë kulturore duhet të jenë pjesë aktive e të gjitha takimeve dhe diskutimeve që zhvillohen me temën e trashëgimisë kulturore;

Pa mure rrethuese – dukuria e rrethimit të objekteve, monumenteve dhe zonave me trashëgimi kulturore me mure të larta duhet të ndërpritet. Ato duhet të jenë pjesë e funksionale e zhvillimeve që ndodhin përreth, duhet të shërbejnë në favor të zhvillimit të turizmit dhe zhvillimit ekonomik në përgjithësi;

(Autori është drejtor i Institutit për Planifikim Hapësinor, AMMK / MMPH)

JUNIKU, NJË QASJE ALTERNATIVE E ZHVILLIMIT HAPËSINOR, BAZUAR NË TRASHËGIMINË KULTURORE DHE PLANIFIKIMIN ME FORCA VETJAKE

Mirian Bllaci



Kur vjen puna te vështirësitë e planifikimit hapësinor në nivel lokal, shumë shpesh ngrihen çështjet e resurseve ekonomike, kulturore e natyrore dhe të mungesës së kapaciteteve profesionale. Kjo e fundit paraqitet si arsyeja kryesore se pse organet përfaqësuese të nivelit lokal ia besojnë tregut menaxhimin dhe hartimin e planeve hapësinore. Mirëpo, as kjo metodë e nënkontraktimit nuk ka rezultuar e efektshme, përkundrazi! Kompanitë hartuese në pozitë e përgjegjësit të hartimit të planeve, në mënyrë të pashmangshme, bëhen edhe drejtues të politikave të planifikimit, duke ushtruar *de facto* dhe në mënyrë ndoshta antidemokratike (qytetari nuk ka mundësi që nëpërmjet votës të "ndëshkojë" hartuesin privat të planeve hapësinore/urbane) një nga kompetencat kyçe të pushtetit vendor.

Por, për të mos hyrë në debatin pa fund mbi efektshmërinë më të madhe të sektorit publik apo atij privat dhe për të na dhënë pak optimizëm në këtë mori pikëpyetjesh në fushën e planifikimit hapësinor, një shembull pozitiv na vjen nga Juniku. Kjo komunë dallon nga komunitet tjerë në Kosovë për qasjen e saj ndaj problematikave të planifikimit, të paktën për dy arsye.

Së pari, sepse trashëgimia kulturore dhe natyrore ka qenë vektori kryesor i fuqizimit të procesit të planifikimit të zhvillimit në Junik. Gjithçka ka filluar në vitin 2001, ku, në një kontekst pas lufte, plotësimi i nevojave më të thjeshta jetike ishin më urgjente sesa trashëgimia kulturore – kur me një fond të Komisionit

Evropian dhe Agjencisë Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar, Sida, fondacioni suedez Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHwB) restauroi Kullën e njohur si Oda e Junikut. Kjo ka qenë zanafilla e një angazhimi të fortë (që ende sot vazhdon) të CHwB-së, që në vitin 2007-2008 prodhoi Planin e konservimit dhe zhvillimit dhe Dokumentin e integruar të vizionimit për Junikun. Këta janë dy gurë themelues për Junikun për arsye se vendosin në qendër të zhvillimit të komunës potencialin e saj më të madh, trashëgiminë kulturore dhe natyrore.


Ky vizion do të konfirmohej qartë edhe gjatë procesit të hartimit të Planit zhvillimor urban dhe Planit rregullues urban të Qendrës së Junikut (në këtë kohë Juniku ishte ende një pilot-njësi komunale, si rezultat i procesit të decentralizimit në Kosovë). I gjithë ky angazhim, i kombinuar dhe me shpalljen e plotë të Junikut si komunë në vitin 2008, dhe me projektet që kanë trashëgiminë kulturore dhe natyrore si emërues të përbashkët, do të kurorëzohej me aprovimin, në korrik të vitit 2011, të Planit Zhvillimor Komunal (PZHK).

Pas fokusimit të paprecedent tek trashëgimia kulturore dhe natyrore, kjo është arritja e dytë e madhe e qasjes së Junikut, falë së cilës kjo komunë u bë e para në Kosovë që realizon "në shtëpi" dokumentin më të rëndësishëm të planifikimit strategjik, me ndihmën e Programit për Mbështetjen e Planifikimit Hapësinor Komunal (PMPHK) të UN-HABITAT, CHwB-së dhe Institutit për Planifikim Hapësinor (IPH).

Akoma dhe më e vështirë për t'u realizuar duket kjo arritje po të përmendim faktin se Juniku administron një territor prej 77,77 km² duke mos pasur mundësi të mëdha investimi për shkak të buxhetit të vogël operativ. Për të mos përmendur pastaj kapacitetet e kufizuara për konceptimin dhe përcjelljen e një procesi të ndërlikuar si ai i planifikimit strategjik. Si shembull vlen të përmendet këtu se Drejtoria e Planifikimit dhe Urbanizimit në Junik operon me një arkitekt të vetëm, një inxhinier civil dhe dy zyrtarë të kadastrës!

Duke pasur parasysh këto kushte, realizimi i procesit të planifikimit strategjik me forcat vetjake ishte një vendim i vështirë për t'u marrë. Nga njëra anë ai justifikohet nga detyrimi për të qenë në përputhje me kërkesat e ligjit dhe vullneti për të propozuar zgjedhje dhe politika të përshtatshme planifikuese. Nga ana tjetër, kjo qasje alternative ishte rezultat i dëshirës për të pasur vetë nën kontroll procesin e planifikimit të një zhvillimi të qëndrueshëm, falë së cilës edhe perspektiva e zbatimit do të ishte më e mirë dhe me ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë e jetesës së junikasve.

Metodologjia e përdorur bazohet në parimin e të mësuarit – duke bërë (learning by doing). Kjo qasje karakterizohet nga fakti se aplikimi i saj mundëson përfundimin e kapaciteteve dhe personave të përfshirë në proces, qoftë në aspektin profesional, qoftë në aspektin organizativ, si dhe në aspektin institucional dhe të bashkëpunimit. Këto



përparësi kompensojnë ato që mund të quhen dobësi të kësaj metode e që janë: faktori kohë, vlerësimi i saktë i burimeve njerëzore dhe kapaciteteve të brendshme, si dhe pamundësia financiare që vazhdon të mbetet një sfidë e vështirë për t'u fituar për nivelin komunal.

Së pari, në aspektin profesional, përveç

rritjes cilësore të inventarit të informacionit të nevojshëm për hartimin e dokumentit, qasja "në shtëpi" ndikon edhe në përmirësimin e aftësive organizative dhe manaxhuese të stafit të përfshirë në projekt. Komuna, duke u vënë në rolin kryesor për menaxhimin e procesit të planifikimit, bën që të rritet

ndjenja e përgjegjshmërisë dhe rrjedhimisht e pronësisë së procesit dhe rezultateve të tij nga stafi dhe politikëbërësit komunalë. Prej kësaj ndërgjegjeje vjen natyrshëm dhe aplikimi i metodave gjithëpërfshirëse dhe me pjesëmarrje të komunitetit në takimet e organizuara në kuadër të procesit të planifikimit.



Së dyti, kjo qasje përmirëson ndjeshëm kulturën e brendshme organizative, prej së cilës vërehet një rritje sasiore dhe cilësore e shkëmbimeve dhe koordinimit mes drejtorive, si dhe pjesëmarrje e kënaqshme e bordit të drejtorëve në të gjitha etapat e rëndësishme të procesit. Ky ndikim pozitiv është shumë i vlefshëm për komunat e krijuara rishtazi si Juniku, ku mungon përvoja në planifikimin e zhvillimit dhe ku nuk janë të mjaftueshme njohuritë e instrumentet aktuale të mbikëqyrjes së zhvillimit. Argumenti financiar qëndron gjithashtu në anën e planifikimit "në shtëpi", sepse shpenzimet janë rreth pesë herë më të vogla krahasuar me metodën e nënkontraktimit. Gjithashtu kështu arrihet

përdorimi optimal jo vetëm i resurseve të brendshme, por dhe i ekspertizës profesionale të donatorëve e partnerëve të përfshirë në proces.

Së treti, metoda e Junikut ka dhënë rezultate të mira edhe për sa i përket fuqizimit institucional, duke bërë më të lehtë integrimin e çështjeve të planifikimit në agjendën politike, element thelbësor për procesin strategjik të planifikimit. Këtë e dëshmon fakti se edhe pas ndryshimeve politike në komunë, udhëheqja e re e mbështeti fillimisht dhe pastaj e aprovoi qasjen në fjalë. Kjo ka kontribuar fuqishëm edhe në kuptimin dhe mirinterpretimin e legjislacionit për planifikimin dhe forcimin e partneritetit mes Komunës dhe Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në sajë të së cilit IPH-ja ia mundësoi projektit një ekspertizë profesionale shtesë. Konsultimet kanë përfshirë edhe instanca të tjera qendrore, komunat fqinje, si

dhe bizneset e OJQ-të, duke bërë që procesi të fitojë më shumë legjitimitet në sytë e të gjitha palëve të interesit.

Së fundmi, mësimet e nxjerra nga Juniku duhet të konsiderohen edhe si një investim afatgjatë, i cili me kalimin e kohës sjell rritjen e kapaciteteve profesionale dhe të aftësive organizative të komunave. Kjo është një domosdoshmëri në një kontekst ku gjithnjë e më shumë komunat do të duhen të përballëshin me turrjen e mundësive financiare, tërheqjen e vazhdueshme të agjencive dhe donatorëve ndërkombëtarë dhe zbehjen e shtetit në rolin e aktorit kryesor në zhvillimin lokal. Në këtë aspekt qasja e Junikut e bazuar në trashëgiminë kulturore dhe në planifikimin me forcat e veta nuk është thjesht një arritje për komunitetin junikas dhe palëve të përfshira në procesin e planifikimit, por dhe një shembull i mirë për Kosovën dhe

rajonin se si me pak mjete, por me përkushtim të madh dhe sens shërbimi ndaj qytetarëve, mund të hidhen baza të forta për një zhvillim të qëndrueshëm. Kështu, falë instruksioneve të përmbajtura të PZHK-së, po zbatohen në Junik projekte nga më të ndryshmet që degjenerojnë punë, të ardhura dhe projekte e aktivitete turistike-kulturore në vazhdimësi. Mjafton të kaloni një fundjavë aty për t'u ndërgjegjësuar...

Shënim

Për informacione më të detajuara rreth qasjes së Junikut dhe aktivitetit të CHwB në këtë komunë mund të konsultoni publikimin "7 projekte të konservimit të integruar në Komunën e Junikut/ 7 Integrated Conservation projects in Junik Municipality" që mund ta gjeni në adresën:

http://www.chwbkosovo.org/file.php?file=Report_18_2011.pdf



KOSOVA – ME URBARKITEK- TONIKË NË "SHQETËSIM"

Ark. Nexharije Buçinca



Ulpiana - pjese banimore ne Prishtine

Grumbullimi i vështirësive në zhvillimet e deritanishme, si dhe fakti se në "dyert e qyteteve" troket përditë e më shumë numër i madh i njerëzve që kërkojnë t'u ndihmohet në kërkesat e tyre në fushën e banimit, alarmon vendimmarrësit dhe njerëzit profesionalë që koha e durimit po shuhet dhe kërkohen zgjidhje të shpejta, efikase dhe eficiente.

Pra, e kujt është Kosova?

Urbarkitektura kosovare po pëson vetëvrasje! Gjendje kjo e krijuar si rezultat i shumë faktorëve: apatisë së vendimmarrësve, institucioneve të brishta, legjislacionit, mungesës së stafit profesional me përvojë dhe njohuri të duhura, mungesës së standardeve, mungesës së regjistrimit të popullsisë deri në këtë vit, mungesës së angazhimit participues e të dinjitetshëm të komunitetit, mungesës së themelimit të agjencisë ekzekutive për banim në kuadër të Ministrisë për Planifikim Hapësinor, e mungesës të sektorit për banim në Kuvendin Komunal (të parapara me Ligjin për banim), mosfunksionimi i entit për urbanizëm dhe projekte, si dhe ndërmarrjeve publike, e shumë e shumë faktorëve të tjerë.

Kush vendos për katandisjen e hapësirës, njerëzit profesionalë apo.....?

"Ne nuk e kemi trashëguar tokën prej prindërve tanë"

"Ne e kemi huazuar atë prej fëmijëve tanë"

Proverb amerikano-indian
Për përdorimin dhe shfrytëzimin e hapësirës vendos një numër i madh i

subjekteve. Këto subjekte kanë interesa të llojllojshme në përdorimin dhe shfrytëzimin e saj, si dhe fuqi ekonomike të ndryshme. Të gjithë këta nuk janë ose nuk duan të jenë të vetëdijshëm se pjesë përbërëse e jetës sonë është rrethina, që formohet me ndërtimin e objekteve e me të cilën i kontribuohet edhe formësimit të ekonomisë dhe zhvillimeve në ambient në tërësi.

Mungesa e hapësirës është radhitur një prej 7 problemeve më të mëdha të botës së sotme. Ajo është e kufizuar, e paripërtëritur dhe e ndarë në mes të shumë shfrytëzuesve. Prandaj, si e tillë kërkon qasje shumë profesionale.

Për shkak të bazës së teorisë së varfër urbane në Kosovë, të bërë në nivelin më të ulët të mendimit shkencor, shumë pak plotësohen nevojat bashkëkohore për planifikim të mirëfilltë, të cilat reflektohen në pamjet urbarkitektonike "pa koment" në vendbanime dhe gjithkund përreth. Hulumtimi dhe aplikimi i metodave të reja shkencore në këtë aktivitet mendor specifik na imponohet si i pashtyrë, sepse ndërrimet e përsheptuara i kanë tejkaluar metodat me të cilat janë orientuar vendbanimet.

Planet rregullative joreale – problem mbi problemet

Në periudhën e pasluftës është e pranishme mënyra joreale e planifikimit. Synohet drejt planifikimit të gjendjes të qëllimshme, pa e vërtetuar realitetin e realizimit të tij.

Përkundrazi, planifikimi real nënkupton përshtatjet e zhvillimeve sociale, hapësinore, ekonomike dhe ekologjike të

të gjitha nënbashkësive, për të gjitha periodat e planifikuara në vazhdimësi. Për këtë kërkohet vetëdijësimi dhe ndërgjegjësimi i vendimmarrësve e profesionalistëve se duhet pasur parasysh faktin që çfarëdo mospërputhshmërie hapësinore dhe ekonomike e zhvillimeve të ndërsjella sjell lëvizje të vogla, të cilat në hapësirë lënë deformime afatgjate të konceptit planifikues.

Në Prishtinë dhe në shumicën e qyteteve në periudhën e pasluftës janë bërë plane zhvillimore, hapësinore dhe shumë plane rregullative. Sa kanë ndikuar këto plane në ndërrimin për së mbari të imazhit të Kosovës? Si janë punuar ato, në cilat standarde janë bazuar (kur dihet se këto të fundit mungojnë), kush dhe kur i ka prodhuar ato standarde? (Sepse edhe atyre u del afati!). A thua i ka reviduar ato dikush dhe si? Sa janë të zbatueshme? Sigurisht se këto pyetje kanë përgjigje, por përgjigjet nuk mjaftojnë për rezultate në hapësirë. Dhe për fund, si dhe sa janë menaxhuar këto plane? Planifikimi është mjet themelor strategjik për menaxhim të mirë. Këto dy koncepte janë të pandara; pa planifikim nuk mund të flasim për menaxhim dhe pa menaxhim planifikimi nuk është asgjë tjetër, përveçse thesar i qëllimeve të mira, tërësisht të ndara nga realiteti. Këtu kanë çaluar institucionet përgjegjëse në Kosovë!

Pamundësia e institucioneve ende të brishta, për të udhëhequr dhe menaxhuar plotësisht zhvillimin e planifikuar, ka sjellë në nevojën që urgjentisht të bëhet revidimi i tërësishëm i konceptit planifikues, duke përfshirë edhe atë të qëllimshëm.

Kësaj i kontribuon edhe zhvillimi i njohurive njerëzore për targetet e zhvillimeve bashkëkohore, të cilat janë bazë e konceptimit të qëllimshëm të hapësirës.

Pasi që në dy decaeniet e fundit në tërë botën janë ndërruar masat e vlerësimeve në raport me nevojat e zhvillimeve teknike dhe ndikimeve në ambient, ngrohja globale, Protokoli i Kyotos etj., me të cilin për herë të parë është treguar në një kufizim objektiv i zhvillimeve teknike, bile edhe në drejtim të shfrytëzimit të të mirave materiale dhe impaktit të tyre në natyrë.

Edhe pse Kosova ende nuk i ka vënë në jetë këta kufij, qysh tani në metodologjinë e shfrytëzimit të hapësirës lajmërohen kufizime të mëdha, të cilat do të ndikojnë në pamjen e planifikimit në të ardhmen. Standardet e ndërtimit të gjelbër, certifikimet LEED (Leadership Energy Efficient Design) e kufizime të tjera do të jenë obligime të pashmangshme në këtë milenium. Milenium në të cilin sigurisht që edhe në Kosovë „CO2 do të jetë valutë” (sasia e emetimi të dyoksidit të karbonit e paguar si gjobë).

Prandaj duhet sintezë bashkëveprimesh mirë të paramenduara, që Kosova të kalojë prej „planifikimit të qytetit” në një „qytet që planifikon”.

Banimi

„Struktura e vendbanimeve humane mbështetet në karrige me tri këmbë, një në politikë, një në ekonomi dhe e treta në transport...prej të cilave më e dukshmja dhe më aktivja është transporti. Është rregull i thjeshtë: si arrijmë, determinon si jetojmë ne”.

- Alex Marshall

Fillimi i këtij shekulli Kosovën dhe popullin e saj e gjeti në ndërrime historike, në dy aspekte, në atë politik dhe social. Pas luftës dyndjet e mëdha prej fshatit në qytet, si dhe ato qytet-qytet e gjetën vendin të papërgatitur për këto ndërrime. Edhe pse disa qytete kishin adoptuar plane urbanistike, realizimi i tyre ishte i vështirë. Kjo çoi në gjendjen kaotike si në banim ashtu dhe në infrastrukturë teknike e sociale dhe në ambient.

Zhvillimet në banim janë reflektim i sintezës së problemeve të trashëguara dhe të krijuara pas luftës. Ato janë shumë të dukshme, gjenden gjithkund ku sillemi, dhe do të kenë impakt nëpër gjenerata. Janë krijuar prej të gjithëve, duke qenë aktivë ose pasivë!

Sfida është që kjo sintezë të pësojë ndërrime, të cilat e çojnë Kosovën drejt ardhmërisë në Evropë.

Banimi është çështje vendimtare për stabilitet social, shëndet dhe zhvillim kualitativ të mirëqenies njerëzore. Kështu që, si shfrytëzuesi më i madh i hapësirës, ndikon në rrjedhën e zhvillimit të gjithëmbarshtëm të shoqërisë, zhvillimit ekonomik dhe ambiental.

Banimi është e drejtë sociale e qytetarit. E drejta në banim gjithnjë e më shumë është e pranishme në kuadër të politikave globale dhe në luftë për të drejtat njerëzore, e sanksionuar edhe me konventa ndërkombëtare.

Edhe pse pjesa më e madhe e jetës së njeriut zhvillohet në ndërtesa dhe rrethin material të saj, edhe pse aty kryhet pjesa më e madhe e nevojave njerëzore, lëmi heterogjen i banimit në Kosovë nuk është hulumtuar dhe nuk i është dhënë vendi meritor. Erupsioni urban, zhvillimet teknike dhe revolucioni shkencor më së shumti ka lënë impakt në jetë dhe banim, e posaçërisht në urbanizëm. Këtu vërehen rezultatet e progresit njerëzor dhe veprimeve njerëzore në tërësi. Prandaj planifikimi i banimit ka rol kyç në sigurimin dhe ofrimin e një ardhmërie të qëndrueshme.

A janë të shqetësuar institucionet për „zhvillimet e banimit në vendin e shqetësuar”?

Në programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, 2008 – 2011, çuditërisht as që është paraparë strategji për banim, bazë kjo për të gjitha zhvillimet e tjera, „për një Kosovë shtet të qytetarëve, të zhvilluar në përputhje me parimet demokratike, të një ekonomie të qëndrueshme, mjedisi shumetnik...” cituar nga programi. Banimi me gjasë është keqkuptuar si çështje individuale, prandaj qeveritarët nuk „dëshirojnë të çajnë kokën për të”.

Sigurisht është menduar „se kjo edhe më tutje duhet të jetë zgjidhje individuale”. Por nuk është paraparë se kjo është çështje madhore, e cila implikon dëme të parevidueshme për komunitetin, ambientin dhe ekonominë.

Edhe në Strategjinë afatmesme zhvillimore të Prishtinës 2008-2011, vizioni për të ardhmen e Prishtinës: „Prishtina- kryeqytet i Kosovës, me rol metropolitan, e njohur për zhvillim ekonomik me urbanizëm bashkëkohor” as që ka një plan strategjik për zhvillimet urbane. Përkundrazi, kjo është një pjesë „narrative” e gjendjes ekzistuese.

Në synimin e tretë të kësaj strategjie, zhvillimi i qëndrueshëm hapësinor dhe urban as që parasheh si objektiv zhvillimin e banimit. Në vend të tij, në objektivin e dytë parashihet hartimi i planeve rregulluese për lagjet e mbetura, duke e ngatërruar hartimin e planeve si një aktivitet për realizimin e objektivit të banimit. Ky „lëshim” është munduar të kompensohet me objektivin e katërt, ku është paraparë „zhvillimi i partneritetit publiko-privat në ndërtimet urbane” (por, asgjë decideve për banim)! dhe me kaq „hiqet qafe gajlla e banimit” në këtë strategji.

Po pra, edhe në nivelin komunal, si në atë qendror, çështja e banimit është lënë të zgjidhet individualisht, QËLLIMISHT OSE PAVETËDIJE!

Për realizimin e politikave dhe praktikave zhvillimore të banimit dhe komunitetit të mirë afekton një plan strategjik i qartë, i cili parasheh:

- Forcimin e tregut të banimit që përkrah ekonominë dhe mbrojtjen e konsumatorit;
- Përmbytjen e kërkesave për njësi banesore të favorshme (ekonomikisht të përballueshme);
- Përdorimin e banimit si platformë për përmirësimin e kualitetit të jetës;
- Ndërtimin e komuniteteve gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme pa diskriminim.

Prandaj le të jetë kjo pikënisje për qëllime të mbara të vendimmarrësve.

VIZIONI PËR KOSOVËN

Përparim Rama



Sheshi -hapësire hecqeje ndërmjet Parlamentit dhe Komisionit Evropjan-Bruksel

Zhvillimet e reja në qendrën e Prishtinës dhe rrethinën e saj ofrojnë mundësi të mëdha për të ndihmuar në konkurrimin e saj në tregjet globale. Këto zhvillime të reja jo vetëm që ndihmojnë përparimin e zhvilluesve, porse me planifikim të kujdesshëm mund të transformohen në katalizatorë të rigjenerimit të Prishtinës dhe të Kosovës në përgjithësi.

Sfida lokale – mundësia globale -

Rreth gjysmë milioni, nga dy milionë shqiptarë kosovarë, janë vendin gjatë viteve të turbullta të 90-tave. Shumë nga ta mund të mos jenë kthyer më për qëndrim të përhershëm në Kosovë, përderisa industritë në rritje, të bazuara në njohuri dhe shërbime, do të mund të ndihmonin në rivitalizimin e vendeve të tyre të lindjes. Zhvillimet e reja në Prishtinë së bashku me programet bashkërendëse mund të luajnë një rol të rëndësishëm në joshjen e kësaj pjese të shoqërisë, duke u mundësuar atyre të kontribuojnë në transformimet e Kosovës. Njëri ndër shembujt më të njohur të kësaj dukurie është komuniteti i ardhur në Silicon Valley. Më shumë se një e treta e forcës së punës në sektorin e teknologjisë së lartë janë kinezë, aziatikë juglindorë dhe emigrantë indianë, të cilët edhe janë gjenerata e parë e qytetarëve të SHBA-së. Tani ky komunitet është duke u kthyer, nëse jo për tërë kohën, porse rregullisht duke themeluar apo nisur biznese të reja dhe partneritete me kompanitë nga vendet e tyre të origjinës. Ata nuk udhëheqin vetëm kompani multinationale, porse edhe tentojnë të mbështesin ndërmarrësit që për përfitime ekonomike ofrojnë një hallkë të shërbimit me ndonjë nga firmat lokale apo partneriteti, të cilët shpesh janë miq të

familjes apo nga universiteti.

Mundësi të ngjashme ekzistojnë dhe për diasporën kosovare, si një motor të fuqishëm për regjenerimin e saj të ardhshëm.

Kosova ka një numër të konsiderueshëm të përparësive të rëndësishme për regjenerimin e saj:

Lidhje të mira me qytete tjera në Ballkan dhe më gjerë në Evropë, përmes aeroportit të klasifikimit të lartë ndërkombëtar, me më shumë se një milion udhëtarë në vit dhe lidhje direkte me Londër, Vjenë, Stamboll, Budapest, Cyrih, Tiranë, Frankfurt, Kopenhagë, Stokholm dhe shumë destinacione të tjera. Popullatë të re në shumicë me arsim dhe njohuri të mira, më të renë në Evropë. Moshë mesatare është 24 vjet.

Rreth gjysmë milioni që jetojnë jashtë Kosovës kontribuojnë në komunitetet e tyre lokale me të ardhura për rreth \$1 miliard USD dhe mbi të gjitha me një besnikëri të fuqishme dhe dashuri për vendlindjen e tyre.

Mbështetje financiare sinjifikante nga jashtë për Kosovën, si për një shtet të ri të pavarur.

Vizioni për Prishtinën: Qendër e rëndësishme logjistike dhe e inovacionit

Zhvillimet e reja të propozuara mund të ripërtërijnë qendrën e qytetit, duke mbështetur ndërtimet e ulëta dhe të vjetra me zhvillime të reja dhe ikonike; për të qenë të rolit të inspiruesit jo vetëm për Kosovën, por dhe për shtetet e tjera të Ballkanit. Kjo lëvizje inspiruese do të mund ta vendoste Prishtinën në zemër të Ballkanit sikurse një qendër të inovacioneve për biznese të shumta nacionale dhe ndërkombëtare,

sikurse dhe si qendër e rëndësishme logjistike.

Këto zhvillime mund të ofrojnë kombinime për selitë qendrore të kompanive të mëdha dhe të suksesshme si në: telekomunikim, shërbime bankare, zyra kombëtare lokale për firma multinationale të cilat janë në rritje në Ballkan, duke shërbyer si kompani të mëdha kosovare porse dhe gjetiu në vendet e Ballkanit. E gjithë kjo do të ishte mundësuar dhe mbështetur nga logjistika e përkryer. Firmat e tilla kanë nevojë për biznese të vogla, të cilat zhvillimet e reja mund t'ju ofrojnë, mirëpresin dhe mundësojnë të gjitha këto.

Grupimet e industrisë: bizneset, arsimit, sektori publik dhe financiar së bashku

Universiteti duhet të jetë i inkurajuar për të qenë në shërbim të bizneseve të teknologjisë së lartë me kurse të ndryshme për studentët, si dhe qendrave shkencore për sektorë të ndryshëm, sikurse që mund të jenë: mediat digjitale dhe e-mësimet. Mund të parashihen projekte për partneritete të ndryshme ndërmjet universitetit, institucioneve shkencore, sektorit privat dhe publik të cilët përdorin fonde ndërkombëtare dhe stimulojnë krijimin e bizneseve të reja.

Këto biznese mund të përfitojnë nga një inkubator, i cili ofron infrastrukturën, "të dish – si" platformën dhe financat për të mbështetur këto biznese, qofshin ato të dala apo të ofruara nga universiteti, apo nga firmat nacionale ekzistuese.

Mbërritja – Një program i mbërritjes drejt këtyre zhvillimeve të reja ikonike mund të zgjerohet në diasporën kosovare, duke iu dhënë mundësi për riinvestime në

vendin e tyre të lindjes dhe duke mbështetur ndërmarrësit lokalë, të dalë nga shkollat e bizneseve dhe institucionet për dizajn dhe teknologji.

Shërbimet e avancuara – Agorë për inovacione – Zhvillimet e reja do të duhej gjithashtu të ofrojnë jo vetëm hotele për të mbështetur komunitetin e biznesit ndërkombëtar, të cilët fillimisht do të mbështesin zhvillimin e firmave lokale dhe do t'u shërbejnë nevojave të firmave më të mira kombëtare, porse gjithashtu do të ofrojnë dhe apartamente për qëndrime të shkurtra sikurse dhe hotele-zyra me hapësira fleksibile për biznese me nevoja për qëndrime të shkurtra. Është me rëndësi për të qenë i aftë, për të joshur dhe mbajtur gjithashtu firmat lokale, me një laramani të hapësirave të ndryshme në kuptim të hapësirave kulturore, tregtare dhe rekreacionit e pushimit, po ashtu shumë të nevojshme. Këto hapësira mund të ofrojnë shumë gjatë rritjes së shpejtë të klasës së re profesionale të Kosovës, me kosovarë të kthyer nga jashtë, komunitetin e biznesit ndërkombëtar dhe gjithashtu ofrimin e formave të reja për turizëm kulturor dhe eko – turizëm (më mirë se autostoperë). Universiteti me hapësirat e tij mund të shërbejë dhe për mbajtjen e konferencave ndërkombëtare për të siguruar shfrytëzim sa më të madh të këtyre hapësirave, përderisa këto do ta poziciononin Prishtinën si një Agorë ballkanike të inovacionit.

Kombinimi i biznesit me artin bën biznese të mira – Së bashku me



Dizajn urban atraktiv i paternit në një qendër të Brukselit

zhvillimet kryesore, qyteti mund të shërbejë si hapësirë me distrikte arti – me riparime modeste të objekteve të vjetra ekzistuese, të cilat do të mund të shërbenin nga artistët dhe disenjatorët. Kjo qasje mundëson krijimin e një "hapësire të imagjinatës", e cila inkurajon më shumë aktivitete avangarde dhe kulturore sesa aktivitete biznesore, mirë të njohura dhe tipike për qytetet e ripërtërirra. Komunitetit ndërkombëtar i nevojiten këto hapësira më shumë se vetëm hotelet e mëdha dhe restorantet e mira. Nga hulumtimet dhe përvoja e qyteteve të tjera, për të startuar dhe marrë këmbët mbarë ky komunitet, nevojitet të gjinden mënyra më personale sesa të

merren me brende të njohura dhe me tregun e artizanëve.

Nga projektet të cilat në kemi ndërmarrë në qendër të qytetit apo dhe zonat më të largëta të Londrës, shohim mundësinë për qytetin e Prishtinës, si dhe për shumë qytete-rajone të tjera, të zhvillimeve pronësore, të cilat shërbejnë si katalizatorë për regjenerim masiv, me investitorë po ashtu dhe ndërkombëtarë. Kjo dukuri ndodh dhe në shumë shtete fqinje, përfshirë këtu dhe shtetet të cilat posa aderuan në BE. Kjo mund të luajë rol të rëndësishëm në zhvillimin e komunitetit dhe krijimin e konceptit për *qytetar të ndërlidhur mirë*.

Zhvillimi i komunitetit: Qytetar i Ndërlidhur Mirë – Këto projekte duhet të kenë qasje globale me komponentë të zhvillimit të komunitetit, me platformë dhe perspektivë sociale. Themelimi i platformës globale sociale/ekonomike për shqiptarët e Kosovës që jetojnë jashtë saj – mund të jetë një mënyrë e mirë për mbledhjen e informatave dhe ndërtimin e konsensusit /besimit ndër kosovarë të shpërndarë gjithandej në shumë kontinente. Programi për ndërlidhje të mirë mund të nënvizojë gjithashtu çështje të politikës së qeverisë, për zgjidhje të mundshme për kosovarët jashtë shtetit, gjenerimit të vlerave ekonomike dhe sociale për ata të cilët mbesin jashtë Kosovës, por gjithsesi ende të lidhur ngushtë me vendin e tyre të origjinës. Tani vonë, Ministria e



Parku i skulpturave në Koln



Parku i Universitetit Erasmus ne Rotterdam

themeluar për Diasporë duhet të angazhojë dhe gjerë mundësitë e shumta proaktive.

Ne duhet të kuptojmë dhe pranojmë rëndësinë e pasjes së platformës sociale/biznesore për t'u ndërlidhur me të kaluarën, platformë për të mbetur në kontakt (duke qenë prezent dhe i qasshëm pa marrë parasysh distancën), platformë me të cilën di se ku të shkosh për ndihmë apo mbështetje, duke "identifikuar" mundësitë për bizneset e reja, ku mund të shprehësh pikëpamjet politike për vendin apo hapësirën për të cilën mendojnë ata të identitetit të ngjashëm me ty, për ndërlidhje të përhershme të suksesshme. Kur shumë anëtarë të komunitetit kosovar jashtë Kosovës do të shikojnë të rikthehen në vendet e tyre të origjinës, do të kthehen sipas mënyrës e cila ka kuptim të ri për ta, në kontekst të ri, duke pranuar sesi së bashku me ndryshimet e mjedisit ku ata janë rritur do të ketë dhe më shumë ndryshime të shumta për jetët e tyre. Është me rëndësi të thuhet se e tërë kjo lëvizje e mundshme do të jetë nga vetë

komuniteti dhe rrënjët e tyre porse dhe e cila mund të mbështetet dhe inkurajohet përmes infrastrukturës, shërbimeve dhe programeve të përshtatshme.

Vlerat e qytetarëve të ndërlidhur në pika të ndryshme takimi –

Qytetari i ndërlidhur në aspektin global/lokal është qytetar i vlefshëm në shumë mënyra, duke pasuruar kombin në aspekt kulturor, social dhe ekonomik. Evolucioni/revolucion i të dhënave mund të ndihmojë në krijimin e mundësive për kapacitete dialogu kuptimplotë ndërmjet individëve, firmave, organizatave dhe agjencive publike. Programi për ndërlidhshmëri globale mund të jetë një projekt në programin e përgjithshëm dhe mund të ketë vlera sinjifikante sociale dhe ekonomike. Për shembull, kursi social mund t'i bashkëngjitet çdo programi të ndërlidhshmërisë, për të mundësuar që njerëzit të riorientojnë investimet e tyre në rigjenerimin e vendlindjes së tyre në mënyrën e cila ka kuptim për ta. Përderisa kursi social nuk është "politikë taksapaguese", ai mund të ndihmojë në

përmirësimin e jetës sociale, kulturore dhe ekonomike të njerëzve në përgjithësi, investimeve të tyre në skemën e mbështetjes për zhvillim të NVM-ve, për ndërlidhje më të fuqishme në zinxhirin e funksionimit.

KONKLUZION – Zhvillimet e reja ofrojnë mundësi për krijimin fizik dhe virtual të pikave të takimit. Pikat e takimit janë me rëndësi për shkëmbimin e njohurive dhe zhvillimin e bizneseve, përderisa bizneset sikurse dhe relacionet shoqërore janë të raporteve person-person. Ofrimi i hapësirës dhe programeve për të mbështetur pikat e takimit në aspekt fizik dhe digjital do të jetë elementë me rëndësi në realizimin e suksesshëm drejt këtij vizioni. Kjo mundësi për ndërlidhjen e shumë aspekteve sociale, arsimore sikurse dhe aspekteve biznesore në një të përbashkët, duhet të mundësohet përmes një skene të përgjithshme për një të ardhme të qëndrueshme të kryeqytetit, Prishtinës, qytetarëve të tij dhe të Kosovës si të tërë.

ROLI I GIS-IT NË PLANIFIKIMIN DHE MENAXHIMIN URBAN

Rizah Murseli

Çka është GIS-i?

GIS-i, në përkthim në gjuhën shqipe d.m.th. Sistemi Informativ Gjeografik (SIGJ) dhe për të ka shumë përkufizime. Një ndër këto përkufizime është ky: Sistemi Informativ Gjeografik është një sistem kompjuterik për mbledhjen, grumbullimin, verifikimin, integrimin, manipulimin, analizimin dhe prezantimin e të dhënave të lidhura me lokacionin (gjeografik) në sipërfaqen e tokës.

GIS-i i organizon të dhënat gjeografike në një seri shtresash dhe tabelash tematike duke përdorur platformat e DB-së, si excel, access dhe platformat e fuqishme, si janë SQL, ORACLE etj. Këto platforma të ruajtjes së të dhënave në GIS quhen GeoDB (Geodatabase). Meqenëse këto të dhëna në GIS janë të gjeoreferencuara, atëherë ato kanë lokacionin ose vendndodhjen e tyre reale në botë (planet) dhe mund të mbishtresohen në mes vete. GIS-i mundëson integrimin dhe analizimin e të gjitha shtresave tematike dhe si rezultat paraqet përfytyrimin real të një hapësire në modelin e gjendjes ekzistuese ose edhe në modelin e gjendjes së planifikuar. Gjithashtu përmes modeleve të dizajnuara mund të kalkulojmë impaktet e ndryshme të çdo skenari të dizajnuar ose zhvilluar.

Në mënyrë që GIS-i të bëhet funksional duhet të përdorë pesë nga komponentët e tij esenciale, siç janë:

Të dhënat - janë informata që duhet të analizohen dhe të prezantohen;

Hardueri - janë komponentë që e fuqizojnë sistemin;

Softueri - janë tullsat e nevojshme që



Harta e Kosovës sipas Planit Hapësinor të Kosovës (Burimi: IPH)

GIS-i të operojë;

Operatorët (njerëzit) - janë ata që menaxhojnë dhe e dizajnojnë sistemin; dhe

Metodat - janë ato që e bëjnë këtë sistem të japë rezultat.

Komponentët esenciale të funksionalizimit të GIS-it

GIS-i na mundëson që të dhënat t'i shikojmë, t'ikuptojmë, t'i interpretojmë dhe t'i vizualizojmë në forma të ndryshme, ku mund të zbulojmë ndërlidhje të ndryshme hapësinore, modele dhe trendë në formë të hartave, globit, raporteve dhe grafikoneve. GIS-i gjithashtu mundëson të përgjigjemi në pyetjet dhe të zgjidhim probleme duke shikuar në të dhënat, në mënyrë shumë të shpejtë dhe lehtësuese dhe duke mundësuar shpërndarjen e shpejtë të tyre. Teknologjia e GIS-it mund të integrohet lehtësisht në çdo kornizë të sistemeve të informacionit apo data bazave.



Skema e integritit të informatave tematike në GIS

Në ditët e sotme gjeografia e shoqëruar me GIS-in është duke na ndihmuar neve që të kuptojmë më mirë planetin tonë, vendin tonë, qytetin tonë ose edhe lagjen tonë dhe të aplikojmë njohuritë gjeografike për një mori të aktiviteteve njerëzore. Rezultati është lindja e një qasjeje të re në gjeografi ose mënyrë e re e të menduarit në zgjidhjen e problemeve që integron informacionin gjeografik në mënyrën se si ne e kuptojmë dhe menaxhojmë hapësirën tonë. Kjo qasje na lejon që të krijojmë njohuri gjeografike duke matur vendbanimin tonë përmes organizimit të këtyre të dhënave, dhe duke bërë analizimin dhe modelimin e proceseve të ndryshme, si dhe ndërlidhjet mes këtyre proceseve ose zhvillimeve. Kjo qasje e re gjithashtu na lejon të aplikojmë këtë njohuri në mënyrën se si ne e dizajnojmë, planifikojmë dhe ndryshojmë planetin tonë, vendin tonë, qytetin tonë ose edhe lagjen tonë.

Është e rëndësishme të kuptohet që zhvillimi urban është zhvillim mjedisor, social, ekonomik dhe teknologjik. Planifikimi dhe menaxhimi i zhvillimeve në këtë kohë moderne është një sfidë me përmasa botërore. Shpërndarja globale e teknologjisë dhe e aktiviteteve ekonomike vazhdojnë të ndikojnë drejtpërdrejt mbi qytetet ose vendbanimet e madhësive të ndryshme. Qytetet duhet të shihen si një kompleks fiziko-gjeografik, social, ekonomik dhe teknologjik i ndërlidhur në një rrjet ankorimi të përmasave lokale dhe globale. Sidoqoftë, jo të gjitha qytetet i ndajnë të njëjtat përparësi në kuptimin e zhvillimeve pozitive. Në këtë kohë të

transformimeve globale, qytetet janë duke konkurruar ashpër për tërheqjen e kompanive (ndërmarrjeve të suksesshme), krijimin e vendeve të punës dhe hapjen e mundësive për investim. Qytetet të cilat janë të lidhura në rrjetin ndërkombëtar të transportit, dhe komunikimeve, imazhi i tyre mund të qarkullojë shumë më lehtë dhe mund të jenë fitues në shumë aspekte, ndërsa qytetet të cilat janë jashtë këtij rrjeti komunikimi zhvillohen në një rrezik të ndarjes mobile në shtresa, ku mënyra e vetme e të jetuarit bazohet në fuqinë ekonomike. Një konkurrim i qyteteve i këtij lloji i shpie zhvilluesit, politikëbërësit dhe planerët të mendojnë rreth identitetit të veçantë të qytetit të tyre në kontekstin global urban.

Këta trendë zhvillimi nënkuptojnë që shoqëria urbane ka nevojë për plane, vizione dhe udhëzime për intervenime në këtë kontekst kompleks. Me qëllim të rritjes pozitive të zhvillimeve urbane në aspektin social, ekonomik, mjedisor dhe teknologjik, si dhe zvogëlimin e efektit negativ të këtyre aspekteve duhet të bëjmë analiza të mira, vizione realiste dhe zgjidhje të shëndosha multidisiplinare. GIS-i në këtë dimension është sistemi më i përshtatshëm për të bërë të gjitha analizat e duhura të kompleksitetit urban që mundëson krijimin e vizioneve realiste dhe gjetjen e zgjidhjeve multidisiplinare.

Të arriturat e ndihmuara nga zhvillimi i teknologjisë kanë mundësuar zhvillimin e teknologjive të avancuara, siç është GIS-i, avancimi i sistemit të përkrahjes së vendimmarrjes duke përkrahur fuqimisht procesin e planifikimit dhe menaxhimit urban.

Sistemet e përkrahjes së planifikimit dhe menaxhimit janë instrumente të suksesshme për procesin e planifikimit në komunitet dhe në procesin e pjesëmarrjes publike për shkak që fokusohen në nevojat reale dhe në njohuritë e përdoruesve, dhe nuk fokusohen në ekspertiza të larta të përdorimit të GIS-it. Sistemet përkrahëse të planifikimit mund të matin dhe të krahasojnë performancën e skenarëve të ndryshëm të zhvillimit nga planerët, si dhe mundësojnë që qytetarët të përzgjedhin indikatorët e shfrytëzimit të tokës, transportit, resurseve natyrore

dhe punësimit. Qëllimi përfundimtar është që të sjellë të gjithë lojtarët potencialë për të punuar bashkërisht në një vizion të përbashkët për komunitetin e tyre. Sistemi përkrahës i planifikimit i mbështetur në shfrytëzimin e GIS-it i mundëson planerët dhe qytetarët që në mënyrë të shpejtë dhe efektive të krijojnë dhe të testojnë skenarët alternativë të zhvillimit për të kuptuar ndikimin e mundshëm të tyre në modelet e shfrytëzimit të ardhshëm të tokës, popullsisë dhe në trendët e punësimit, duke lejuar zyrtarët publikë që të bëjnë vendimmarrjen në bazë të planifikimit të mirëinformuar.



Skema e integritetit të informatave tematike në GIS

Në vendin tonë, Kosovë, GIS-i për nevojat e planifikimit hapësinor për herë të parë është përdorur gjatë hartimit të planit hapësinor të Kosovës, duke filluar nga viti 2004, ku edhe është bërë specializimi i stafit. Ndërsa përdorimi i GIS-it në nivelin akademik apo universitar për herë të parë është bërë dhe vazhdon të zhvillohet me një staf të specializuar të Fakultetit të Shkencave Matematiko-Natyrore, gjegjësisht në Departamentin e Gjeografisë. Gjithashtu GIS-i ka filluar të aplikohet si lëndë edhe në disa fakultete të tjera të Universitetit të Prishtinës.

Sidoqoftë, fuqizimi i GIS-it për nevojat e planifikimit hapësinor dhe urban vazhdon të promovohet nga Instituti për Planifikim Hapësinor, ku nga ky promovim GIS-in kanë filluar ta zbatojnë edhe shumë komuna dhe kompani private që merren me çështjet e planifikimit. Është me rëndësi të

përmendet që ardhja e konsulencave të huaja ka qenë jetike në fuqizimin e GIS-it në Kosovë, si në nivelin qendror ashtu edhe në atë lokal. Në Kosovë fuqizimi i përdorimit të GIS-it për nevojat e planifikimit hapësinor ka filluar si pionier me Institutin për Planifikim Hapësinor gjatë hartimit të Planit Hapësinor të Kosovës 2005-2015+, ndërsa ndër komunat e para që e kanë përdorur këtë sistem kanë qenë: Suhareka, Peja, Istogu, Shtimja, Kaçaniku etj, të cilat e kanë përdorur GIS-in gjatë hartimit të planeve zhvillimore komunale dhe urbane.

Kohëve të fundit GIS-i po shfrytëzohet si një vegël shumë e fuqishme edhe në hartimin e Planeve Rregulluese Urbane (PRrU), sidomos në prezantimin e gjendjes ekzistuese, ndërsa shumë pak apo fare nuk përdoret për fazën e planifikimit në këtë kategori të planeve. Kjo ndodh për shkak të ndryshme, mirëpo ndër më të njohurat është mungesa e specialistëve të shkathët që mund të manipulojnë me GIS për nevojat e PRrU-së dhe për shkak të moskuptimit të drejtë të mundësive të këtij sistemi dhe avantazheve që ofron GIS-si në krahasim me sistemet e tjera tradicionale, si CAD sistemi dhe programet e tjera për dizajn grafik, siç mund të jetë Corel apo Adobe.

Në përgjithësi mund të konkludojmë që niveli i përdorimit të GIS-it në Kosovë për nevojat e planifikimit hapësinor dhe urban është bazik. Deri më tani nuk është përdorur apo nuk është dizajnuar asnjë model i përdorimit në adresimin e asnjë çështjeje urbane. Përrjashtim në këtë rast bëjnë zhvillimet e koncepteve dhe modeleve të avancuara në projektin e konsulencës së EULUP-it, ku janë dizajnuar një mori modelesh kryesisht për nevojat e planit hapësinor dhe nevojat e planeve zhvillimore komunale. Ndërsa, për çështje të tjera të nivelit më detaj ende nuk kemi asnjë model të dizajnuar dhe si rrjedhojë edhe përdorimi i GIS-it është në shkallë shumë të vogël të shfrytëzimit të mundësive që ofron ky sistem shumë i avancuar.

(Autori është Gjeograf & GIS specialist)

ZHVILLIMET URBANE KARSHI MENAXHIMIT TË PATUNDSH- MËRIVE NË KOSOVË

Visar Hoxha



Roli i menaxhimit të patundshmërive

Në ekonominë e Kosovës kanë ndodhur dy transicione të mëdha, të cilat kanë ndikuar në zhvillimet urbane gjatë viteve. E para, ishin lëvizjet nga viset rurale në ato urbane, ndërsa tjetra ishte transformimi nga planifikimi qendror në atë të ekonomisë së tregut. Ekonomia e Kosovës varet nga aftësia e tij për të zhvilluar tregun dhe shërbimet konkurruese, sikurse industriale dhe të shërbimeve, në tërë vendin. Këto aktivitete, të bazuara në zgjidhje urbane pikësëpari, reflektojnë dhe mënyrën se si menaxhohen patundshmëritë në Kosovë.

Mundësitë ekonomike në zonat urbane rezultuan me rritjen e popullatës urbane, të cilat ndikuan në migrimet sinjifikante ruralo-urbane. Kosova është në një pikë kyç në progresin e saj drejt zvogëlimit të papunësisë dhe varfërisë. Infrastruktura adekuate është esenciale për të zvogëluar shkallën e varfërisë në Kosovë, të përmirësimit të kualitetit të jetës dhe përsheptimit të zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm. Zhvillimi i prekshëm gjithashtu varet nga menaxhimi i urbanizimit. Infrastruktura bazike në Kosovë përballet dhe me problemet serioze mjedisore, ndër të cilat zë vend dhe menaxhimi i joefikas i mbeturinave. Rritja e paplanifikuar është duke marrë hov në pjesët periferike të qyteteve në Kosovë, shpesh pa qasje adekuate në infrastrukturë, që më parë. Vendosja e infrastrukturës, në një zhvillim të paplanifikuar, është shumë më e shtrenjtë për autoritetet lokale sesa ndërtimi i infrastrukturës së re, si pjesë e zhvillimit të planifikuar. Kosovës i nevojitet një strategji për zhvillimet e

integruara urbane, që mund të promovojë më me efikasitet zhvillimin ekonomik, e cila mund të arrihej përmes menaxhimit më efikas të procesit të urbanizimit në Kosovë.

Në Kosovë mund të shihet se kemi mungesë të pikëvështrimit strategjik nga autoritetet lokale të qyteteve. Qytetet në Kosovë hynë në mileniumin e ri, pa menaxhim urban efektiv apo infrastrukturë, për të përbushur rolin e qyteteve, të cilin do të duhej ta kishin në ekonominë e tregut.

Në botën moderne zhvillimi urban dhe menaxhimi i patundshmërive është i planifikuar në detaje. Banimi individual tenton t'i shërbejë funksionalitetit, absorbimit të dritës dhe rehatisë. Zhvillimi urban gjithashtu duhet të gjejë balancën mes qëllimeve të sektorit privat dhe publik, në ekonominë e tregut (Harvey 1973). Në Kosovë forca e zhvillimit të patundshmërive është e udhëhequr nga përfitimet enorme, si pasojë e zhvillimeve urbane të paplanifikuara, për dallim nga zhvillimet urbane, të cilat do të duhej të ishin të planifikuara dhe me ndikim në rregullimin e hapësirës.

Në demokracitë moderne zhvillimet urbane të planifikuara, përbushin dëshirat dhe nevojat e njerëzve në kuadër të kontekstit legal të definuar, duke integruar çështje të ndryshme siç janë: transporti, energjia, punësimi dhe ofrimi i shërbimeve të tjera të interesit publik. Në Kosovë, tregu i patundshmërive dhe zhvillimet urbane nuk janë në baraspeshë, gjë që do të duhej të ishte dhe do të duhej ofruar përmes

shërbimeve adekuate për arritje të qëllimeve ekonomike.

Në rast të zhvillimit urban të planifikuar, shfrytëzimi i tokës varet nga konkurrenca për shfrytëzim të mundshëm dhe të ndryshëm, që rregullohet me mekanizëm të ofertës dhe kërkesës. Në Kosovë tregu i patundshmërive dhe zhvillimet urbane operojnë në formën "laissez faire", ku shfrytëzimi i tokës është kryesisht i udhëhequr nga përfitimet enorme të zhvilluesve të patundshmërive, pa ndonjë përkujdesje për zhvillime urbane të pakontrolluara, të cilat shkaktojnë efekte shkatërruese për gjenerata të ardhshme.

Në këtë kuptim Prishtina nuk është vetëm qyteti me dendësi më të madhe, por një zonë e tërë në të cilën, zhvillimi i patundshmërive ishte shumë aktiv përgjatë viteve të fundit, me efekt shumë të madh në planifikimet urbane. Planerët, agentët e patundshmërive dhe zhvilluesit e patundshmërive në Kosovë pranu se pavarësisht nga afërsia me shkëmbimet sociale dhe simbolizmit social, ndërtimet sot nuk paraqesin relacionet dhe perceptimet e planerëve për rregullim të hapësirës. Në Kosovë mund të shihet se ekziston një nivel sinjifikant i lëkundjes ndërmjet elitave politike, për të përbushur interesat e tyre në hapësirën kosovare, dukuri kjo e cila qëndron në mes të politikës, historisë dhe aktualiteteve për formësim të vendit, të manifestuar në formën e zhvillimit të qyteteve në Kosovë.

Planifikimi urban është i definuar si: "Bregë e qeverisë për shfrytëzimin e resurseve si segment të administrimit



Shfrytëzimi i pronës dhe objekteve me planin e konservimit të Prizrenit

publik” (Solesbury 1974). Në Kosovë, nevoja për zhvillim të planifikuar urban duhet të bashkekzistojë me nevojat e tjera për liri të lëvizjes apo pasaporta biometrike. Planifikimi urban duhet të jetë prioritet i administrimit publik, për të arritur balancimin e duhur ndërmjet të mirës individuale dhe përfitimeve kolektive.

Konservimi i objekteve historike, të cilat përfaqësojnë identitetin e njerëzve, konsiderohet si e mirë kolektive. Në Kosovë konservimi i objekteve historike

është bërë viktimë e betejës ndërmjet elitave të ndryshme politike dhe të biznesit.

Nuk është befasi që presioni politik ndikon fuqishëm në mënyrën se si planerët do të rregullojnë hapësirën në Kosovë, e cila reflektohet përmes presioneve politike në vendimet e planerëve. Ky presion ka për shkak zhvillimin e sektorit të patundshmërive dhe përfitimet e tyre enorme, të cilat janë të kanalizuar përmes përfaqësuesve të tyre politikë në nivelin qendror dhe lokal.

Sfida më e madhe është ndërtimi i kapaciteteve të nevojshme në qeveritë lokale dhe ndryshimi i sjelljes së zyrtarëve të qeverive lokale, të cilët merren me zhvillimin e qytetit dhe zhvillimin e planifikuar të patundshmërive prej pozitive pasive të tyre në ato më shumë proaktive.

(Autori është drejtor i Programit për Menaxhimin e Patundshmërive, European School of Law and Governance)

LEGJISLACIONI NË ZHVILLIMET URBANE NË KOSOVË

Vjosa Vela



Konsulentët në planifikim

Hyrje

Legjislacioni paraqet mekanizmin kryesor përmes së cilit një shtet modern i harton ligjet dhe rregulloret që rrjedhin nga ligjet, të cilat formojnë bazën mbi të cilën shoqëria qeveriset dhe që vazhdimisht reflektojnë normat dhe vlerat e një shoqërie të caktuar. Kjo nënkupton një njohje themelore se ligjet dhe legjislacioni nuk janë vetëm dokumente teknike, por një pjesë e rëndësishme e zhvillimit shoqëror dhe politik të çdo shoqërie. Zhvillim urban efikas, i barabartë dhe i qëndrueshëm, varet në një masë të madhe në ekzistencën dhe angazhimin për zbatimin e ligjeve. Sfidat me të cilat përballlet Kosova nuk janë vetëm miratimi i ligjeve, por krijimi i mekanizmave për zbatimin e tyre.

Disa aspekte ligjore të zhvillimit urban në Kosovë

Zhvillimi urban gjithmonë ka qenë një çështje e diskutueshme politike. Askush nuk merret saktësisht se si duhet të dizajnohet një qytet, i cili jo vetëm se duhet të zhvillohet ekonomikisht, por do të mundësojë një cilësi të mirë të jetës për banorët e tij.

Kosova si dhe të gjitha shtetet e dala nga luftërat ka pasur migrim dhe normë të lartë të rritjes së popullsisë urbane, të cilat kanë krijuar presione në qeverinë qendrore dhe lokale. Strukturat politike dhe administrative nuk kanë qenë të gatshme për një menaxhim dhe trajtim adekuat të rritjes së popullsisë urbane. Qytetet dhe fshatrat nuk kanë ditur në masë të duhur t'i adresojnë sfidat sociale dhe mjedisore, nevojat e infrastrukturës, mungesën e tokës ndërtimore në dispozicion dhe mungesën e politikave të planifikimit.

Edhe pse periudha e pasluftës ka pasur zhvillime të pakontrolluara urbane, nuk mund të thuhet se nuk ka pasur legjislacion për rregullimin urban të qyteteve dhe fshatrave. Menjëherë pas luftës është nxjerrë Rregullorja e UNMIK-ut, nr.1999/24, e datës 12 dhjetor 1999, për ligjin në fuqi në Kosovë, e cila e lë në fuqi legjislacionin në Kosovë prej 22 marsit 1989 e tutje, në pjesët ku nuk janë diskriminuese, gjer në nxjerrjen e ligjeve të reja të miratuara nga Kuvendi i Kosovës. Kështu në vitin 2003 nxirret Ligji për Planifikim Hapësinor nr. 2003/14, i cili rregullon planifikimin hapësinor në tërë territorin e Kosovës, i amendamentuar më pas me Ligjin nr. 03/L-106 për Ndryshimin e Ligjit nr. 2003/14 për Planifikim Hapësinor. Më pastaj nga Kuvendi i Kosovës nxirret Ligji për Ndërtim nr. 2004/15. Këto dy ligje dhe udhëzimet administrative të nxjerra nga këto ligje e kanë mbuluar legjislacionin sa i përket planifikimit dhe ndërtimit në territorin e Kosovës.

Komunat, edhe pse me Ligjin për Planifikim Hapësinor nr. 2003/14 kanë qenë të obliguara që brenda 18 muajsh të hartojnë planet hapësinore dhe urbanistike sa u përket territorit të tyre, këtë gjë nuk e kanë bërë. Me ndryshimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor komunave u është dhënë edhe një afat shtesë prej 12 muajsh për hartimin e planeve hapësinore dhe urbanistike dhe përsëri të gjitha komunat nuk i kanë hartuar planet e tyre brenda këtij afati. Kjo mund të jetë një nga shkaqet e zhvillimeve të pakontrolluara urbane në Kosovë. Por, për të mos ndodhur këto zhvillime të pakontrolluara, Ligjit për Planifikim Hapësinor përkatësisht neni 24 dhe neni 16 i Ligjit të ndryshuar ka paraparë që, citoj: "Në raste të veçanta, kur ende nuk është

miratuar Plani Zhvillimor i Komunës dhe/ose Plani Zhvillimor Urban dhe kur vonesat e mëtejshme në hartimin e Planit Zhvillimor Urban mund të çojnë në zhvillime të pakontrolluara në kundërshtim me interesat e komunitetit, Kuvendi Komunal mund të miratojë kushtet e përkohshme për rregullimin hapësinor me vendim të motivuar dhe me pëlqimin e shprehur të Ministrisë". Kjo do të thotë që ligjvënësit kanë menduar për zhvillimin urban edhe në rastet kur ende nuk janë hartuar planet. Lidhur me këtë është edhe neni 22 i Ligjit për Planifikim Hapësinor, i cili thotë se: "22.3. deri në miratimin e Planit Zhvillimor të Komunës nuk mund të ndërtohen objektet të cilat janë në kundërshtim me destinimin e tokës pjellore bujqësore" dhe paragrafi 22.4. "me vendim të Kuvendit të komunës, në përputhje me Ligjin për tokën bujqësore, do të caktohet toka bujqësore kualitative në të cilën nuk mund të ndërtohen objektet në pajtim me paragrafin 22.3 të këtij neni", çka do të thotë se ligjvënësit janë kujdesur për ruajtjen e tokës bujqësore edhe në mungesë të planeve.

Çka ndodh në praktikë?

Meqenëse me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale komunat kanë kompetenca për planifikimin hapësinor dhe urban të komunës, në disa raste bëhet ndërtimi i destinimit të tokës bujqësore të kategorisë së parë dhe shndërrimi në tokë ndërtimore. Kjo bëhet, sepse nuk zbatohet Ligji për tokën bujqësore dhe Ligji i aplikueshëm për tokën ndërtimore, por pritët që Kuvendi i Kosovës të nxjerrë ligj të ri për tokën ndërtimore, me të cilin pasi të caktohet toka ndërtimore me plan, do të bëhet



Ligjshmëria në planifikim

regullimi i saj dhe do t'u jepej në shfrytëzim të interesuarve sipas kriterëve të përcaktuara me ligj.

Çështja e kushteve të përkohshme për rregullimin e hapësirës është një problem tjetër që në disa raste komunat nuk i zbatojnë dispozitat ligjore sa i përket çështjes kur mungojnë planet.

Kushtet e përkohshme për rregullimin e hapësirës në të vërtetë janë kushtet në bazë të të cilave duhet të hartohet një plan rregullues i përkohshëm që pastaj do të inkorporohet në Planin zhvillimor të komunës dhe Planin zhvillimor urban. Në disa raste këto kushte janë trajtuar si kushte të lokacionit për një objekt banimi individual. Me ndryshimin e Ligjit për planifikim hapësinor është sjellë një risi, sepse këto kushte duhet të miratohen nga Kuvendi i Komunës me vendim të motivuar dhe me marrjen e pëlqimit paraprak nga MMPH-ja.

Gjer tani ende nuk është sjellë ndonjë plan rregullues i përkohshëm për pëlqim nga MMPH-ja.

Por, të kthehemi tek marrja e vendimit për hartimin e planeve. Gati asnjë komunë nuk e ka hartuar vendimin për hartimin e planit në përputhje me nenin 16 të Ligjit për Planifikim Hapësinor. MMPH-ja ka hartuar një udhëzues që të shërbejë si formë se çka duhet të përmbajë vendimi për hartimin e një plani dhe u është dërguar të gjitha komunave, por disa komuna përsëri nuk i caktojnë në vendim kufijtë dhe territorin të cilin e përfshin plani, që është një gjë e domosdoshme për t'u informuar edhe këshilltarët komunalë dhe publiku i gjerë për hapësirën, të cilën do ta përfshijë plani, si dhe në asnjë vendim nuk përshkruhen

kushtet dhe mënyra e zbatimit të planit, siç e parasheh ligji.

Çështje tjetër është konsultimi dhe shqyrtimi publik, pra pjesëmarrja në hartimin e një plani, të cilës i jep rëndësi edhe Agjenda 21. Këto çështje janë të rregulluara në Udhëzimin administrativ nr. 54/2005, lidhur me shqyrtimet publike për planet hapësinore dhe urbanistike. Raporti nga shqyrtimet publike së bashku me Planin zhvillimor të komunës për dhënien e pëlqimit që sillet në Ministri, ka mangësi të shumta. Në të nuk shihet përfshirja e aktorëve të ndryshëm shoqërorë e as komuniteti të cilin e afekton plani, nuk ka raport se cilat vërejtje janë marrë në konsideratë dhe cilat jo dhe për çfarë arsyesh nuk janë marrë. Shpesh ndodh që nuk janë të informuar fare pronarët e tokave se çka është planifikuar në tokën e tyre, andaj plani bëhet i pazbatueshëm dhe krijon pakënaqësi tek komuniteti të cilin e afekton.

Problem i veçantë i zhvillimit rapid urban në Kosovë është Prishtina. Nuk dihet saktë sa është numri i ndërtimeve pa leje, por supozohet të jetë 20 000. Qeveria, gjegjësisht MMPH-ja që sa vjet është në proces të hartimit të Ligjit për trajtimin e ndërtimeve pa leje, por nuk ka arritur që të miratojë një draft të pranueshëm të këtij ligji, për shkak të sfidave të shumta që do të mund të sillte ky ligj. Sipas informatave të fundit, ky ligj është hartuar dhe pritet të miratohet përfundimisht në vitin 2012. Komuna e Prishtinës, duke u ballafaquar çdo ditë me ndërtime të reja pa leje, ka miratuar Rregulloren për trajtimin e ndërtimeve pa leje dhe përmes hartimit të planeve rregulluese dhe kriterëve të tjera

është duke u munduar ta zgjidhë këtë problem. Shikuar nga aspekti juridik, komuna nuk mund të hartojë rregullore pa ekzistimin e një ligji ku duhet të bazohet rregullorja, por nga ana tjetër ajo nuk mund të presë me vite të tëra nxjerrjen e një ligji e të lejojë zhvillime të tjera të pakontrolluara urbane. Kjo çështje është një sfidë për qeverinë qendrore dhe atë lokale dhe për legjislacionin ekzistues, të cilin duhet zgjidhur sa më parë.

Rekomandimet

Në funksion të zhvillimit dhe zbatimit të legjislacionit për zhvillim të qëndrueshëm urban në Kosovë:

Së pari duhet të ekzistojë vullneti politik për të rregulluar zhvillimet urbane në Kosovë, pra të funksionojë shteti ligjor, kurse ligjvënësit të kryejnë punën e tyre.

Përvoja ka treguar që përfshirja e spektrit të plotë të të interesuarve jo vetëm që është parakusht themelor për vendimmarrje të suksesshme pjesëmarrëse, por gjithashtu është e rëndësishme për promovimin e barazisë dhe drejtësisë sociale në qeverisjen urbane.

Nevoja e hartimit të ligjeve dhe rregulloreve shtesë apo ndryshimi i atyre ekzistuese po që se nuk funksionojnë, si nga qeveria qendrore ashtu edhe ajo lokale, me qëllim të zbatimit sa më efikas të legjislacionit.

Mbikëqyrje e përhershme administrative dhe asistencë komunave nga niveli qendror, si dhe mbikëqyrje inspektuese duke shqiptuar gjoba aty ku nuk zbatohet legjislacioni.

Ngritja e kapaciteteve të inspektoratit.

Me qëllim të parandalimit të zhvillimeve të pakontrolluara urbane, në ligj të përcaktohet krijimi i policisë ndërtimore, që të veprojë një kohë gjer në ndërprerjen e zhvillimeve të pakontrolluara urbane.

Nevoja për hartimin e rregulloreve të përshtatshme në nivel lokal për menaxhimin dhe shfrytëzimin e tokës dhe mjedisit të ndërtuar.

Efikasiteti i administratës në lëshimin e lejeve urbanistike dhe ndërtimore brenda afatit ligjor.

(Autorja është zyrtare e lartë ligjore, Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor)

ARKITEKTURA E OBJEKTEVE PUBLIKE NDIKIMI I ARKITEK- TURËS PERËNDI- MORE-EVROPIANE ARKITEKTURA E PRISHTINËS 1878 – 1912

Mr.Sc. Vlora Navakazi, i.d.a



Prishtina ka një traditë të gjatë dhe zhvillim kontinual në periudha të ndryshme të zhvillimit të saj. Me anë të hulumtimit dhe analizës së objekteve është identifikuar etapa e zhvillimit urban-arkitektonik në qytetin e Prishtinës, depërtimi dhe ndikimi i arkitekturës evropiane-perëndimore në indin e vjetër të qytetit, për nevoja të shërbimeve publike, monumentalitetit dhe autoritetit të qeverisjes, e më pak për vlerat arkitektonike dhe artistike.

Dokumentimi shkencor i arkitekturës dhe zhvillimit urban të qytetit të Prishtinës nga fundi i shek. XIX deri në fillim

të shek XX ka rëndësi të posaçme. Qyteti i Prishtinës si qendër e Vilajetit të Kosovës (brenda viteve 1878-1912), fiton një numër të konsiderueshëm të objekteve të rëndësishme për administrimin më të mirë të qeverisë osmane. Gjatë analizës dhe përshkrimit të strukturave organizative të ndërtesave, klasifikimit të tyre, është arritur të bëhet evidencimi i zhvillimit shoqëror, si dhe arritjes së teknikave të reja të ndërtimit, të ndikuara nga arkitektura evropiane. Mbrojtja dhe ruajtja e strukturave arkitektonike të ndërtuara gjatë kësaj periudhe në qytetin e Prishtinës, të cilat

ende në tërësi nuk janë të shkatërruara, paraqesin trashëgimi me vlerë të posaçme jo vetëm për qytetin e Prishtinës, por edhe për Kosovën;

Gjatë procesit të hulumtimit është analizuar literatura e përgjithshme historike, gjeografike dhe antropografike, monografitë e Prishtinës, si dhe shkrimet e ndryshme të udhëpërshkruesve të ndryshëm, si burime të rëndësishme për zhvillimin e qytetit të Prishtinës në fund të shek. XIX dhe fillim të shek XX. Dokumentacioni arkivor i periudhës së hulumtuar në arkivin e Prishtinës nuk ekziston fare. Në Arkivin e Kosovës



ekzistojnë dokumente të cilat nuk i përkasin lëmit të urbanizmit dhe arkitekturës, përderisa numri më i madh i dokumentacionit ndodhet në arkivin shtetëror të Turqisë (në Stamboll), në rajon apo edhe më larg.

Me anë të punës në terren është bërë identifikimi dhe klasifikimi i objekteve nëpër terren; klasifikimi i objekteve në qytetin e Prishtinës në fund të shek XIX dhe fillim të shek XX. Kjo metodë është plotësuar me metodën e krahasimit, duke krahasuar me objekte të ngjashme në qytete të ndryshme të rajonit.

Janë shfrytëzuar të dhëna gojore nga qytetarët e vjetër të qytetit të Prishtinës të cilët jetojnë në Prishtinë apo në Turqi. Nëpërmes të një numri të madh të hartave të gjetura nëpër arkiva të botës, nëpër libra dhe literaturë elektronike (internetit, ku një numër i madh i hartave është identifikuar edhe në Amerikë dhe Kanada), është analizuar një periudhë historike e Kosovës, situata politike në të, ndërrimi i kufijve dhe shënimi i qytetit të Prishtinës nëpër harta të gjetura.

Faktorë i rëndësishëm i zhvillimit dhe formësimit të indit të qytetit të vjetër të Prishtinës dhe zonës urbane brenda

periudhës së viteve 1878-1912., është ndryshimi i numrit dhe i strukturës së banorëve.

Me anë të klasifikimit dhe vlerësimeve analitike të objekteve, sipas destinimit, formës dhe vëllimit të planimetrisë së objektit, dispozitës në indin urban të qytetit, si dhe mënyrës dhe teknikave të ndërtimit janë arritur rezultate të mjaftueshme për hulumtim.

Nga etapat dhe periudhat e ndryshme historike nuk kemi të ruajtura shumë monumente të kulturës, e posaçërisht nga lëmi i arkitekturës së objekteve publike. Pas vendosjes së qendrës së Vilajetit të Kosovës në Prishtinë, qyteti fiton vlera të rëndësishme artistike, historike dhe arkitektonike të cilat vërtetojnë vazhdimësinë historike të zhvillimit të qeverisjes dhe administrimit ushtarak për nevojat të qeverisë otomane. Në fund të shek. XIX dhe në fillim të shek. XX vërehet frymë e re e ndërtimit, ndërtimi i ndërtesave qeveritare dhe administrative me materiale dhe teknologji të re. Stili arkitektonik është i ndryshëm nga stili i deriatëhershëm i ndërtimit oriental; është i ndikuar nga arkitektura europërendimore, qoftë e sjellë apo e krijuar nga mjeshtrit vendës;

Ndërtesat e ndërtuara gjatë kësaj periudhe shquhen më tepër me arkitekturë dhe vëllim të ndryshëm nga ndërtimet e deriatëhershme dhe më pak për "vlerat arkitektonike apo artistike të tyre".


Zhvillimi i qytetit të Prishtinës (shek. XIV deri në shek. XVIII)

Pas rënies së territorit të Kosovës nën Perandorinë osmane shprehet një lulëzim në ndërtimin e strukturave arkitektonike, të mbështetura në përmirësimin e dy nevojave themelore të: përmirësimit të strategjisë ushtarake dhe asaj religjioze.

Fillon ndërtimi i xhamive në çdo mëhallë, ku sipas defterit të viteve 1569-1570, vërehet se në shumicën e rasteve emërtimi i mëhallave bëhet sipas emrit të mesxhidit (xhamisë pa minare) apo të xhamisë.

Zhvillimi i qytetit të Prishtinës prej vitit 1878 deri më 1888 - qendër e Vilajetit të Kosovës

Nga viti 1878 deri më 1888, Prishtina ishte qendër e Vilajetit të Kosovës, një ndër vilajetet më të mëdha shqiptare nën administrimin e Perandorisë os-



mane, ndërsa nga viti 1888 deri më 1912, qendra e këtij vilajeti vendoset në Shkup.

Pjesë më e rëndësishme publike brenda viteve 1878 deri më 1912, ndodhej në bërthamën e vjetër të qytetit të Prishtinës, zona qendrore në mes të pjesës së banimit dhe

Çarshisë së Vjetër (hapësira në mes të Çarshi-xhamisë dhe Xhamisë së Jashar Pashës. Për nevoja të administrimit të Vilajetit të Kosovës, Qeveria turke ndërton objektin qeveritar "Ucmet Konagi" (Objekti i Muzeut të Kosovës). Në këtë kohë nga Prishtina administrohej i tërë Vilajeti i Kosovës, por edhe Sanxhaku i Prishtinës, i cili përbëhej nga 220 000 banorë; kazaja e Prishtinës me 237 fshatra, me 8027 shtëpi dhe me rreth 56.286 banorë;

Strukturat e ndërtuara arkitektonike

Për nevoja të qeverisjes dhe administrimit ushtarak të Perandorisë osmane fillon ndërtimi i objekteve me teknikë krejtësisht të ndryshme në krahasim me ndërtimin oriental të deriatëhershëm.

Struktura urbane e qytetit

Struktura urbane e qytetit të Prishtinës gjatë viteve 1878 deri më 1912, është e ndarë në 12 lagje/mëhallë. Numri më i madh i lagjeve/ mëhallëve ka mbajtur edhe sot e kësaj dite emërtimin e njëjtë sipas emrit të xhamive të ndërtuara gjatë shek XV;

Paraqitja e konceptit perëndimor në arkitekturën e Perandorisë Osmane

Pas sundimit mijëvjeçar, në fund të shek. XVIII, fuqia e Perandorisë Osmane fillon të dobësohet; Sulltan Selimi III, zotërues i Perandorisë Osmane prej vitit 1789 deri më 1807, i pakënaqur me këtë gjendje, fillon të modernizojë ad-



Ndërtesa e Kuvendit në Beyoglu 1861-1876, ark. Barborini

ministratën e posaçërisht ushtinë; Gjatë reformave të Tanzimatit, edhe në arkitekturë vërehet një stil i ri i ndërtimit, stili i ri perëndimor neoklasik, i cili bëhet mjaft i përhapur në objektet e kazermave ushtarake dhe pallateve në Perandorinë Osmane, i sjellë nga

Perëndimi përmes arkitektëve evropianë dhe inxhinierëve ushtarakë, me qëllim të përmirësimit të strategjisë dhe kushteve të ushtisë së Perandorisë Osmane, sipas modeleve evropiane;

Paraqitja e konceptit perëndimor në arkitekturën e Ballkanit

Në qendra të mëdha të vilajeteve nëpër Rumeli, për arsye të qeverisjes më të mirë administrative, nën ndikimin e mënyrës së administrimit perëndimor dhe qeverisjes ushtarake, fillon ndërtimi i objekteve për administrim dhe udhëheqje ushtarake.



Ndërtesa administrative e Vilajetit të Kosovës, në Prishtinë, viti 1896, Prishtinë



Kazemat ushtarake (mëciye Kislasi)
1849-1853, ark. W.J. Smith



Ndërtesa administrative e Vilajetit të Shkodrës gjatë viteve 1878 deri 1912, Shkodër



Ndërtesa administrative e Vilajetit të Manastirit gjatë viteve 1878 deri 1912, Manastir

Valorizimi i ndërtesave për destinim publik në Prishtinë

Gjatë viteve 1878 deri më 1912, në

strukturën urbane të qytetit të Prishtinës vërehet ndërtimi i ndërtesave për destinim publik. Numri më i madh i

strukturave arkitektonike të ndërtuara ishte në pjesën qendrore të qytetit, në pjesën e Çarshisë së Vjetër dhe në afërsi të saj. Këto struktura paraqiten me madhësi monumentale, si dhe me material të ndryshëm të ndërtimit në krahasim me teknikat e atëhershme, janë identifikuar këto objekte:

1. Muzeu i Kosovës
2. Ndërtesa e Gjykatës Komunale
3. Shkolla e Mesme Teknike (në vitin 2010 e transformuar në Arkivin e qytetit të Prishtinës)
4. Shkolla e parë shqipe
5. Ndërtesa e Kadastrës së KK të Prishtinës
6. Ndërtesa e Rektoratit të Universitetit të Prishtinës
7. Ndërtesa e shkollës së mesme "Xhevdet Doda" (e rrënuar në vitin 2008)
8. Ndërtesa e Ministrisë së Shëndetësisë

Në këtë dokument është marrë si shembull i valorizimit objekti më reprezentativ i asaj kohe Muzeu i Kosovës.


MUZEU I KOSOVËS / UCUMET KONAGI/

Ndërtesa më monumentale e ndërtuar gjatë viteve 1878 - 1912 jo vetëm në Prishtinë, por edhe në tërë Vilajetin e Kosovës, është ndërtesa e Muzeut të Kosovës, si ndërtesë për nevojat e qeverisë osmane e quajtur "Ucumat konagi".


Shembull i rivitalizimit – Muzeu i Kosovës "Ucumat Konagi"

Gjatë analizës së objekteve administrative-qeveritare, gjatë viteve 1878 – 1912, në Prishtinë, është analizuar ndërtesa publike e qeverisë turke/Ucumat Konagi. Ky objekt veçohet me elemente karakteristike të ndërtimit gjatë kësaj periudhe, meriton kujdes të posaçëm gjatë përcaktimit të kriterëve për ruajtjen dhe rivitalizimin e objekteve të ndërtuara brenda periudhës së viteve 1878-1912 në Prishtinë dhe në Kosovë.






Muzeu i Kosovës. Baza e përdheshës



Muzeu I Kosovës. Prerja tërthore



Muzeu I Kosovës. Fasada kryesore




Viti 1895 "Ucimet Konagi"
Gjatë qeverisjes së Perandorisë Osmane



Viti 1912. "Ndërtesa e Divizionit të Kosovës",
gjatë qeverisjes së Jugosllavisë së vjetër (Serbisë)



Nga viti 1975 shfrytëzohet për "Muze të Kosovës"
gjatë periudhës së Ish- Jugosllavisë




Muzeu i Kosovës. Baza e përdhësë

Objekti është ndërtuar në pjesën qendrore të qytetit të Prishtinës në periudhën e viteve 1878-1912, në mes të xhamisë më të vjetër në Prishtinë, Çarshi Xhamisë dhe Xhamisë së Jashar Pashës. Rëndës-

inë e pozitës së ndërtesës së Muzeut të tanishëm e vërteton edhe Sahat-kulla, e cila ishte ndërtuar në shek XVII, duke formuar përreth saj sheshin publik. Sahat-kulla e vjetër është e ndërtuar sipas


shembujve të kullave romanike të shekullit të mesëm. Ndodhej në pjesën qendrore publike të qytetit, në pjesën e përparme të ndërtesës së Muzeut të Kosovës.



Muzeu i Kosovës. Baza e përdheshës

STILI ARKITEKTONIK-

i ndërtësës së Muzeut të Kosovës "Uc-umet Konagi", është barok me shkallë të jashtme reprezentative, në formë gjysmërrethore, derisa elementet në fasadë kanë dekor të lehtë të ndikuar nga arkitektura perëndimore-evropiane




DISPOZITA E BAZES DHE FUNKSIONALITETI I SAJ

Dispozita e bazës - është ndërtësë e veçantë, me hapësira të ndriçuara, orientim të mirë, vizura në pjesën qendrore të qytetit-çarshisë së atëhershme. E rrethuar me oborr, në të cilin ka qenë e vendosur Sahat-kulla e vjetër deri në vitin 1900. Nga oborri, përmes shkallëve dekorative gjysmërrethore nga të dyja anët, ndodhet hyrja kryesore e ndërtësës. Hyrja është monumentale, me trem të hapur me tri harqe gjysmërrethore, si dhe timpanonin dekorativ mbi të.



INTERVENIMI I PARË

Në vitin 1912, shndërrohet në ndërtesën e Divizionit të Kosovës të qeverisë serbe. Ndërtesa pëson ndryshime gjatë intervenimit të asaj kohe; Fasada pëson ndryshime: timpanoni eliminohet dhe ballkoni mbi hyrjen kryesore mbyllet në tërësi.



INTERVENIMI I DYTË

Me adaptimin dhe rikonstruktimin e vitit 1975, transformohet në ndërtesën e Muzeut të Kosovës. Pason ndryshimet në partinë hyrëse, e cila mbyllet, që edhe pas intervenimit të dytë nuk rikthehet, kulmi transformohet në formë të mansardës, kurse dritaret e drejta marrin formën e gjysmërrethit.



Nga viti 1912 deri 1975, Ndërtesë e Divizionit të ushtrisë serbe.

Ndërtesa e Muzeut është objekti më i rëndësishëm historiko-arkitektonik në Prishtinë, prandaj duhet pasur kujdes në intervenimet e ardhshme në të. Arkitektura e trashëguar nga gjysma e dytë e shek XIX dhe fillimit të shek XX në qytetin e Prishtinës, si përfaqësuese e civilizimit të kësaj periudhe në territorin e Ballkanit, nën dominimin e Perandorisë Osmane, nuk është analizuar deri më sot; ndërtesat janë të pranishme dhe ende plotësisht të pashkatërruara. Qyteti i Prishtinës si qendër e rëndësishme ushtarako-administrative e Perandorisë Osmane fitoi objekte me destinim publik, për qëllim të administrimit më të mirë. Në bazë të tipologjisë së hulumtuar vërehet se ndërtesat e analizuar kanë vend të posaçëm në zhvillimin e arkitekturës së kohës së re nën dominimin e Perandorisë Osmane, ishte i përvetësuar tipi i



Nga viti 1975 deri 1988, Muzeu i Kosovës

ri arkitektonik dhe hapësiror karakteristike për hapësirat e qendrave evropiane. Duke analizuar dhe klasifikuar këto ndërtesa është evidencuar një periudhë e zhvillimit shoqëror, arritjet e reja

teknologjike të ndërtimit, si dhe njohurisë më të mirë për strukturat hapësirnore organizative të ndërtesës si dhe zhvillimit urban të indit të qytetit të Prishtinës gjatë periudhës 1878-1912, qendër e Vilajetit të Kosovës.

IDENTITETI URBAN NË KOSOVË

Arch. Ylber Vokshi Ylli



Mobiliari urban me kohë krijon identitetin e vet në hapësirë
"NEWBORN" monumenti i pavarësisë në Prishtinë

Asgjë më mirë se një tërësi urbane, kompleks apo objekt arkitektonik, nuk mund ta dokumentojë apo tregojë vazhdimësinë shekullore të ekzistencës së një populli në një tërësi të caktuar hapësinore. Identiteti urban, i cili është krijuar me shekuj, e ka një rëndësi të veçantë në aspektin kohor dhe historik, të cilin duhet kultivuar dhe ruajtur domosdo me dinjitet dhe profesionalizëm të lartë. Është ky një fenomen, të cilit duhet t'i japim rëndësi të veçantë në funksionimin e shtetit të Kosovës, që pa mëdyshje do të amortizojë dilemat dhe dyshimet, të cilat kanë qarkulluar me shekuj në këto hapësira. Për këtë ka dokumente dhe fakte të pamohueshme të shprehura me ekzistencën e popullit shqiptar, si pasardhës të ilirëve në këto hapësira.

Në këtë vështrim të shkurtër nuk do të analizoj detajet apo elementet kryesore të identitetit urban, siç janë sheshet qendrore

dhe sekondare, vendtubimet specifike, si rrugët apo shëtitoret për këmbësorë, fontanat, mobileritë urbane (ulëset, shportat e mbeturinave, krojet publike etj.), përmendoret, skulpturat, pikturat apo mozaikët publikë, objektet e rëndësishme arkitektonike, si dhe tërësitë urbane, që identifikojnë një vendbanim apo një shtet. Si shoqëri, këtij fenomeni nuk i kemi dhënë rëndësinë e duhur, e kjo gjithnjë na është hakmarrë gjatë shekujve të kaluar të ekzistencës sonë.

Në Kosovë për të përcaktuar identitetin urban duhet hulumtuar të gjithë shkaktarët në periodat e kaluara historike, të cilët kanë ndikuar direkt apo indirekt në zhvillimin dhe respektimin e këtij procesi, i cili përcakton ekzistencën e një populli në hapësira të caktuara territoriale me shekuj. Për këtë duhet bërë hulumtime të veçanta për

kryeqytetin, qytetet kryesore dhe vendbanimet e tjera në Kosovë. Ne vetë jemi të prirë dhe në gjendje ta shkatërrojmë ardhmërinë e jetës urbane, për gjeneratat e reja që do të jenë të detyruara të jetojnë në këto hapësira, është ky një fatalizëm i pashpjegueshëm historikisht.

Përse është i rëndësishëm identiteti urban shumë pak i trajtuar në tërë Kosovën!

Sa lehtë e anashkalojmë dhe harrojmë ekzistencën tonë në këto hapësira. Jo gjithnjë e kemi vlerësuar të kaluarën tonë, e cila më së miri identifikohet me objekte të cilat çdo shoqëri në mënyrë institucionale i ruan, për të treguar dhe dokumentuar lashtësinë e vet, përderisa ne, mu këto vlera historike dhe arkitektonike i kemi zhdukur përpara dhe të njëjtën gjë jemi duke e bërë edhe në njëmbëdhjetëvjetëshin e parë të shekullit 21.

Vetëm ata të cilët nuk e njohin rëndësinë historike të ekzistimit të këtij populli në këto hapësira, e ndërlikuar ngushtë me identitetin urban të vendbanimeve tona, mund ta minimizojnë rëndësinë e procesit. Në shikim të parë kjo duket e parëndësishme, shumë objekte kulturo-historike edhe që ishin nën mbrojtjen e shtetit në mënyrë sistematike në dymbëdhjetëvjetëshin e fundit janë zhdukur. Se prapë, që nga paslufta do të trajtojmë këto monumente kulturo-historike në këtë mënyrë nënçmuese, as që do komente profesionale, gjë që është e patoleruar, e pafalshme, pasi sot e kemi tërë infrastrukturën shtetërore që është e obliguar të veprojë.

Shtrohet pyetja logjike se ku është identiteti urban i Kosovës, me vendbanime të vjetra dhe të reja. Ruajtja e identitetit burimor, avancimi i tij, si dhe harmonizimi me



Shembull i mirë se si ruhet dhe çmohet identiteti urban
"Çarshia e madhe" në Gjakovë e restauruar dhe rindërtuar

karakterin e përbashkët gjithnjë ka qenë imperativ i çdo shoqërie, përderisa te ne po veprohet në mënyrë vandale me rrënimin e tyre sistematik pa asnjë dhënie të përgjegjësive. Kjo mënyrë e veprimeve në të njëjtën kohë shkatërron edhe trashëgiminë e qyteteve tona, e cila rrënjësisht ndikon në identitetin e qytetit pasi gjeneratat e reja as që e dinë se nga i kanë rrënjët apo se nga kanë ardhur. Në të ardhmen sfida më e madhe do të jetë se si të plotësohen kërkesat e investitorëve të rinj, dhe në të njëjtën kohë duke mbajtur nivelin e lartë të praktikës planifikuese, në gjenerimin e hapësirave urbane, në favor të gjithë banorëve të qytetit. Pyetje thelbësore e teorisë dhe praktikës së urbanizmit do të duhej të ishte se në interesin e kujt planifikohet hapësira në qytete, ku bashkëpronarë (hisedarë) janë të gjithë banorët e tij.

Pyetja e identitetit të hapësirës urbane është me rëndësi fundamentale për përjetimin e ndonjë qyteti në botën e re globale që po krijohet. Me zhvillimin e procesit të globalizimit, identiteti urban është bërë faktor i rëndësishëm në procesin e planifikimit hapësinor. Qytetet po ballafaqohen me kërcënimet e humbjes së identitetit, e në të njëjtën kohë me mundësinë për ta ndryshuar atë. Këtë e mundëson ekonomia globale, e bazuar në ekonominë e tregut, me krijimin e mundësive të reja për tregje të reja dhe integritet politik.

Janë disa principe elementare që duhet të respektohen, sikurse janë projektuesit urbanë kosovarë, ashtu dhe pjesëmarrësit e tjerë gjatë përpilimit të dokumenteve hapësinore, ashtu dhe zyrtarët e shumtë të dy niveleve shtetërore apo ata që presin sfida të mëdha në jetësimin e këtyre kërkesave të kohës, si:

Përcaktimi i bërthamës së qyteteve-qendrës së tyre të vjetër (down town), si dhe trajtimi adekuat me kritere të veçanta arkitektonike dhe urbanistike;

Ruajtja e identitetit burimor të disa zonave të qyteteve tona si dhe avancimi dhe përshtatja e tyre sipas kërkesave të reja urbane;

Përparimi dhe riformulimi i të gjitha elementeve karakteristike të një vendbanimi; Identifikimi i pikave karakteristike natyrore dhe të ndërtuara të zonave urbane dhe



Djegia e hotelit Union në Prishtinë

rurale të vendbanimeve tona; Vënia me prioritet i pasurive të ndryshme arkitektonike dhe bërthamave urbane, si trashëgimi e patjetërsueshme me shekuj; Evidencimi dhe promovimi i arkitekturës dhe urbanizmit bashkëkohor në shekullin 21, si pjesë të pandara të identitetit urban; Kjo do të thotë që sa më parë duhet të mendohet se si duhet të përmirësohen kushtet e jetesës së këtyre njerëzve, me rifillimin e zbatimit të dokumenteve të shumta të planifikimit hapësinor dhe urbanistik. Çuditërisht ende veprimet tona të pakontrolluara në dhjetëvjetëshin e fundit nuk kanë justifikim. A thua, kush na pengoi pos vetvetes!

Duhet të jemi të vetëdijshëm se është në pyetje humbja e identitetit urban, i gërshtuar me elemente të trashëgimisë historike, që shumë lehtë po shkatërrohet me veprimet tona, pa menduar në pasojat të rënda për tërë Kosovën. Kjo çështje nuk u përket vetëm rasteve individuale, porse është e ndërlidhur me filozofinë jetësore të mjedisit ku jetojmë e veprojmë. Harresa historike na është hakmarrë në të kaluarën, e si jemi duke vepruar do të na hakmerret edhe në të ardhmen.

Qëllimi është që të tregojmë se si njohja me fenomenin e identitetit urban të vendbanimeve tona mund të shërbejë edhe si udhëzues i zhvillimit të ardhshëm të tyre. Mbrojtja e të gjitha vlerave natyrore, historike dhe arkitektonike duhet të ishte obliguese, pasi ashtu e kërkojnë ligjet,

normat dhe standardet ndërkombëtare, të cilave deshëm apo nuk deshëm jemi të obliguar t'u nënshtrohemi, nëse nuk dëshirojmë të jemi të "izoluara" edhe në vitet e ardhshme të shekullit 21. Një gjë të tillë e ka përjetuar një pjesë e kombit shqiptar në shekullin e kaluar, me pasojat të rënda të cilat edhe në ditët e sotme vërehen.

Kjo çështje nuk u përket vetëm grupeve të caktuara të interesit, porse është e ndërlidhur me filozofinë jetësore të mjedisit ku jetojmë e veprojmë, nëse analizohen vetëm veprimet tona në vitet e fundit, të cilat e vërtetojnë qartë identitetin arkitektonik dhe urbanistik të dokumentuar me trashëgiminë e pasur historike dhe kulturore. Çuditërisht këto veprime fare nuk vlerësohen dhe nuk trajtohen dhe se nuk e kanë vendin që duhet t'u takojë në pedestalin e kulturës së popullit tonë.

Është koha që kokat e kthjellëta intelektuale të reagojnë në këto veprime për të mirën e të gjithë neve dhe gjeneratave të ardhme. Jam i vetëdijshëm se për të shpjeguar e pastaj zbatuar elementet kryesore të identitetit urban është shumë vështirë në Kosovë. Për shumëkënd ky është mision i pamundur, por me sakrificën e profesionistëve të vërtetë dhe me një punë konstante të të gjitha institucioneve relevante shtetërore, kjo do të fillojë të realizohet.

(Autori është kryetar i Këshillit për Planifikim Hapësinor të Kosovës - KPHK)

Cartoons are the winners of the 4th International Indian Cartoon Competition, 2007.

Karikaturat janë fituese të Konkursit të IV-të Ndërkombëtar Indian për karikaturë, 2007.



Alessandro Gatto - Italy



Huseyin Cakmaci - Cyprus



Huang Qiu Jiang - China



Bostjan Kavcic - Czech Republic



Spilthoven - Russia



Raul de la cruz - USA



Spilthoven - Russia


Quotes on urban development

If you are planning for a year, sow rice;
if you are planning for a decade, plant trees;
if you are planning for a lifetime, educate people.
- **Chinese Proverb**

We must stop talking about the American dream
and start listening to the dreams of Americans.
- **Reubin Askew**, former Governor of Florida

Good plans shape good decisions.
That's why good planning helps to make
elusive dreams come true.
- **Lester Robert Bittel** (b. 1918), writer

Have a plan. Follow the plan, and you'll be
surprised how successful you can be.
Most people don't have a plan. That's why it's
easy to beat most folks.
- **Paul "Bear" Bryant**, University of Alabama




Constantin Ciresu - Romania



Mohmmed nazari - Iran



Raul de la mont - USA



Gabriel Rusu - Romania

Cartoons are the winners of the 4th International Indian Cartoon Competition, 2007.

Karikaturat janë fituese të Konkursit të IV-të Ndërkombëtar Indian për karikatura, 2007.

Disa nga konferencat ndërkombëtare lidhur me zhvillime urbane në vitin 2012
Some of International conferences for Urban Development on 2012
Medjunarodne konferencije za Urbani Razvoj tokom 2012

February 2012

- Green Development: Sustainable Buildings and Infrastructure **Vancouver Canada**
- Cognitive Research on Human Perception of Built Environment for Health and Wellbeing **Visakhapatnam India**
- Architecture for Leisure in Post-war Europe [1945-1989] **Leuven Belgium**
- International Conference on Environmentally Sustainable Urban Ecosystems (ENSURE 12) **Guwahati India**

March 2012

- International Conference on Sustainable Architecture and Urban Design 2012 **Penang Malaysia**
- 2nd Global Conference: Urban Popcultures **Prague Czech Republic**
- GLOBE 2012 **Vancouver Canada**
- 3rd Global Conference: Urban Fantasies - Magic and the Supernatural **Prague Czech Republic**

April 2012

- Agriculture in an urbanizing society - International Conference on Multifunctional Agriculture and Urban-Rural Relations **Wageningen Netherlands**
- City2020+: Engineering Life Quality for the Future Aachen Germany
- First International Conference on Architecture and Urban Design (1-ICAUD) **Tirana Albania**
- ISVS-6 International Seminar on Vernacular Settlements **Famagusta Cyprus**
- GreenAge 2012 **Istanbul Turkey**

May 2012

- 2nd International Congress on Urban and Environmental Issues and Policies **Trabzon Turkey**
- 7th International Conference on Urban Regeneration and Sustainability **Ancona Italy**
- REAL CORP 2012 - 17th International Conference on Urban Planning, Regional Development and Information Society Schwechat **(Vienna's Airport City) Austria**

June 2012

- EUROGEO 2012: Geography and Global Understanding: Connecting the Sciences **Dublin Ireland**
- LONDONCITY 2012: The Second Annual London Studies Conference - London: City of Transformations? **London United Kingdom**
- Sustainable Futures 2012 **Kampala Uganda**
- World in Denmark 2012 - City PLANTastic **Copenhagen Denmark**

July 2012

- World Cities Summit 2012 **Singapore**

August 2012

- 8th International Conference on Urban Climate – ICUC 8 **Dublin Ireland**

September 2012

- 4th International Conference on Harmonisation between Architecture and Nature **Kos Greece**
- Planning Africa 2012 **Durban South Africa**

October 2012

- Space Strategies 2012 **San Diego Other**
- GreeNets 2012 **Gandia Spain**

November 2012

- 13th World Conference of ACUUS: Underground Space Development-Opportunities and Challenges **Marina Bay Sands, Singapore Singapore**
- CONTEMPORARY ARCHITECTURE AND URBANISM IN THE MEDITERRANEAN AND THE MIDDLE EAST CAUMME 2012 International Symposium Global Impacts Local Challenges **Istanbul Turkey**
- Sustainability By Design: breaking the silos **Auckland New Zealand**



SOROS

Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur
 Kosovska Fondacija za Otvoreno Društvo
 Kosovo Foundation for Open Society